

VËRTETËSIA

Botimi i Xhematit Mysliman Ahmadia të Shqipërisë

Janar-Prill 2009

Paqja shoqërore ekonomike

f. 26



Xhemati Mysliman Ahmadia

Një paraqitje

f. 12



Mesazhi i Krytarit të Xhematit Mysliman Ahmadia me rastin e njëqind-vjetorit të Kalifatit Ahmadia

f. 19



Një rishikim I kritikës historike të fajdesë dhe vërtetje mbi krizën globale ekonomike

f. 46



Investimi, interesi dhe Islami

f. 39

VËRTETËSIA

“Erdhi e vërteta dhe u zhduk e pavërteta. Sigurisht, e pavërteta gjithnjë zhduket.”

(Kurani i Shenjtë 17:82)

Botimi i Xhematit Mysliman Ahmadia të Shqipërisë

Janar-Prill 2009 Viti I Nr. 1

Lënda

❖ Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!	2
❖ Komentimi i Kuranit të Shenjtë	4
❖ Nga thëniet e Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s.	8
❖ Nga thëniet e Hazret Mesihut të Premtuar, Themeluesit të Xhematit Mysliman Ahmadia a.s.	11
❖ Xhemati Mysliman Ahmadia – Një paraqitje	12
❖ Mesazhi i Udhëheqësit shpirtëror të Xhematit Mysliman Ahmadia, me rastin e njëqind-vjetorit të Kalifatit	19
❖ Paqja shoqërore ekonomike	26
❖ Investimi, interesi dhe Islami	39
❖ Zekati	44
❖ Një rishikim i shkurtër i kritikës historike të fajdesë	46
❖ Interesi dhe vërejtje mbi “Krizëne kredisë” (Poshtë shënim)	58
❖ Atributi i Zotit “Furnizues” (Er-Rezak) dhe kriza globale ekonomike	62
❖ Filozofitë ekonomike të Kapitalizmit, Komunizmit dhe të Islamit	71
❖ Kriza ekonomike e parashikuar në vitin 1990	74
❖ Filozofitë kryesore të sistemit ekonomik – një përjasje	76
❖ Konferenca për paqen e organizuar nga Xhemati Mysliman Ahmadia i Anglisë	80
❖ Shkurtime dhe shpjegime	84

Redaksia

Kryeredaktor: Samad Ahmed Ghorri

Zv. Kryeredaktor: Shahid Ahmad Butt

Redaktor: Petrit Bezhani

Anëtarë: Bujar Ramaj, Çapajev Zera, Fisnik Bytyçi

Adresa: Xhemati Mysliman Ahmadia i Shqipërisë, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 1,
Kutia Postare 8176, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355(0)682974992, 0692994966, 0672168054,

Fax: +355(0)48302523

E-mail: vertetesia@gmail.com

Shtypur në Shtypshkronjën “Mirgeeralb”

Përgatitja grafike: Studio “Geer”

Kopertina: Shahid Ahmad Butt

Tiranë, 2009

السلام عليكم ورحمة الله وبركاته

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

Mijëra e mijëra falënderime i takojnë Zotit të Madhëruar që i dha mundësi Xhematit Mysliman Ahmadia, që edhe në Shqipëri, pas një veprimtarie shumë vjeçare të tij, të arrijë të botojë revistën “Vërtetësia”, mes së cilës do t’i tregojë botës shqiptare vërtetësinë e Kuranit të Shenjtë, si dhe atë të Librave të feve të tjera që kanë ardhur nga i njëjti Zot, i Vetëm dhe i Mëshirshëm. Revista jonë “Vërtetësia”, si më e reja mes botimeve bashkëkohore shqiptare mes shkrimeve të saj me tematika fetare, kulturore, enciklopedike dhe shkencore, duke u bazuar gjithmonë në Shpalljen Hyjnore do t’iu tregojë besimtarëve rrugën e drejtë, atë të përsosmërisë e të fisnikërimit, bazuar me mësimet e Allahut të Madhëruar që i treguan rrugën e drejtë njerëzimit gjatë gjithë historisë së tij e deri më sot.

Sipas Xhematit Mysliman Ahmadia, paralajmërimet e feve të vërteta tregojnë se kjo është koha e ringjalljes të të gjitha feve, të cilën

do ta bëjë Islami me argumentet, me mesazhin e tij të dashurisë e të paqes. Ky Xhemat (Bashkësi) është themeluar nga Hazret Mirza Ghulam Ahmadi, paqja qoftë mbi të, mbas vdekjes të të cilit Xhemati u udhëhoq nga Kalifët e tij. Kalifi i tanishëm është Hazret Mirza Masroor Ahmadi, Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar. Në vitin 2008, Xhemati Mysliman Ahmadia festoi në mbarë botën njëqindvjetorin e sistemit të Kalifatit.


Në numrin e parë të “Vërtetësisë” po ju sjellim një paraqitje të këtij Xhemati dhe disa nga aktivitetet e tij.

Veç kësaj po ju sjellim shumë këshilla të çmuara nga bota e fesë që hedhin dritë mbi sistemet ekonomike dhe rrugëzgjdhjet nga mund të dilet prej kësaj krize globale.

Profeti i parë që dërgoi Zoti i Madhëruar në këtë botë, sipas Kuranit të Shenjtë si dhe Biblës, ishte Hazret Ademi paqja qoftë mbi të. Sipas Kuranit të Shenjtë, në fakt, parajsa në të cilën ai jetonte ishte shoqëria e tij që ai qeveriste. Këtij Profeti i jepen udhëzime të tilla që në radhë të parë synojnë të sigurojnë jetën e lirë dhe paqësore të çdo individi, qoftë edhe



ekonomikisht. Kurani i Shenjtë citon:



“(O Adem), Ti nuk duhet të mbetesh kurrë as i uritur e as i zhveshur, dhe nuk duhet të kesh as etje e as vapë!”

(Ta-Ha 20:119-120)

Me fjalë të tjera, çdo individ duhet të ketë ushqim dhe ujë, rroba dhe shtëpi. Padyshim që këto janë elementet më jetike me të cilat nis jeta për një shoqëri. Mbas Hazret Ademit a.s. erdhën shumë profetë të tjerë, që nën udhëzimin Hyjnor, u dhanë njerëzve parime të arta, të cilat ishin të përshtatshme për kohërat dhe për vendet e tyre. Në fund, Zoti i Mëshirshëm dërgoi fenë Islame nëpërmjet Hazret Profetit Muhammed, *paqja dhe mëshira e Allahut gjithmonë qofshin mbi të*, që është feja përfundimtare dhe mban mësimet që do t’iu nevojiten njerëzve të gjithë botës në çdo kohë edhe në të ardhmen.

Sot, “drejtësia ekonomike” është një slogan shumë i diskutuar. Edhe kapitalizmi, me tregun e lirë dhe globalizmin, ka të njëjtin slogan, si edhe socializmi, me zotërimin e përbashkët të ekonomisë, pretendon të praktikojë të njëjtën gjë. Por fatkeqësisht të dyja

sistemet nuk arritën të bëjnë drejtësi me këtë parim të drejtë.

Sigurisht, kapitalizmi është ai sistem që i liroi ekonomikisht disa shtete si Shqipërinë, që ishin të “prangosur” nga një komunizëm i fort.

Por ai, me parimet e tij që përqendrohen te grumbullimi i pasurisë vetëm në disa duar, thelloi gjithnjë e më shumë humnerën midis të pasurve dhe të varfërve.

Ndërsa sistemi ekonomik i paraqitur nga Islami, gjithashtu mundëson tregun e lirë, por duke u bazuar mbi idenë se:

“Çdo gjë që ekziston në qiej e në tokë, i përket Allahut” (Ali Imran 3:190)

dhe që njeriu është caktuar si përgjegjës dhe i janë dhënë me mirëbesim, furnizime dhe pajisje të ndryshme për t’i përdorur ato drejtësisht. Gjithashtu, pasuria apo varfëria janë dukuri apo mjete për ta sprovuar njeriun, saqë në të dyja këto rrethana, ata që janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e tyre, të dallohen nga ata që kthehen në egërsira dhe nuk e vrasin mendjen për vuajtjet e të tjerëve.

I lutemi Zotit të Madhëruar që të na mundësojë që ne, me anë të këtij organit tonë, t’ju përcjellim sa më mirë mesazhin Hyjnor dhe të përhapim paqe e siguri në botën ku jetojmë ne të gjithë bashkë.

Revistës i urojmë rrugë të mbarë në misionin e saj fisnik dhe inshallah (dashtë Zoti) do të përpiqemi të vazhdojmë gjithmonë duke ju shërbyer me urtësinë Hyjnore me anë të kësaj reviste.

Tani kjo është juaja...

Samad Ghoiri

Komentimi i Kuranit të Shenjtë

*Nga Hazret Mirza Mahmood Ahmad,
Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar r.a. (1889-1965)*

Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin e Shenjtë:

“Ata që japin nga pasuria e tyre natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi do të kenë shpërblimin e tyre te Zoti i tyre. Ata nuk do të kenë as frikë e as nuk do të pikëllohen.”

(El-Bekare, 2:278)

Hazreti Mirza Mahmood Ahmad r.a., duke shpjeguar këtë ajet thotë:

“Në këtë ajet Zoti ka përmendur disa elemente të tjera të sadakasë (bërja e mirësisë për hir të Zotit). Ai thotë se besimtarët e vërtetë nuk presin për ndonjë kohë të caktuar për të dhënë lëmoshë. Ata e japin edhe natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi. Në fakt, sipas Kuranit të Shenjtë, besimtarët myslimanë nuk kalojnë asnjë çast pa bërë vepra të mira. Kështu që obligimi i faljes së namazeve gjatë ditës e natës, agjërimet dhe haxhillëku sipas kalendarit hënor, i lejojnë besimtarët t'i kryejnë këto detyra në kohë të ndryshme dhe në muaj të ndryshëm të vitit.

Në këtë ajet ndajfolja “fshehurazi” është përmendur para ndajfoljes “haptazi”, në të njëjtën mënyrë fjala “natë” është përmendur para fjalës “ditë”, që tregojnë lidhjen me ndajfoljet e tyre përkatëse. Pra, besimtarët e vërtetë, nganjëherë, edhe gjatë natës dalin fshehurazi dhe japin lëmoshë, në mënyrë që marrësi apo nevojtar i nuk arrin ta njohë dhënësin. Besimtarët veprojnë kështu që mos të lëndojnë nevojtarin, por gjithashtu që edhe vetë ata mos të ndjejnë asnjë fije mendjemadhësie apo dukjeje në zemrat e tyre. Ata japin lëmoshë edhe haptazi gjatë ditës, jo për të fituar nam në shoqëri, por që të nxisin të tjerët në bërjen e bamirësisë për të varfrit, dhe kështu të eci gjithë shoqëria në bamirësi. Me fjalët “natë” dhe “ditë” mund të kuptohet edhe kjo që besimtarët e vërtetë shpenzojnë në rrugën e Zotit gjatë vështirësisë edhe gjatë rehatisë. Nëse do të shikojmë me vëmendje, Zoti caktoi dy lloje lëmoshash në fenë Islame. Së pari është “zekati”

që kërkohet nga shteti si taks. Me këtë sistem Islami e siguron jetën e të varfërve. Së dyti është “sadakaja”, që dallon besimtarët e devotshëm nga jo të devotshëm. Sepse i devotshmi jep lëmoshë edhe me dëshirë për të fituar pëlqimin e Zotit. Por zekatin, ngaqë vetë shteti e merr, çdo besimtar patjetër duhet ta paguajë, edhe ai që është i devotshëm dhe ai që është i dobët në besimin e tij. Prandaj, Islami i nxit besimtarët për të dhënë edhe lëmoshë, që njerëzit të priren sa më shumë për të ngritur nivelin e jetesës të shtresës së ulët e të të varfërve.

Një arsye tjetër e sistemit të zekatit është për t’ia respektuar ndërgjegjen tjetrit. Sepse paratë e zekatit i shpërndan shteti, kështu që marrësi nuk mund ta dijë se kush i ka dhënë ndihmë. Ndërsa, nga ana tjetër, sadakaja është ajo që krijon dashamirësi dhe vëllazëri midis njerëzve. Shkurt, një pjesë e lëmoshave u është siguruar të varfërve duke i detyruar të pasurit që të paguajnë zekat, ndërsa një pjesë tjetër e tyre është për të përparuar në besim dhe për të arritur nivele të larta të devotshmërisë, duke u dhënë vullnetarisht lëmoshë të varfërve.

Sipas ligjit të natyrës nuk mund të kesh të korra nëse nuk i ke mbjellë farat më përpara. Duke u bazuar në këtë ligj, Zoti thotë se së pari ne të shpenzojmë e të harxhojmë për hir të Tij dhe pastaj Ai do të na japë shpërblimin. Padyshim Zoti mund të krijojë diçka edhe pa farë, por ngaqë Vetë Ai e ka vënë këtë ligj, prandaj Ai

pret që edhe ne të japim kontributin tonë.

Me fjalët “Ata nuk do të kenë as frikë e as nuk do të pikëllohen”, Allahu i Madhëruar na thotë se: në këtë botë shumë njerëz që mbjellin farat, nganjëherë humbasin edhe të korrat e tyre. P.sh. mund t’i bjerë zjarr arës ose mund të vidhet hambari, dhe kështu bujku nuk mund të korë asgjë veçse frikën dhe pikëllimin, por besimtarët e Tij kurrë nuk pësojnë këtë gjendje (përderisa ata besojnë fuqimisht dhe gjithë shpresën e kanë vetëm te Zoti). Gjithashtu, në këtë botë nga një farë mund të mbijnë njëqind kokrra, por Zoti jep në mënyrë të panumërt dhe besimtarëve të Tij Ai u dhuron bekime të përjetshme.

Pas këtij ajeti Allahu i Madhëruar thotë:

“Ata që hanë kamatë, nuk qëndrojnë veçse sikur ai i çmenduri nga të prekurit e shejtanit. Sepse ata thonë se tregtia është njëlloj si kamataria. Mirëpo Allahu tregtinë e ka lejuar kurse kamatarinë e ka ndaluar. Pra, ai të cilit i vjen këshilla nga Zoti i tij dhe i shmanget kamatës, le ta mbajë atë që tashmë ka fituar dhe çështja e tij është në dorën e Allahut. Ndërsa ata që i kthehen kamatës sërish, do të jenë banorë të Zjarrit ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”

(El-Bekare 2:276)

Në këtë ajet Allahu i Madhërishëm tregon gjendjen e atyre popujve që janë fajdexhinj, dhe tek të cilët, për shkak të pasojave të fajdesë, jo

vetëm që thellohet humnera midis të varfrit dhe të pasurit, por gjithashtu shkatërrohet paqja shoqërore. ...

Në fakt, ndalimi i fajdesë është një nga urdhrat më të rëndësishëm të Islamit. Islami nuk dëshiron që pasuria të mbetet vetëm në duar të disa njerëzve të pasur dhe të tjerët të vuajnë edhe për bukën e gojës. Ai synon që çdokush të ketë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në garën e përparimit dhe kështu shoqëria të ngrihet mbi baza shumë të forta. Pra, duhen mbyllur të gjitha bizneset që mbështeten te fajdeja. Sepse pikërisht fajdeja, me anë të së cilës të pasurit duke u pasuruar gjithnjë e më shumë, zaptojnë çdo lloje tregtie, në mënyrë që të tjerët të mbijetojnë me mëshirën e tyre.

Fajdeja, në përgjithësi, është e dylllojshme: (1) Së pari, është ajo që një i pasur, për ta shtuar pasurinë e vet merr paratë nga të pasurit e tjerë dhe ua paguan fajdenë atyre. Siç është puna e bankave apo e tregtarëve të kësaj kohe. (2) Dhe lloji tjetër i fajdesë është ai, kur një i varfër merr hua nga një i pasur për të plotësuar nevojat e tij jetike dhe pastaj ia paguan fajdenë atij.

Islami i ndalon të dyja llojet e fajdesë... dhe jo vetëm që ndalon dhënien e fajdesë por ndalon edhe marrjen e saj. Madje, Islami fajëson edhe dëshmitarët dhe shkruesit e një marrëveshjeje që mbështet në fajde.

Nëse dikush na pyet për fajdenë e llojit të parë, pra për atë të të pasurve, që nëse një njeri ka dhjetëmijë rupi

(monedhë indiane), atëherë ai, për ta shtuar e fuqizuar tregtinë e tij, pse të mos t'i shtojë ato në njëqindmijë rupi duke marrë kredi bankare, apo hua nga njerëzit e tjerë të pasur? Ne mund t'i përgjigjemi shumë lehtë që ai duhet të durojë, pasi dhjetëmijë rupi janë mjaft për të mbijetuar. Por nëse shtrohet pyetja që një njeri i varfër që po vdes nga uria, se nuk i eci mirë bujqësia se nuk pati shira sivjet, dhe s'ka as bukë për të ngrënë në shtëpinë e tij; atëherë në këto rrethana ai ka vetëm një rrugë zgjidhje – duhet të marrë borxh. Por çfarë duhet të bëjë ai, nëse askush nuk i jep borxh pa fajde. Përgjigjja e kësaj pyetjeje është pak e vështirë. Sepse ne nuk mund t'i themi një të mjeri e të varfri të tillë, që “nëse s'ke para duhet të durosh dhe jeto me aq sa ke!” Atij mund t'i përgjigjem vetëm kaq: “Rri pa bukë dhe vdis!” Por kjo nuk është një përgjigje që mund t'i përshtatet ndërgjegjes sonë dhe as nuk i mbush mendjen atij që e shtron një pyetje të tillë. Prandaj duhet të shikojmë se si i përgjigjet Islami kësaj pyetjeje. Duke u nisur nga kjo ide, nëse do t'i shqyrtojmë mësimet e Islamit, gjejmë dy lloje njerëzish të këtij grupi. Disa të varfër vërtetë s'kanë para, por ata kanë pasuri tjetër. Kështu që ata mund të marrin hua duke lënë rehen një pjesë të pasurisë së tyre. Ndërsa janë edhe të varfër të tjerë që nuk kanë as para e as pasuri. Ose edhe nëse ata kanë pasuri, nuk janë në gjendje ta lënë rehen. P.sh. nëse një bujk që do të lërë rehen token e tij, ai s'ka ku të zhvillojë bujqësi. Për t'iu

shmangur këtyre situatave Islami vë zekatin si takse për të pasurit. Dhe nëse as taksa nuk ua mbulon nevojat të varfërve, atëherë të afërmit e tyre ose njerëzit e shoqërisë së tyre duhet t'u japin "hua të bukur"¹ dhe sipas ajetit "*Fanaziraton ila mejsira*" huamarrësve u duhet dhënë një afat i mjaftueshëm që ata të kenë mundësi për t'u përmirësuar ekonomikisht. Në këtë mënyrë mund të plotësohen nevojat e tyre dhe ata nuk do të kenë më nevojë për të marrë para hua me fajde.

Ata që thonë se nuk mund të zhvillohet bota pa fajde, e kanë gabim. Në kohën e es-habëve (shokëve) të Profet Muhammedit s.a.v.s., ata kishin fituar deri njëzet milionë rupi, por gjithmonë pa fajde, pasi ajo ishte e ndaluar për ta. Pra, është gabim që të thuash se pa fajde tregtia nuk mund të përparojë.

Islami e ndaloi fajdenë në një anë, por në anën tjetër nisi sistemin e zekatit dhe të trashëgimisë. Me anë të këtij sistemi, pasuria nuk mund të mbetet e përqëndruar vetëm te disa njerëz, apo te një fis. Por i pasur mund të bëhet vetëm ai që do të mundohet. Vetëm në këtë mënyrë nuk u mbetet peng të varfërve për të përparuar. Prandaj, urdhri i ndalimit të fajdesë është me shumë urtësi. Islami jo vetëm që e konsideron të papranueshme dhe të ligë fajdenë, por përdorimin e saj e quan të barabartë me luftën kundër Allahut dhe të Dërguarit

1 Islami e quan "hua të bukur" ("kerzah hasanah") atë borxh që jepet pa fajde dhe me kushte të lehta për t'u kthyer.

të Tij. Pra, e quan si një rebelim të madh dhe u thotë fajdexhinjve të përgatiten të luftojnë me Zotin.

Disa njerëz pyesin se nëse fajdeja është e ndaluar, atëherë në ditët e sotme, si mund të praktikohet ky mësim? Ata duhet të dinë se feja (Din) përbëhet nga një sistem i tërë normash, që mund të arrijë rezultate të mira vetëm atëherë kur do të zbatohet tërësisht. Nuk mund të shfaqet bukuria e tij e plotë, nëse ajo do të zbatohet pjesërisht. Sot, po t'iu flasësh njerëzve kundër përdorimit të kamatës, ata të thonë se s'mund të jetohet pa fajdenë. Dhe zakonisht ata kur e thonë këtë, nuk e kanë fjalën se shoqëria u bë aq e keqe, se çdo njeri është i detyruar që të marrë fajde, por ata kujtojnë se vetëm fajdeja është ajo që të shpëton nga vështirësitë. Realisht, fajdeja nuk është kyçi që zgjidh problemet e tyre, por në fakt, ajo është një sëmundje që e përhapit vetë njeriu, shërimi i së cilës gjendet në Islam. Por ky shërim kërkon një sistem që të funksionojë me të gjitha mekanizmat dhe nuk mund të arrihet derisa të mos zbatohet ai sistem; pra është si një shtëpi që nuk mund të jetë e përshtatshme për të banuar në të, derisa të mos ketë çatinë, muret e dritaret. Kështu që, mësimet e Islamit janë të tilla që nëse do të zbatohen nuk do ketë fare nevojë për fajdenë."

(Marrë nga "Tafsir-e-Kebir",
vol. 2, f. 629-634)

Përktheu: Samad Ghoori

Nga thëniet e Hazret Profetit Muhammed

paqja dhe bekimet e Allahut gjithmonë qofshin mbi të

Hazret Ebu Dherr r.z. përcjell nga Hazret Profet Muhammedi s.a.v.s.
dhe ai e transmeton nga All-llahu i Gjithëfuqishëm, që ka thënë:

“O robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar mizorinë Vetes dhe e kam ndaluar edhe ndër ju, prandaj mos i bëni mizori dhe dhunë njëri-tjetrit. O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të lajthitur, përveç atij që e përudh Unë, prandaj kërkoni udhëzim nga Unë, do t’ju përudhë. O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të uritur, përveç atij që e ushqej Unë, prandaj kërkoni nga Unë t’ju ushqej, do t’ju ushqej. O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të zhveshur, përveç atij që e vesh Unë, prandaj kërkoni veshje nga Unë, do t’ju vesh. O robërit e Mi! Vërtet ju gaboni natën dhe ditën, kurse Unë jua fal të gjitha mëkatet, prandaj kërkoni nga Unë falje, do t’ju fal. O robërit e Mi! Ju kurrë nuk mund të më shkaktoni dëm që të mundoheni për këtë dhe as kurrë nuk mund të më sillni dobi që të përpiqeni për këtë. O robërit e Mi! Sikur i pari nga ju dhe i fundit nga ju dhe njerëzit nga ju dhe xhinnët nga ju, të ishin të devotshëm, si zemra më e devotshme e njerit nga ju, kjo nuk do ta shtonte sundimin Tim në asgjë. O robërit e Mi! Sikur i pari nga ju dhe i fundit nga ju dhe njerëzit nga ju dhe xhinnët nga ju, të ishin të prishur, si zemra më e prishur e njerit nga ju, kjo nuk do ta pakësonte sundimin Tim në asgjë. O robërit e Mi! Sikur i pari nga ju dhe i fundit nga ju dhe njerëzit nga ju dhe xhinnët nga ju, të mblidheshin në një vend dhe të më kërkoni të plotësoja dëshirat tuaja dhe Unë ta plotësoja dëshirën e çdonjërit, kjo nuk do ta pakësonte atë që kam Unë përveç sa zë vend gjilpëra kur futet në det. O robërit e Mi! Çdo njëra nga veprat tuaja është e ruajtur dhe e llogaritur tek Unë. Unë do t’jua shpërblej ato, por varet nga veprat tuaja, të cilat tek Unë janë të ruajtura dhe të llogaritura, ndaj ato Unë do t’jua kthej juve të gjitha duke i shpërblyer. Pra, kush gjen mirë, le ta falënderojë Allahun, ndërsa kush gjen të kundërtën, mos ta fajësojë askënd përveç vetvetes”.

(Sahih Muslim,
Kitabul birri ves sila)



Hazret Ebu Hurejra r.z. rrëfen se Hazret i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Allahu i Lartësuar më ka treguar bukurinë dhe lavdërimet e Tij deri në atë shkallë që askush nuk është njoftuar kaq shumë përpara meje.”

(Sahihul Buhari, Kitabut Tefsir, Sure Isra)

Hazret Ebu Hurejra r.z. rrëfen se Hazret i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Çdo punë e rëndësishme nëse niset, pa përmendur lavdërimin e Zotit, ajo do të mbetet e pabekuar.” (Ibn Maxha, Ebuabun Nikah) Dhe në një rrëfim tjetër, që gjithashtu është nga Hazret Ebu Hurejra, ai thotë se Hazret i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Çdo punë nëse niset pa e thënë “Bismila hirrahmanirrahim-in”¹ ajo do të mbetet e mangët dhe e pabekuar.”

(El-xhamius segir lis Sujuti, Herfi Kaf)

¹ Do të thotë: “Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirëplotit”

Hazret Xherir bin Abdillahi rrëfen:

“Një herë, ne ishim ulur në shërbim të Hazret Profet Muhammedit s.a.v.s. Ishte natë. Hazret Muhammedi s.a.v.s. pa hënën që ishte e plotë dhe na tha: “Kështu ju do të shikoni edhe Krijuesin tuaj, siç po e shikoni hënën, pa asnjë pengesë. Nëse dëshironi ta arrini këtë (status) atëherë nuk duhet të përtoni për të falur namazin si para lindjes së diellit ashtu dhe para përëndimit të tij.”

(Sahihul Buhari,
Kitabut Teuhid ve rredidi
ala xhehimati ve gairihim)

Rrëfëhet nga Hazreti Ebu Hurejra r.z. se Hazret Profet Muhammedi s.a.v.s. ka thënë:
“Një njeri po shkonte diku, dhe rrugës ai pa një degë me gjemba. Ai e largoi atë nga rruga dhe Zoti i shprehu mirënjohje për veprën e tij dhe ia fali mëkatet atij.”

(Sahihul Buhari, Kitabul Mazalim)



*"Kjo pasuri është me vlerë
ta marrësh nëse e gjen
duke dhënë edhe jetën"*

**- Nga thëniet e
Hazret Mesihut të Premtuar a.s.**

Hazret Mirza Ghulam Ahmad
Themeluesi i Xhematit
Mysliman Ahmadi
Mesihu i Premtuar paqja qoftë mbi të

Hazret Mirza Ghulam
Ahmadi, Mesihu i Premtuar
dhe Themeluesi i Xhematit
Mysliman Ahmadi a.s. thotë:

*"Parajsa jonë është Zoti ynë.
Shijet tona më të larta gjenden në
Zotin tonë, sepse ne e pamë Atë dhe
çdo lloj bukuri e gjetëm në Të. Kjo
pasuri është me vlerë ta marrësh
nëse e gjen duke dhënë edhe jetën.
Dhe ky rubin është me vlerë ta
blesh edhe sikur të kushtojë sa e
gjithë qenia jote. O të humbur,
vraponi drejt këtij burimi se ky
do t'ju shuajë etjen tuaj. Ky është
burimi i jetës që do t'ju shpëtojë.
Ç'të bëj unë? Si mund ta gdhend
në zemrat e njerëzve këtë lajm
të gëzuar? Me ç'daulle t'i njoftoj
njerëzit se Ky është Zoti juaj? Dhe
me ç'ilaçe t'ua kuroj veshët që ata
të fillojnë ta dëgjojnë?"*

(Kashti Nuh, Ruhani Khazain,
vol. 19, f. 21-22, Londër, 1984)

*"Zoti i Islamit është po Ai Zot i Vërtetë, i
cili pasqyrohet gjithashtu në faqen e natyrës
dhe të instinktit. Islami nuk ka paraqitur
ndonjë zot të ri, por ai ka paraqitur po atë
Zot, që paraqesin edhe drita e zemrës së
njeriut, ndërgjegjja e tij dhe i gjithë ky univers."*

(Tablig-e-Risalat, vol. 6, f. 15)

*"Shpirti ynë dhe çdo grimcë e trupit tonë i bën
sexhde (përulet) Atij Zoti të Plotfuqishëm, të
Vërtetë e të Përsosur, me dorën e të cilit është krijuar
çdo shpirt dhe çdo thërmijë e të gjitha krijesave
me të gjitha aftësitë e tyre, dhe nga Qenia e të cilit
është varur çdo qenie tjetër. Asnjë gjë nuk është
jashtë dijes së Tij, jashtë kontrollit apo krijimit të
Tij. Gjithashtu, mijëra selame, bekime dhe mëshira
qofshin mbi Profetin e shenjtë Hazret Muhammed
s.a.v.s., nëpërmjet të cilit e gjetëm Atë Zot të Gjallë, që
Vetë na tregon shenjën e Tij duke komunikuar me ne,
dhe duke na treguar mrekulli të jashtëzakonshme, na
del i shndritur me fuqi dhe me veti të Tij të përsosura
e të përhershme. Pra, ne e gjetëm atë Profet që na
tregoi Zotin neve dhe e gjetëm Atë Zot që krijoi
gjithçka me fuqinë e Tij të përsosur. Sa madhështore
është krijimtaria e Tij, pa të cilin nuk mund të marrë
jetë asnjë qenie dhe pa mbështetjen e të cilit asgjë nuk
mund të qëndrojë!. Ai Zoti ynë, është shumë Besnik,
shumë Bekues, shumë i Fuqishëm, shumë i Bukur dhe
tejet Mirëbërës. S'ka zot tjetër përveç Atij."*

(Ruhani Khazain vol. 19,
Nasim-e-Da'vet, f. 363, Londër, 1984)

XHEMATI MYSLIMAN AHMADIA

NJË PARAQITJE



Shahid Ahmad Butt

Islami, Profeti i shenjtë ^{savs} dhe Kurani i Madhërishëm

Islami, që do të thotë “paqe” dhe “bindje ndaj dëshirës së Allahut” është feja me përhapjen më të shpejtë në botë. Ajo u themelua nga Profet Muhamedi (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) para 1400 vjetësh në Arabi. Profet Muhamedi ^{savs} mori një shpallje nga Zoti, në të cilën atij i'u tha që Islami ishte feja e fundit dhe e përsosur për të gjithë njerëzimin. Profeti i Shenjtë ^{savs} tha se vetëm Allahut i takon adhurimi dhe askush nuk i përngjan Atij. Muhamedi ^{savs} përkrahu të varfrit, i çliroi skllëverit dhe i vendosi të drejtat e barabarta për gratë. Ai udhëzoi pasuesit që të jenë të durueshëm gjatë vuajtjeve dhe t'i luten Allahut. Qëllimi i tij ishte të zhdukte të keqen dhe padrejtësinë (të ligën) dhe të rrënjoste mirësinë dhe besimin në botë. Muhamedi ^{savs} kaloi një jetë të thjeshtë, të pastër dhe të qetë. Ai ishte i famshëm për gatishmërinë e tij për të ndihmuar të varfrit, dhe kështu fitoi titujt *sidik* (dmth. i vërtetë) dhe *amin* (dmth. i ndershëm).

Kurani i Madhërishëm është libri i shenjtë i Islamit. Në të është fjala e Allahut dhe që Ai ia zbriti Muhamedit ^{savs} brenda një periudhe prej 23 vjetësh.

Ai përmban 30 kapituj dhe 114 sure. Në të gjenden një varg i gjerë mësimesh dhe një kod gjithëpërfshirës për sjelljet e njeriut. Kurani gjithashtu përmban një mori paralajmërimesh, shumë prej të cilave tashmë janë plotësuar, ndërsa një pjesë mbetet ende për t'u plotësuar.

Islami beson në të gjithë profetët e mëdhenj që erdhën nga Zoti i Madhërishëm, në kohëra të ndryshme dhe vende të ndryshme, duke përfshirë Muhamedin, Ibrahimin, Musain, Isain, Krishnan, Budën, Konfucin dhe Zarathustran (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ata). Sipas Islamit, të gjithë këta ishin prijësit shpirtëror që ishin dërguar në këtë botë, për t'i reformuar njerëzit dhe për të vendosur lidhjen e tyre me Zotin, Krijuesin e tyre. Prandaj, Islami kërkon të vendosë paqen midis të gjitha feve, duke dëshmuar të vërtetën e mësimëve të tyre të vërteta. Islami gjithashtu thekson se femrat dhe meshkujt janë të barabartë para Zotit, dhe vetëm nga veprat e tyre të drejta varet pozita e tyre në raport me njeri tjetrin. Islami nënvizon fuqishëm konceptin e humanizmit, dhe respektin ndaj lirisë personale. Gjithashtu Islami përkrah të drejtën elementare të njeriut,

për të qenë i lirë në zgjedhjen e fesë, siç është përmendur në Kuran që nuk ka forcë në çështjen e besimit.

Xhemati Mysliman Ahmadia


Pasuesit e të gjitha feve prisnin me padurim ardhjen e atij, Të Premtuarit në Ditët e Vona, siç ishte përmendur në librat e tyre të shenjtë. Pasuesit e fesë hindu prisnin ardhjen e Krishnas, ndërsa të krishterët dhe çifutët përgjonin arritjen e Mesiut, budistët me padurim prisnin mbërritjen e Budës kurse Myslimanët po prisnin Imam Mehdiun si dhe Mesihun. Sipas udhëzimit të Zotit, Hazret Mirza Ghulam Ahmadi bëri këtë deklaratë të rëndësishme, se në fakt do të vinte vetëm një njeri duke përfaqësuar të gjithë këta të Premtuar dhe njerëzia do të mbledhej përfundimisht nën flamurin e fesë universale. Hazret Ahmadi, ^{alehiselam} (Allahu qoftë i kënaqur me të) themeluesi i Xhematit Mysliman Ahmadia, pohoi se




ishte po ai i Premtuar, ardhja e të cilit po pritej në mbarë botën dhe kjo pritje po trashëgohej brez pas brezi në të gjitha fetë.

Që nga themelimi i tij, Xhemati Mysliman Ahmadia ka lulëzuar dhe ka përparuar me hov të pandalshëm në të gjithë botën përballë të gjitha pengesave, vuajtjeve dhe mizorive. Kjo na mëson Islamin e vërtetë, me gjithë dëlirësinë e tij. Islami është feja e paqes dhe dashurisë. Ajo është një fe shumë e thjeshtë, por jashtëzakonisht e organizuar për të plotësuar kërkesat e nevojat, dhe për të ballafaquar sfidat e një bote gjithnjë në ndryshim. Islami nuk lejon në asnjë mënyrë shfrytëzimin (mashttrimin), qoftë ai shoqëror, politik, ekonomik ose fetar. Ai beson tërësisht në parimet morale, zbatimin e drejtësisë dhe në ndërgjegjshmërinë në të gjitha sferat e interesave njerëzore. Xhemati Mysliman Ahmadia ka qëndrim të palëkundur që, Islami është përgjigjja e të gjitha problemeve dhe sëmundjeve prej të cilave po vuan sot shoqëria njerëzore.






HAZRET MIRZA GHULAM AHMAD
Mesihu i Premtuar *paqja qoftë mbi të*



HAKEEM MAULVI NOORUDDIN r.a.
Kalifi i Parë i Mesihut të Premtuar



**HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN
MAHMOOD AHMAD r.a.**
Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar

Islami na mëson që përderisa njeriu nuk mëson të jetojë në paqe (harmoni) me veten dhe të tjerët, ai kurrë nuk do të arrijë të jetojë në paqe me Zotin e tij. Në Islam, ju do të përfitoni paqen, kënaqësinë dhe qetësinë shpirtërore, e cila është fryt i bindjes ndaj pëlqimit të Allahut.

Xhemati Mysliman Ahmadia ka një shtrirje ndërkombëtare globale, që shkon në më shumë se 193 vende në Afrikë, Amerikë, Australi dhe Europë etj.


Anëtarësia e kësaj bashkësie ndërkombëtare tashmë është me miliona dhe po shtohet nga dita në ditë. Vetëm në vitin e kaluar (d.mth. nga gushti i vitit 2007 deri në korrik të vitit 2008) më shumë se 300 mijë njerëz u anëtarësuan në këtë xhemat. Si dhe gjatë kësaj periudhe Xhemati ka përruruar 351 xhami të reja nga të cilat jehon mesazhi i dashurisë, humanizmit, dashamirësisë, mirëkuptimit, drejtësisë dhe harmonisë në të gjitha anët e botës. Në vitin 2008 Xhemati përruroi Xhaminë *Baitul Nur* në Kalgari, Kanada, e cila është xhamia më e madhe e Amerikës Veriore, si dhe Xhaminë *Hatixhe* në Berlin, Gjermani po ashtu xhamia e parë e këtij Xhemati në Gjermaninë Lindore. Sot kjo bashkësi fetare është më dinamike dhe më progresive në të gjithë botën. Prej anëtarëve të bashkësisë shquhen fituesi i çmimit nobel në fushën e fizikës (i ndjeri dr. Prof. Abdul Salam) dhe një kryegjykatës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë dhe sekretar i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (i ndjeri Sir Muhammad Zafrullah Khan). Shumë anëtarë janë tregtarë të suksesshëm, pedagogë, akademikë, inxhinierë, mjekë, avokatë dhe profesionistë të tjerë por pjesa dërrmuese i përket jetës modeste të

përditshme.


Megjithatë, niveli i sakrificës ndër anëtarët është i pakrahasueshëm. Anëtarët e Xhematit dallohen në të gjithë botën për zbatimin e ligjit, si njerëz paqësor, punëtor të mëdhenj dhe qytetar dashamirës në të gjithë botën.

Xhemati që kujdeset...


Xhemati ka ndërtuar shkolla të përgjithshme për të gjithë në shumë vende të botës. Disa prej tyre janë bërë ndër shkollat më të njohura dhe më të respektuarat në ato vende. Xhemati Mysliman Ahmadia shquhet për kontributin e tij në zhvillimin shoqëror, dhe në përmbushjen e kërkesave mjekësore dhe arsimore, jo vetëm të anëtarëve të vet por edhe të atyre shoqërive në të cilat ndodhet ai. Xhemati po ashtu ka hapur shumë spitale dhe klinika mjekësore, që ofrojnë shërbimin mjekësor falas për nevojtarët. Në Afrikë, iniciativa të tilla iu kanë shërbyer popujve vendas, për shumë dhjetëvjeçarë. Xhemati ka marrë shumë nisma shoqërore për të përkrahur zhvillimin e vendeve të ndryshme në Afrikë dhe Azi, dhe duke ndihmuar të prekurit e luftrave dhe të fatkeqësive natyrore në vende si India, Japonia, Turqia, Bosnja dhe Kosova. “Humanity First” (*Humanizmi në radhë të parë*) është një organizatë bamirësie ndërkombëtare, e themeluar nga Xhemati Mysliman Ahmadia për të përkrahur dhe për të ruajtur dinjitetin dhe jetën njerëzore. Është një shoqëri jo politike, pa përkatësi sektare, një organizatë ndërkombëtare për bamirësi dhe zhvillim, që bashkëpunon me shoqëritë vendase në të gjithë botën, për përmirësimin e jetës në disa nga vendet më të prapambetura dhe më të varfra. Anëtarët e bashkësisë janë angazhuar në shërbim të njerëzimit, me një përkushtim të jashtëzakonshëm,



HAZRET HAFIZ MIRZA NASIR AHMAD r.t.a.
Kalifi i Tretë i Mesihut të Premtuar



HAZRET MIRZA TAHIR AHMAD r.t.a.
Kalifi i Katërtë i Mesihut të Premtuar



HAZRET MIRZA MASROOR AHMAD a.b.a.
Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar

me vetëmohim të lartë dhe përmes devotshmërisë dhe dashamirësisë.

Botimet

Xhemati në vazhdimësi bën botime, përkthime dhe publikon literaturë që mundëson një kuptim më të mirë të Islamit dhe përkrah dialogun e mirëkuptimit ndërfaqet; duke përfshirë këtu edhe botimin e revistës mujore që themeloi vet Hazret Ahmadi alehiselam - *The Review of Religions*. Xhemati gjithashtu tashmë ka botuar përkthimet e Kuranit të Madhërisë, në më shumë se 68 gjuhë të botës duke përfshirë edhe botimet në gjuhët kineze, ruse, japoneze, gjermane dhe italiane.

përmeshur të gjitha ato paralajmërimet rreth reformatorit të Premtuar të ditëve të vona. Ky ishte zëri i Hazret Mirza Ghulam Ahmadit. Përparimi i Ahmadiatit është bekuar me sistemin e kalifatit - sistemi shpirtëror i udhëheqjes në Islam. Pasardhësi i parë i Hazret Mirza Ghulam Ahmadit ^{Alehis-selam} ishte Hazret Moulvi Nooruddin ^{r.a.} (Allahu qofte i kënaqur me të), i cili ishte studiues i njohur i Kuranit dhe mjek i shquar. Në vitin 1914 pas vdekjes së tij, ai u zëvendësua nga Hazret Mirza Bashiruddin Mahmood Ahmad ^{ra} (Allahu qofte i kënaqur me të) - një studiues i thellë në fushën e Islamit, që gjithashtu kishte njohuri të gjera rreth feve të tjera. Ai qëndroi në krye dhe udhëhoqi xhematin për 51 vjet dhe hodhi themele të forta që xhemati të njihet si një bashkësi ndërkombëtare.



Tubimi Vjetor në Mannheim, Gjermani, 2001

Ahmadia- Islami i vërtetë

Para një qind vjetësh, një ngjarje e jashtëzakonshme zuri vend në Kadian - në një fshat të vogël të Indisë. Ishte një ndodhi që ishte paracaktuar të ndërronte kahen e historisë përgjithmonë. Nga ky fshat i vogël, u ngrit një zë që shpalli se ishte Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu, dhe ardhja e tij kishte

Ai e mori shpalljen se ai do të jetë ushtari i Allahut, mbështjellë në pallto të Profetëve të ndryshëm, që do të thotë se cilësitë, detyrat dhe forcat shpirtërore të të gjithë reformatoreve të mëdhenj, ardhja e të cilëve ishte paralajmëruar, do të shkrihen në qenien e tij. Ai deklaroi se, Zoti e ka përzgjedhur Islamën për shfaqjen e unitetit të tij përfundimtar dhe të gjithanshëm. Pasardhësi i tretë ishte

Hazret Mirza Nasir Ahmad ^(Allahu e mëshiroftë), një arsimtar i dalluar i cili theksoi rëndësinë e shërbimit ndaj vendeve afrikane. Pas tij, në vitin 1982 u zgjodh Hazret Mirza Tahir Ahmadi pasardhësi i katërt.

Gjatë udhëheqjes së tij, mësimet e bukura të Islamit ai i paraqiti në shkallë të gjerë botërore, me anë të planeve të shumta për t'i plotësuar kërkesat e shekullit XXI, duke përdorur metodat më

të efektshme përfshirë hapjen e kanalit unik satelitor të MTA-së. Në vitin 2003, kur ai ndërroi jetë, disa nga personalitetet më të shquara botërore shprehën ngushëllime për të. Madje për kortezhin e funeralit të tij dhe për masa të tjera përkatëse, autoritetet civile ndihmuan në çdo hap dhe kështu i bënë nderime të posaçme, duke i mbajtur protokoll zyrtar këtij udhëheqësi të madh dhe të respektuar.

Xhemati Mysliman Ahmadi tashmë po kalon momente të arta nën udhëheqjen e Kalifit të pestë, Hazret Mirza Masroor Ahmad ^(Allahu e ndihmoftë), i cili po mban këtë bashkësi në një tërësi të vetme. Ai siguron se çdo hap i hedhur nën drejtimin e tij do të jetë i sigurt dhe me synim për të arritur misionin e Mesihut të Premtuar ^{Alehiselam}. Kalifi mban të ngulitur në vëmendje çështjen e përhapjes së imazhit të vërtetë të Islamit - të kësaj feje paqësore.

Islami sot...

Islami do të jetë feja sunduese në këtë mijëvjeçar të ri. Mësimet e bukura të Islamit janë aq të përshtatshme për kohën e sotme, ashtu sikurse ishin gjatë



Xhamia "Betul Evvel", Tiranë, Shqipëri

jetës së Profet Muhamedit ^{savs}. Islami është një fe me shtrirje universale. Islami me udhëzimet e tij të përpikta, që burojnë nga Kurani i Madhërishëm dhe përmes modelit të shkëlqyeshëm të Profet Muhamedit ^{savs}, i përshtatet plotësisht natyrës së njeriut dhe ambientit të tij.

Tubimi vjetor (Xhelsa Salana)

Më 27 dhjetor 1891 u mbajt tubimi i Xhematit Mysliman Ahmadi në Kadian, Indi, në të cilin morën pjesë 75 persona. Tubimi pati sukses të gjithanshëm dhe themeluesi i Xhematit Mysliman Ahmadi, bëri të ditur se një tubim i tillë tregues do të mbahet çdo vit. Tubimi vjetor tashmë është një nga pjesët më interesante të kalendarit të Xhematit, që mbahet rregullisht çdo vit në data të ndryshme e në vende të ndryshme të botës. Qëllimi i këtyre tubimeve është të shqyrtohen arritjet e Xhematit gjatë çdo viti, si dhe të përfitohet nga diskutimet dhe fjalimet që mbahen nga Kalifi dhe dijetarë të shquar, që trajtojnë tema rreth Zotit, Islamit, Ahmadiatit, feve krahasimtare, problemeve ekonomike, shoqërore dhe politike si dhe zgjidhjeve

të tyre. Myslimanët Ahmadi që marrin pjesë në këto tubime, vijnë nga të gjitha vendet e botës. Ata shfrytëzojnë këtë rast, jo vetëm për të shtuar diturinë fetare dhe energjinë shpirtërore, por edhe për të ringjallur miqësi të vjetra. Mijëra njerëz që marrin pjesë në këto tubime shpirtërore kanë mundësi të dëgjojnë fjalimet e personaliteteve të shquara si dhe të atyre të ftuarve jomyslimanë. Në vitin 2008 më shumë se 40 mijë njerëz nga 85 vende të botës, morën pjesë në tubimin vjetor të Anglisë, ndërsa numri i pjesëmarrësve në tubimin vjetor të Gjermanisë tejkaloi 37 mijë.

Islami nënkupton “PAQE”

Sot ne jetojmë në një botë e cila është mjaft e ndikuar nga reportazhet e mediave. Fotografitë, shkrimet, titujt e ndryshëm dhe lajmet mund të paraqesin nocione dhe mendime jo të sakta me shumë lehtësi se sa të tregojnë fakte. Ndonëse reportazhi jo i drejtë dhe informacioni jo i saktë, nuk i përket gjithmonë fushës fetare, por përshkrimi i pasaktë i parimeve të vërteta të ndonjë feje mund të shkaktojë paragjykime, armiqësi dhe padrejtësi. Pasqyrimi i paqartë dhe i anshëm për Islamin, është mjaft i përhapur në këto vitet e fundit, veçanërisht në lidhje me terrorizmin dhe luftën. Perceptimi dhe botëkuptimi i qartë dhe i vërtetë për Islamin mund të gjendet vetëm në mësimet e tij thelbësore, dhe një studim i tillë mund të zbulojë se Islami jo vetëm që e urren dhe mohon dhunën, por në fakt inkurajon dhe i jep shtysë paqes në të gjitha sferat madje edhe gjatë konfliktit të luftës.

Islami është një fe e përsosur dhe gjithëpërfshirëse. Ai percepton që për shkak të dobësisë së njeriut, ambicies dhe dinamizmit luftarak, do të kemi raste kur mosmarrëveshjet, konfliktet madje edhe luftërat do të jenë të pashmangshme. Megjithëse Islami

ndalon nisjen e luftës dhe agresionin ushtarak, por kur lufta mbrojtëse bëhet e pashmangshme për myslimanët, Islami vendos udhëzime të rrepta për t'u zbatuar. Për shembull liria dhe të drejtat e qytetarëve jo-ushtar duhen mbrojtur në çdo rast. Të moshuarit, gratë, fëmijët nuk duhet të pësojnë asnjë dëm gjatë luftës. Vendbanimet nuk duhen dëmtuar si dhe prodhimi dhe prona duhet të mbeten të paprekura.

Në fund, për të shmangur keqkuptimin që emri i xhematit ka prejardhje nga emri i themeluesit, po shtjellojmë këtë me fjalët e vet Hazret Ahmadit ^{Alehiselam}. Ai shkruan:

Emri, që i përshtatet këtij Xhemati dhe që ne parapëlqejmë për t'u quajtur, është Myslimanët e Xhematit Ahmadia. Ne kemi zgjedhur këtë emër sepse Profeti i shenjtë ^{sav} kishte dy emra, Muhamed dhe Ahmed. Emri Muhamed personifikonte madhështinë, ndërsa emri Ahmed mishëronte atributin e bukurisë.

Zoti krijoi kushte të tilla në jetën e Profetit të shenjtë ^{sav} në Mekë, që gjatë asaj periudhe të shfaqeshin tiparet e emrit Ahmed, ku myslimanët u këshilluan që të ishin të durueshëm dhe të qëndrueshëm. Ndërsa gjatë kohës sa jetoi në Medinë u shfaqën tiparet e emrit Muhamed dhe Allahu me urtësinë e Tij vendosi të mposhte kundërshtarët e tij. Por ishte edhe një profeci, që emri Ahmed do të manifestohej përsëri në ditë të vona, në kuptim që do të vijë një person përmes të cilit do të shfaqen cilësitë e bukurisë që karakterizojnë emrin Ahmed, dhe të gjitha luftërat do të marrin fund. Për këtë arsye u mendua që emri më i përshtatshëm për këtë Xhemat, duhej të ishte Xhemati Ahmadia, që kushdo vetëm duke dëgjuar këtë emër të kuptojë që ky Xhemat është themeluar për të përhapur paqen dhe sigurinë dhe që nuk ka të bëjë fare me luftën dhe konfliktin.”

[Tabligh-e-Risalat, vol. IX, f. 90-91]

MESAZHI

I HAZRET MIRZA MASROOR AHMADIT,
KALIFIT TË PESTË TË MESIHUT TË PREMTUAR,
ME RASTIN E NJËQIND-VJETORIT TË KALIFATIT AHMADIA
(1908-2008)

Me emrin e Allahut

të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirëplotit

Me bekimin e Zotit dhe mëshirën e Tij

Të dashurit e mi anëtarët e Xhematit,

*Es-selamu alejkum ve rrahmetullahi ve
barakatuhu¹*

Sot, më 27 maj 2008, mbushen plot njëqind vjet të Kalifatit Ahmadia. Kjo ditë na kujton historinë e Xhematit Mysliman Ahmadia, një histori më shumë se njëqind vjeçare, dhe gjithashtu edhe kohën kur sipas profecisë së Profetit të shenjtë ^{s.a.v.s.}, një shërbëtor i zgjedhur i Allahut, nën urdhrin e Tij, në mars të vitit 1889, bëri shpalljen për themelimin e këtij Komuniteti të shenjtë.

Objektivat e misionit të tij dhe ato të themelimit të Xhematit ishin që: të vendosej marrëdhënia midis Zotit dhe njeriut; t'u mësohej njerëzve që t'i përuleshin Zotit të Vetëm; të përpiqeshin për vendosjen e Njeshmërisë së Tij në botë dhe t'i bashkonin të gjitha kombet e botës në një *umet*; të mblidhte të gjithë njerëzimin nën flamurin e Profetit të shenjtë ^{s.a.v.s.} dhe të tërhiqte vëmendjen e njerëzimit në njohjen dhe respektimin e të drejtave reciproke të njeriut.

Personi, të cilin Zoti ia dërgoi botës nën titujt Imam Mehdi dhe Mesih i Premtuar, ka përmbushur me sukses misionin e tij me ndihmën dhe mbështetjen e Allahut për pothuajse nëntëmbëdhjetë vjet, që nga themelimi i Xhematit në vitin 1889 deri në vitin 1908, kur ai ndërroi jetë. Përkundër të gjitha llojeve të kundërshtive dhe situatave të pafavorshme, çdo kundërshtar që iu kundërvu këtij kampioni të Allahut, përjetoi vetëm poshtërim dhe turp.

Sipas ligjeve të Allahut, çdokush që vjen në këtë botë do të iki prej saj. Ky shërbëtor i zgjedhur i Allahut dhe i dashuruar i vërtetë i Profetit të shenjtë ^{s.a.v.s.}, gjatë gjithë jetës së tij i mbeti besnik praktikës së mësuesit të tij (Hazret Muhamedit ^{s.a.v.s.}), me padurim për ta takuar Mikun e tij më të Lartin (Allahun). Ndërsa Allahu i Plotfuqishëm, që e dërgoi shërbëtorin e Tij si Udhëheqës të ditëve të vona, duke e informuar për kohën e vdekjes së tij që po iu afrohej, e ngushëlloi dhe e siguroi se, edhe pse vdekja i ishte afruar, Ai nuk do ta linte misionin e tij të pa përmbushur. Sepse në përputhje me deklarin e Tij vetë Zoti e ngriti atë si Imam të ditëve të vona: *O i dashuri Im! Ti që je tepër i shqetësuar për vendosjen e Unitetit Tim në botë dhe sovranitetit të Profetit Tim të dashur, mos e vra mendjen se si do të përmbushet misioni yt pas vdekjes sate. Kujto,*

¹ Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

se sipas profecisë së Profetit ^{s.a.v.s.}, që është autorizuar prej Meje, Kalifati mbi gjurmët e profetizmit do të vendoset dhe do të vazhdojë deri në fundin e botës. Kështu që pasi ti të kesh ndërruar jetë, do të jetë ky institucion i Kalifatit me anë të të cilit Unë do ta nis edhe njëherë planin për vendosjen e Sheriatit Tim të fundit në botë. Pas kësaj garancie nga Allahu i Plotfuqishëm, Mesihu i Premtuar ^{s.a.v.s.} duke iu drejtuar Xhematit shkroi:



Hazret Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar duke dhënë mesazhin e tij me rastin e njëqind-vjetorit të Kalifatit Ahmadia, në Excel Centre të Londrës, më 27 maj 2008.

“Është praktika e Allahut, që është në veprim që kur Ai e ka krijuar njeriun mbi tokë, që Ai gjithmonë ndihmon të dërguarit dhe profetët e Tij duke u dhënë atyre epërsi dhe fitore mbi të tjerët, siç thotë në Kuranin e Shenjtë:

“Allahu ka vendosur se Ai dhe të Dërguarit e Tij do të ngadhënjë.”

(El-Muxhadila 58:22)

Dhe këtu “ngadhënjim” do të thotë se ashtu siç dëshirojnë profetët dhe të dërguarit e Tij që Vullneti i Zotit të vendoset në tokë dhe askush të mos ketë mundësi ta kundërshtojë atë. Po ashtu Allahu i Madhërishëm me shenjat e Tij të fuqishme, e nxjerr në dritë të vërtetën e tyre si dhe të vërtetën që ata dëshirojnë ta përhapin në botë, dhe u krijon atyre mundësinë që ta mbjellin farën e saj me duart e tyre. Megjithatë, Ai nuk e lë atë të japë frytet e plota në duart e tyre, por Allahu i merr profetët nga kjo botë në një moment që duket se misioni i tyre dështoi, duke u dhënë kështu mundësi kundërshtarëve të tallen e të qeshin me profetët. Dhe pasi të jenë ngopur së talluri, atëherë Allahu e shfaq fuqinë e Tij të dytë dhe krijon ato mjete për mes të cilave, misioni i tyre, që kishte mbetur deri diku i paplotësuar, të plotësohet deri në fund. Me një fjalë, fuqia e Allahut manifestohet dy herë.

Së pari, Ai e shfaq fuqinë e Tij përmes duarve të të Dërguarit të Tij.

Dhe së dyti, kur, pas vdekjes së profetit, besimtarët përballen me vështirësi të mëdha, dhe armiku ndjehet i fuqishëm, duke menduar se tani gjithçka ka përfunduar, dhe është i bindur se tashmë ky Xhemat (bashkësi) do të zhduket nga faqja e dheut. Edhe vetë anëtarët e Xhematit fillojnë të frikësohen të dëshpërohen duke u ndjerë të dobët e të papërkrahje, madje disa prej tyre të pafat, e braktisin edhe fenë. Atëherë, Allahu për të dytën herë e shfaq fuqinë e Tij madhështore dhe e merr nën kujdesin e Tij Xhematin, që ishte gati të rrëzohej.

Pra, ai që duron deri në fund, e sheh këtë mrekulli të Zotit. Siç kishte ndodhur në kohën e Hazret Ebu Bekër Sidikut ^{r.z.}, kur vdekja e Profetit të shenjtë ^{s.a.v.s.} u konsiderua e parakohshme dhe shumë beduinë injorantë e braktisën fenë. Edhe es-habët (shokët) e Profetit të shenjtë ^{s.a.s.}, të goditur nga pikëllimi i vdekjes së tij, u bënë si të çoroditur. Atëherë, Allahu e ngriti Ebu Bekër Sidikun ^{r.z.} dhe e shfaqti për të dytën herë fuqinë e Tij, dhe kështu Islami që dukej se po rrëzohej, u ndihmua nga Ai duke e përmbushur kështu premtimin e Tij të dhënë në Kuranin e Shenjtë:

“Pas frikës Ne do t’i vendosim fort ata.”

(En-Nur 24:57)

(Ruhani Khazain, vol. 20, Elvesijet, f. 304-305)

Mandej Themeluesi i Xhematit Ahmadia thotë:

“Pra, të dashur miq! Sikurse shihet ka qenë gjithmonë praktika e Allahut, që Ai t’i shfaqë dy mrekulli të Fuqisë së Tij, në mënyrë që të shkatërrohen dy gëzime të rreme të armiqve. Prandaj është e pamundur që Allahu ta ndryshojë tani këtë praktikë të Tij të vjetër. Prandaj, mos u pikëlloni nga kjo që po ju them e as mos t’ju lëshojnë zemrat tuaja, sepse është e domosdoshme për ju që ta shihni manifestimin e dytë gjithashtu. Dhe ardhja e saj është më e mirë për ju, sepse ajo do të jetë e përhershme dhe nuk do të përfundojë deri në Ditën e Gjykimit. Por ai manifestimi i dytë nuk do të mund të ndodhë para se unë të largohem. Pasi unë të kem shkuar, atëherë Allahu do t’ju dërgojë juve manifestimin e dytë të Fuqisë së Tij, që do të mbetet përgjithmonë me ju. Siç është premtuar nga Allahu në **“Berahine Ahmadia”**² se ky premtim nuk është për mua, por është për ju, se siç thotë Allahu: Unë do ta bëj këtë Xhemat, që janë pasuesit e tu, mbizotërues mbi të gjithë të tjerët deri në ditën e Gjykimit.

Pra, është e pashmangshme që ju do ta shihni ditën e largimit tim, kështu që, pas asaj dite, do të vijë për ju dita e premtimit të amshueshëm. Zoti ynë është Ai që e mban premtimin e Tij dhe është shumë Besnik dhe i Vërtetë. Ai do t’ju tregojë të gjitha ato që jua ka premtuar. Edhe pse këto janë ditët e fundit të botës, dhe ka shumë fatkeqësi që pritet të ndodhin, megjithatë, është e domosdoshme që kjo botë të vazhdojë të ekzistojë deri sa të përmbushen të gjitha ato, të cilat Allahu jua ka premtuar.

Unë erdha nga Allahu si manifestim i Fuqisë së Tij dhe jam mishërim i fuqisë së Allahut. Dhe pas meje do të ketë persona të tjerë që do të jenë manifestim i dytë i fuqisë së Tij. Andaj, ju të gjithë bashkë priteni manifestimin e dytë të fuqisë së Tij, duke u angazhuar në lutje.”

(Ruhani Khazain, vol. 20, Elvesijet, f. 305-306)

2 “Berahin-e-Ahmadia” është një libër i famshëm i Hazret Mesihut të Premtuar^{a.s.} Katër vëllimet e para të tij u botuan gjatë viteve 1880-1882.

Më në fund, koha erdhi dhe ai ndërroi jetë për t’u prehur pranë Allahut të Plotfuqishëm. Dhe siç e kishte thënë ai, zemrat e gjithë ahmadianëve u

mbushën me frikë dhe pikëllim. Por, për shkak të lutjeve të besimtarëve, toka dhe qielli edhe një herë dëshmuan përmbushjen e premtimit të Allahut (në Kuranin e Shenjtë) se: “Ai me siguri, pas frikës, do tu japë atyre siguri dhe paqe”, (En-Nur 24:56) sikurse ishte dëshmuar edhe në fillim të Islamit. Revolucionin e madh që Hazret Mesihu i Pretuar^{a.s.} solli me ardhjen e tij, Allahu i Plotfuqishëm dëshoi që ta vazhdonte nëpërmjet Institucionit të Kalifatit. Me vdekjen e Hazret Mesihut të Premtuar^{a.s.}, Maulana Abdul Kalam Azadi (një jo-ahmadian, dijetar i kohës) shkroi në gazetën “Wakil”:

“Ai njeri, një njeri shumë i madh, pena e të cilit ishte magjike dhe fjalët e të cilit ishin magjepsë, njeriu që ishte personifikimi i mrekullive të mendjes, shikimi i të cilit ishte magjik dhe zëri i të cilit ishte boria e ringjalljes, gishtat e të cilit ishin të lidhur me telat e revolucionit, grushtet e të cilit ishin si dy bateri të ngarkuara me elektricitet, njeriu që për tridhjetë vjet shkaktoi një tërmet dhe stuhi në botën e fesë, që tingëlloi si trumbeta e ditës së gjykimit dhe vazhdoi t’i zgjonte ata që ishin në gjumin e thellë të vdekjes... Vdekja e Mirza Ghulam Ahmad Sahibit të Kadianit, nuk është diçka prej së cilës njeriu nuk nxjerr ndonjë mësim dhe mund të durojë, thjeshtë duke e lënë këtë ngjarje si një histori e kaluar. Njerëzit që shkaktojnë revolucione në botën fetare dhe intelektuale, nuk shfaqen shpesh. Këta bij të mëdhenj të historisë, krenaria e njerëzimit, e vizitojnë shumë rrallë botën, dhe kur vijnë, sjellin një revolucion në të”

(Gazeta “Wakil”, Amritsar; Tarikh-e-Ahmadiyyat, Vol.2, f. 560)

Kështu, Allahu i Plotfuqishëm, duke i bërë jo-ahmadianët që të pranojnë këtë revolucion me gjuhët dhe penat e tyre, tregoi se Mesihu i Premtuar^{a.s.} kishte një mbështetje dhe ndihmë të veçantë

nga Allahu i Madhërishëm. Por, ata nuk e kuptuan që Zoti i Plotfuqishëm, sipas premtimit të Tij, këtë revolucion do ta vazhdonte me anë të Institucionit të Kalifatit. E gjithë bota ishte dëshmitare e kësaj të vërtete, në kohën kur u zgjodh Hazret Maulana Nuruddini ^{r.z.} si Kalif i Parë i Mesihut të Premtuar ^{a.s.}. Pavarësisht nga fakti se kundërshtarët e Mesihut të Premtuar ^{a.s.} ishin dëshmitarë të një komuniteti të organizuar dhe solid, të themeluar prej tij, dhe ishin dëshmitarë të themelimit të Kalifatit, ata bënë përpjekje të organizuara t'i jepnin fund këtij Xhemati, Xhematit që u themelua nga Zoti i Plotfuqishëm, dhe për të cilin Ai na kishte premtuar:

“Kujtoje mirësinë Time. Unë, me dorën Time, e kam mbjellë për ty pemën e mëshirës dhe fuqisë Sime”.

(Tadhkirah, f. 428)

Kështu, në përputhje me këtë premtim, ata dështuan në planet e tyre si gjithmonë, megjithëse tepruan aq shumë me kundërshtimin dhe egërsinë e armiqësisë së tyre sa që një gazetë e kohës shkruante:

“Nëse na pyet ndokush, atëherë ne themi se po të ishte e mundur për myslimanët, ata duhet t'i hedhin librat e Mirza'it (të Hazret Mesihut të Premtuar a.s.) jo në oqean por në furrat e djegies; dhe nuk duhet ta lënë këtë çështje këtu, por të sigurohen që në të ardhmen asnjë historian mysliman dhe jo-mysliman nuk duhet t'ia përmendë emrin në historinë e Indisë dhe të Islamit”.

(“Wakil”, Amritsar, 13 qershor 1908)

Por, sot historia e Ahmadiatit është dëshmitare e faktit – dhe e gjithë bota e di këtë – se askush nuk i mban mend ata kundërshtarë të Ahmadiatit, ndërsa me bekimet e Kalifatit, Xhemati po lulëzon në botë, dhe miliona njerëz e kanë pranuar me përkushtim Ahmadiatin.

Armiqtë e Ahmadiatit i kaluan kufijtë e diskutimeve të tyre absurde deri në atë pikë sa që një gazetë e kohës, t ë



cilën

e citoi

edhe Hazret

Kalifi i Parë i

Mesihut të Premtuar a.s.

në fjalimin e pare të Tubimit Vjetor, shkruan:


“Tani asgjë nuk u kambetur më përkrahësve të Mirza'it. Koka e tyre u pre. Si Imam i tyre është zgjedhur një njeri, që nuk është i aftë të bëjë asgjë tjetër përveç t'u mësojë atyre Kuranin në xhami.”

(Curzon Gazette, Tarikh-e-Ahmadiyyat, vol. 3, f. 221)

Duke e komentuar këtë, Hazret Kalifi i Parë ^{r.z.} tha:

“Subhanallah (Lavdia i takon Allahut), kjo është detyra ime më e rëndësishme. Më dhëntë Allahu mundësinë që ta përmbush këtë detyrë me sukses.”

Për fat të keq, edhe disa anëtarë të shquar të Xhematit nuk e vlerësuan statusin e Kalifatit. Komplete vazhduan të kurdiseshin prej tyre, por pema e mbjellë nga dora e Zotit vazhdoi të rritej.



Xhematit iu desh të përballej me vuajtje të mëdha dhe kundërshtime të rrepta, por me bekimet e Kalifatit, ai vazhdoi përpara me sukses. Mjafton t'u hedhësh një vështrim pesëdhjetë viteve të Kalifatit të Hazret Kalifit të Dytë^{r.z.}, për të parë se sa mbresëlënëse ishin arritjet e këtij biri të Kampionit të Allahut – Mesihut të Premtuar^{a.s.}.

Pas vdekjes së Hazret Kalifit të Dytë, frika i kaploi përsëri anëtarët e Xhematit, por Allahu, sipas premtimit të Tij, duke e zëvendësuar këtë frikë me paqe dhe siguri, në pak orë i dhuroi Xhematit hënën e shndritshme të manifestimit të tretë (Kalifatit të Tretë). Përkundër kundërshtimit të qeverive të asaj kohe dhe përpjekjeve të bashkuara dhe të organizuara të të gjithë sekteve myslimane (përpara dhe pas aprovimit të një ligji mizor kundër ahmadianëve), karvani i Ahmadiatit vazhdoi të ecte duke kaluar kufij të ri të progresit, duke i dhënë botës mesazhin e dashurisë, duke u shërbyer të varfërve të vendeve të ndryshme dhe duke e përcjellur mesazhin e Profetit Arab^{s.a.v.s.} e duke i mbledhur ata nën flamurin e tij.

Pastaj erdhi koha, që sipas vendimit Hyjnor, Hazret Kalifi i Tretë^{r.a.} gjithashtu u largua nga kjo botë për ta takuar Krijuesin e tij. Përsëri edhe një herë pati ç'rregullime dhe djallëzira nga jashtë dhe brenda. Por, në përputhje me Premtimin Hyjnor, Xhemati Mysliman Ahmadi u konsolidua dhe u fuqizua përsëri nëpërmjet Kalifatit të Katërt; dhe djallëzitë e intrigat përsëri dështuan.

Allahu i Plotfuqishëm i shkatërroi ata që vendosën kushtëzime ndaj Xhematit

Sipas premtimit të Allahut që iu bë Mesihut të Premtuar^{as}, Xhemati i vogël i pasuesve të devotshëm të tij, vazhdoi të rritej dhe asnjë përpjekje për ta dëmtuar atë nuk pati sukses.

Pastaj, kur erdhi koha e Kalifatit të Dytë, disa anëtarë të mirënjohur, që u përmendën më lart, në mënyrë të hapur dhe të vendosur e kundërshtuan Institucionin e Kalifatit. Por, të gjithë këta njerëz me besim të tepruar në vetvete dhe krenarë për diturinë, përvojën dhe arsimimin e tyre, nuk mundën të përballeshin me një djalë të ri 25 vjeçar (Kalifi i Dytë). Në të vërtetë, i tillë ishte statusi i tij i lartë, sa që askush nuk mund t'ia kalonte apo të barazohej me të në mënyrën se si ai e organizoi Xhematin, si në fushën e përhapjes së mesazhit, të edukimit shpirtëror dhe moral të anëtarëve, apo në diturinë e thellë të Kuranit të Shenjtë. Shumë herë

përmes një ligji të padrejtë e mizor, me zotimin për ta çrrënjosur një herë e përgjithmonë “kancerin e Ahmadiatit”. Për shkak të këtij ligji, që u miratuar nga qeveria e Pakistanit, Kalifi i kohës u detyrua të emigronte. Por, ky emigrim hapi horizonte të reja për progresin e Ahmadiatit. Edhe një here ne, me sytë tanë pamë përmbushjen e premtimit të Allahut në favor të Xhematit të Tij. Tani, rrugë të reja për punën misionare ishin hapur; gjë që dikur dukej vetëm si një mundësi e largët.

Gjatë Kalifatit të Katërt, Allahu i Madhërishëm, përmes MTA-së (Muslim Television Ahmadiyya – Kanali televiziv i Xhematit Mysliman Ahmadi), përmbushi premtimin e Tij ndaj Hazret Mesihut të Premtuar ^{a.s.}:

“Unë do ta çoj mesazhin tënd deri në skajet e botës.”

Nëse i shikojmë mundësitë tona të kufizuara dhe mënyrën se si ky kanal televiziv e filloi punën e tij, fjalë falënderimi dhe lartësimi ndaj Allahut të Gjithëfuqishëm burojnë natyrshëm nga zemrat dhe gjuhët tona. Sot, ky kanal, nga Lindja në Perëndim dhe nga Veriu në Jug, i ka bërë të heshtin të gjithë kundërshtarët e Ahmadiatit. Kështu, Zoti i Madhërishëm, përmes MTA-së, e çoi zërin e njeriut të Tij, me mesazhin e së Vërtetës, nëpër shtëpitë e atyre që dëshironin shkatërrimin e tij. Sot, me ndihmën e Allahut, përmes MTA-së, ushqimi shpirtëror i Sheriatit të fundit të Zotit të Plotfuqishëm – Kuranit të Shenjtë si dhe të Hazret Mesihut të Premtuar ^{a.s.}, po arrin në çdo cep të botës.

Në përputhje me ligjin që përmendet në ajetin: “Çdo gjë që ekziston në tokë është e vdekshme.” (Al-Rrahman 55:27), Hazret Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar



Ahmadianët duke dëgjuar mesazhin e Udhëheqësit të tyre shpirtëror

ndërroi jetë. Në atë kohë e gjithë bota dëshmoi se sytë e kamerave të MTA-së transmetuan një skenë në çdo shtëpi nëpër botë. Skena ishte e mrekullueshme si për ahmadianët, ashtu edhe për jo-ahmadianët. Ahmadianët gëzoheshin duke parë që Zoti i Plotfuqishëm e zëvendësoi frikën e tyre me paqe dhe siguri, ndërsa të tjerët pyesnin veten, se si ishte e mundur që këta njerëz dhe ky Xhemat që ata ishin përpjekur për ta shkatërruar për njëqind vjet, vazhdoi të përparonte dhe të lulëzonte kështu! Një kundërshtar haptazi pranoi: “Unë nuk besoj që ju jeni në rrugë të drejtë, por pasi e kam parë këtë, më duhet të pranoj se Zoti, me veprimet e Tij, ka dëshmuar se është me ju.”

Allahu i Plotfuqishëm e ka bashkuar të gjithë Xhematin në dorën e një njeriu si unë, modest dhe jo shumë i ditur. Për çdo ditë, marrëdhënia midis meje dhe Xhematit bëhet gjithnjë e më e fortë. Bota mendoi se ndoshta unë nuk do të isha në gjendje të kujdesesha për Xhematin, dhe se ata së shpejti do ta shihnin fundin e tij, të cilin po e prisnin prej 100 vjetësh. Por, ata harruan se kjo pemë është mbjellë nga dora e Allahut të Plotfuqishëm. Asnjë qenie njerëzore nuk është përgjegjëse për mbjelljen dhe lulëzimin e saj, përkundrazi, vepron premtimi dhe mbështetja e veçantë e Allahut. Ai e përmbushi premtimin që i

bëri Mesihut të Premtuar^{as} në shpalljen;

“Unë jam me ty dhe me ata që ti i do”.

Pra, ky është dekreti Hyjnor, ky është premtimi i bërë nga Ai Zot, i cili nuk bën premtime të rreme. Ata të dashur të Mesihut të Premtuar^{a.s.}, që në përputhje me udhëzimet e tij, e përqaftuan manifestimin e dytë të fuqisë së Allahut (sistemin e Kalifatit), gjithmonë do të kenë epërsi mbi botën, sepse Zoti është me ta, Zoti është me ne.

Sot, mbushen 100 vjet nga manifestimi i dytë i Fuqisë së Allahut - Kalifatit. Dhe çdo ditë po përjetojmë, me një shkëlqim të ri, përmbushjen e premtimeve të përmendura më lart që Allahu ia ka bërë Mesihut të Premtuar^{as}. Prandaj është detyrë e çdo ahmadiani, që duke qëndruar të bashkuar dhe të lidhur ngushtë me Kalifatin, të përpiket me të gjitha aftësitë e tij, që ta përmbushë misionin e shenjtë të Hazret Mesihut të Premtuar^{a.s.}.

Sot, ne duhet ta sjellim të gjithë Krishterimin nën flamurin e Profetit të shenjtë^{s.a.v.s.}, ne duhet t'i sjellim edhe hebrenjtë nën flamurin e tij dhe të gjithë hindutë si dhe ndjekësit e të gjitha feve të tjera nën flamurin e tij. Ne gjithashtu duhet t'i bashkojmë të gjithë myslimanët përreth Kalifatit Ahmadia, në dorën e Mesihut të Premtuar dhe Imam Mahdiut^{a.s.}.

Prandaj, o ahmadianë që jetoni në të gjitha anët e botës, përqendrohuni fort në këtë synim kryesor që e përmenda më lartë dhe përmbusheni detyrën që Udhëheqësi (Imami) i Kohës, Mesihu dhe Mahdiu^{a.s.} jua ka besuar me urdhër të Zotit. Ai, duke thënë se “*ky premtim është për ju*”, ka vendosur mbi ne një përgjegjësi

të madhe. Premtimet përmbushen vetëm atëherë, kur të zbatohen edhe kushtet e vendosura me to.

O besimtarë të Mesihut të Muhammedit! O ju që jeni të dashur të Mesihut të Premtuar^{a.s.} dhe degë të lulëzuara të pemës së qenies së tij! Ngrihuni! Jini gati të bëni çdo sakrificë që kërkohet për përforcimin e mëtejshëm të Kalifatit Ahmadia, kështu që duke u mbajtur fort pas *litarit të Allahut*, ju mund të shpërndani në të gjitha anët e botës mesazhin e Profetit të shenjtë^{s.a.v.s.}, mësuesit të Mesihut të Premtuar^{a.s.}. Gjithashtu, përcilljani mesazhin çdo njeriu të botës, se mbijetesa e tyre varet nga vendosja e një marrëdhënieje të vërtetë me Zotin që është Një dhe i Vetëm. Paqja e botës varet nga të pranuarit e Xhematit të *Mahdiut* dhe të Mesihut, sepse sot vetëm ai është mësuesi i mësimave të vërteta të Islamit që sjellin paqe dhe siguri, shembulli i të cilave nuk gjendet në faqen e dheut.

Përmbushja e misionit të Mesihut të Muhammedit^{s.a.v.s.} dhe bashkimi në besimin e një të Vetmit Zot, sot mund të arrihet vetëm duke qëndruar i lidhur me Kalifatin Ahmadia. Kjo është mënyra, nëpërmjet së cilës, njerëzit e Zotit do të sjellin një revolucion shpirtëror në botë.

I mundësoftë Allahu çdo ahmadiani që t'ia përçojë, me besim të paluhatshëm, këtë realitet të bukur çdo njeriu në botë. Amin!

Vesselam (Paqja qoftë me ju)

Mirza Masroor Ahmad

Khaliftul Mesihu V

(Kalifi i V i Mesihut të Premtuar)

Përktheu: Erald Bezhani

PAQJA SHOQËRORE EKONOMIKE

HAZRET MIRZA TAHIR AHMAD, KALIFI IV I XHEMATIT MYSLIMAN AHMADIA

Shembulli i atyre që shpenzojnë pasurinë e tyre, për të kërkuar pëlqimin e Allahut dhe që e forcojnë veten me punë të mira, shëmbëllojnë me një kopsht të mbjellë në rrafshnaltë, në të cilin bie shi i bollshëm, andaj jep fruta dyfish. Nëse nuk bie shi i bollshëm, i mjafton vesa e imët. Allahu i sheh mirë punët që bëni ju.

(Kurani i Madhërishëm 2 : 266)

U është hijeshuar njerëzve dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, thesaret e ruajtura të arit dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e përkohshme të kësaj jete, por shumë më i mirë është strehimi tek Allahu.

(Kurani i Madhërishëm 3 : 15)

Përmbledhje

Islami gjithashtu ka fjalë këshilluese lidhur me ato fusha ku horizontet e shoqërisë takohen me ato të ekonomisë. Nëse këto mësimë zbatohen, ato mund të shndërrojnë ditët tona të errësuar në të ndritshme.

DREJTËSIA EKONOMIKE NË KAPITALIZËM, SOCIALIZËM DHE NË ISLAM

Drejtësia ekonomike është slogan i bukur. Qoftë shoqëria kapitaliste që mbështet tregun e lirë, ose doktrina e shoqërisë socialiste që e përkrah materializmin dialektik: të dy ngrenë të njëjtin slogan.

Në një anë sistemi imperialist mëton se vetëm ai vendos drejtësinë shoqërore, ndërsa në anën tjetër socializmi shkencor shpreh të njëjtat pretendime. Më vjen keq por më duhet ta shpreh druajtjen time, se të dyja kanë dështuar në vënien e drejtësisë sipas principeve të arta të drejtësisë ekonomike; por më në detaje këtë çështje do ta diskutojmë më vonë.

Në Islam parimi i drejtësisë mban vend mbizotërues dhe sundues. Ky parim sundon në çdo aspekt të mësimëve Islamike, por kjo nuk është e gjitha. Islami hedh një hap edhe më përpara.

Socializmi shkencor, bën përpjekje të nivelojë krejtësisht dhe përsosmërisht reliefin ekonomik që të mos ketë ulje-ngritje në rrafshin ekonomik, të zhduket ndryshimi midis shtresës së varfër dhe të pasur, dhe të gjithë të përfitojnë nga pasuria shtetërore. Të varfër nuk do të ketë më në shoqëri dhe as nuk do të ekzistojë më çështja e nevojave. Pra edhe të pasurit, që gëzojnë të gjitha të mirat materiale, nuk do të kenë frikë nga shtresa e ulët, se mos ua “grabisin” “pasurinë e tyre të tepërt”.

Në shoqëritë kapitaliste, flitet më shumë për mundësitë e barabarta dhe tregjet e lira, se sa për shpërndarje të drejtë të pasurisë. Prandaj, në një shoqëri të tillë, gjithmonë shtrohet nevoja për të

mbrojtur të drejtat dhe krijimin e grupeve sindikaliste¹ që gjithmonë kërkojnë që të merren vesh me qeveritë dhe kapitalistët për përkrahjen e punonjësve dhe nëpunësve, që jetojnë gjithmonë nën ndjenjën e humbjes.

Nëse socializmi shkencor është i zbatueshëm teorikisht në shoqëri, atëherë nuk do të ketë më nevojë që një shtresë e shoqërisë të paraqesë kërkesa. Ose kjo shoqëri do të jetë mjaft e pasur, dhe do ta shpërndajë pasurinë shtetërore sipas nevojave, në mënyrë të drejtë, ose do të jetë aq e varfër dhe në këtë mënyrë do të dështojë në përmbushjen e nevojave, dhe secili do të bëhet pjesë e këtyre vuajtjeve. Gjithsesi, kjo do të përfundojë si një shoqëri ku kërkesat dhe nevojat nuk luajnë një rol të rëndësishëm.

Nga ana tjetër, sistemi kapitalist,

drejtohet nga kërkesat-nevojat. Shtresës së pafavorshme të shoqërisë, i duhet dhënë patjetër e drejta, për të shprehur pakënaqësinë dhe mundësia për t'u dëgjuar zëri i tyre: dhe si rrjedhim do të formohen grupime që do të kundërshtojnë, do të zhvillojnë greva, do të shkaktohen mosmarrëveshje në prodhimet industriale dhe do të ketë mbyllje të fabrikave etj.

Islami bën përpjekje të krijojë një qëndrim, përmes të cilit qeveritë dhe të pasurit, rikujtohen vazhdimisht që është në interesin e tyre, të themelojnë një sistem të drejt ekonomik. Ai gjithashtu i këshillon ata që të kujdesen për të drejtat e të tjerëve. Njerëzve të dobët dhe të varfërve, nuk duhet t'u mohohen të drejtat e tyre ekonomike si liria për të zgjedhur zanatin, mundësitë e barabarta dhe nevojat elementare të jetesës. Mungesa e këtij atributi ka sjellë mjaft vuajtje, dhimbje dhe mosmarrëveshje

¹ Sindikata: grupet e punonjësve të organizuara që mbrojnë të drejtat e tyre përballë punëdhënësve. (shënim i përkth.)



Hazret Kalifi IV r.a. duke mbajtur fjalimin e tij *“Përgjigjet e Islamit ndaj çështjeve bashkëkohore”* në Sallën e Konferencës së Mbretëreshës Elisabetë II, në Londër më 24.02.1990.

në historinë e luftës së njeriut për të mbijetuar. Islami i vë theks në mënyrë të veçantë *dhënies*, më shumë se sa *marrjes* ose *mbajtjes*. Qeveritë, si dhe të pasurit, vazhdimisht duhet të jenë sy hapur që shtresës së varfër të mos u mohohen të drejtat elementare. Një shtet i denjë islamik duke kuptuar nevojën do të marrë masa paraprake për t'i plotësuar ato të drejta. Para se dhimbja të shndërrohet në klithmë dhe protestë, dhe para se nevoja të kërcënojë paqen dhe qetësinë, shkaku i saj duhet gjetur, dhe kërkesa duhet përmbushur.

Për sa i përket plotësimit të nevojave, në këtë aspekt, islami shfaq karakteristika të njëjta me shoqërinë socialiste, por, në fakt, ngjashmëria është veçse sipërfaqësore. Islami e arrin objektivin, por jo përmes atyre metodave shtrënguese të socializmit. Nuk më lejon koha, të shpjegoj në hollësi se si Islami bën përpjekje të arrijë këtë synim të lartë por ne me pak fjalë, mund të përmendim se qëndrimi i islamit ndaj kësaj çështjeje, nuk është i thatë dhe mekanik, si filozofia e materializmit dialektik. Sistemi shoqëror i islamit është ndërthurur fort në psikikën e njeriut.

Ndër të tjera, Islami krijon një mjedis ku nevoja e të drejtave të dikujt, hap rrugën për kujdesin ndaj të drejtave të të tjerëve. Në këtë mënyrë, niveli i ndërgjegjshmërisë dhe i ndjeshmërisë së individit, ndaj vuajtjeve të shoqërisë njerëzore, ngrihet deri në atë shkallë, ku pjesëtarët e shoqërisë në tërësi, interesohen më shumë për detyrat që kanë ata ndaj të tjerëve, se sa shoqëria ndaj tyre.

“Jepi punëtorit më shumë se sa i takon atij”, është porosia e shpeshtë e Profetit të Shenjtë ^{savs} drejtuar pasuesve të tij.

“Jepi atij pagën para se t'i thahet djersa. Atyre që punojnë nën kujdesin tuaj mos u thoni që të bëjnë detyra që as ju vet nuk i bëni dot. Po të keni mundësi, ushqejini shërbëtorët tuaj, prej asaj me të cilën ushqeni familjen tuaj. Pajisini me rroba të njëjta. Mos i shkelni të drejtat e të dobëtëve, përndryshe do të përgjigjeni para Zotit. Për të mos rënë pre e krenarisë së gabuar, thirrini shërbëtorët tuaj herë pas here në sofër dhe shërbejuni.”²

SHPENZIMI PËR BAMIRËSI EDHE PSE NË

MJERIM

Dinjitetin njerëzor në të gjitha sferat e jetës, islami e vlerëson në shkallë më të lartë. Në ajete të mëposhtme islami paraqet etiketën morale, se si mund të plotësohen nevojat e shtresës së varfër dhe kërkesat e nevojtarëve. Për ata që sillen me dinjitet dhe që përvetësojnë norma morale të larta, Allahu u premton faljen e mëkateve.

... të cilët shpenzojnë (në rrugën e Allahut) edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin gabimet njerëzve. Allahu i do bamirësit.

(Kurani i Madhërishëm 3 : 135)

SHPENZIMI PËR TË VARFRIT

Zakonisht ajo që kuptohet nga lëmosha dhe *sadakaja* nënkupton dy aspekte. Në njërin anë vlerëson cilësitë e shkëlqyera të dhuruesit të lëmoshave; ndërsa në anën tjetër, kjo krijon një gjendje sikleti, nëse jo turpërimi, të pranuesi. Vetë veprimi i pranimit të lëmoshës është mjaft poshtërues. Islami e ndryshon rrënjësisht këtë qëndrim.

Ajeti i mëposhtëm, tregon arsyen se

² Burime të ndryshme të Hadithit

përse disa njerëz janë shumë të varfër, ndërsa disa të tjerët janë të pasur. Duke shqyrtuar thellësisht këtë çështje Kurani thotë:

Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.

(Kurani i Madhërishëm 51 : 20)

Ajo që zakonisht nuk merret parasysh, është përdorimi i fjalës “hak” (d.m.th. e drejtë), që flet me hollësi për sjelljen e dhuruesit, si dhe për qëndrimin e atij që merr lëmoshë. Dhuruesit, i rikujtohet (i bëhet me dije) se paratë që u jep të varfërve në fakt nuk i përkisnin atij. Nuk është në rregull me një ekonomi në të cilën disa njerëz të varfër janë të detyruar që të lypin, për të mbijetuar. Në sistemin e shëndoshë ekonomik, nuk duhet të ketë fare varfëri. Nuk ka asnjë justifikim që njerëzit ende të lypin, për të mbijetuar. Mesazhi që i kumtohet marrësit të lëmoshës, e kujton atë që nuk ka nevojë të shqetësohet ose të vuajë nga dëshpërimi moral, sepse Zoti i ka dhënë të drejtën themelore, të jetojë në mënyrë modeste dhe të ndershme. Prandaj, gjithçka që merrni nga një dhurues në fakt është e drejta juaj, dhe ajo ju përket juve.

Siç kam thënë edhe më parë, parimet hyjnore janë të ndërlikura drejtpërdrejtë me natyrën e njeriut. Çdo urdhër ose udhëzim, që mund ta prishë këtë ekuilibër, atëherë do të paraqiten masat korrigjuese.

MIRËNJOHJA

Në rastin e sapopërmendur sigurisht është edhe rreziku i qenësishëm që disa njerëz do të tregohen mosmirënjohës ndaj mirëbërësve. Në vend që t'ua shprehin mirënjohjen atyre, për ato

favore që kishin përfituar, ata mund t'iu drejtohen atyre duke u thënë se gjithçka që kishin marrë ishte e drejta e tyre. Nuk jemi të detyruar, në asnjë mënyrë, të falënderojmë dikë. Nëse kjo prirje dhe tendencë përkrahet, atëherë, nuk do të kemi më sjellje njerëzore dhe modeste në shoqërinë tonë.

Duke u kthyer te përfituesi i favoreve, Kurani i Madhërishëm ia rikujton herë pas here detyrat që të jetë mirënjohës, dhe ta shprehë mirënjohjen për çdo favor që i bëhet atij sado i parëndësishëm. Besimtari këshillohet vazhdimisht që Zoti kurrë nuk i do njerëzit mosmirënjohës.

Nëse ju dilni mosbesimtarë (mosmirënjohës), dini se Allahu është vërtet i pavarur prej jush. Megjithatë, Ai nuk është i kënaqur me mosmirënjohjen e robërve të Tij, por kënaqet me ju, nëse e falënderoni. Asnjë bartës nuk do të mbartë barrën e tjetrit. Pastaj, do të ktheheni te Zoti juaj e Ai do t'ju njoftojë për atë që keni bërë, sepse Ai e di vërtet fshehtësitë e zemrave tuaja.

(Kurani i Madhërishëm 39 : 8)

Në vazhdim, duke i kushtuar rëndësi të veçantë ndjenjës mirënjohëse, Profeti i shenjtë i islamit ^{savs} udhëzon pasuesit e tij duke thënë:

Ai që nuk u shpreh mirënjohje njerëzve, kurrë nuk tregohet mirënjohës ndaj Zotit.

Kjo na mëson, që një njeri që mund të jetë shumë mirënjohës ndaj Zotit, por që sillet me mosmirënjohje në marrëdhënie me njerëz të tjerë, Zoti, kurrë nuk do të pranojë mirënjohjen dhe përlulesinë e tij. Kështu që Mesazhi i Kuranit, nuk i shkuraizon aspak mirësjelljen, mirënjohjen dhe fisnikërinë, siç kemi parë në ajetin e mëparshëm. Por është një mesazh i heshtur, që i kumtohet marrësit që ai nuk duhet të vuajë nga kompleksi dhe as nuk duhen lënduar dinjiteti dhe krenaria e tij. Përfundimi do të ishte që

shprehja e falënderimit dhe mirënjohjes nuk është në kundërshtim të dinjitetit njerëzor por, përkundrazi, e ngre dhe e lartëson edhe më shumë atë.

Duke iu drejtuar dhuruesit, islami mban një qëndrim krejtësisht të kundërt. Ai thotë që pranimi i mirënjohjes, sikurse dhënësi e meritonte atë është kundër dinjitetit dhe përlësisë së tij. Ndonëse kjo prirje dhe tendencë vlerësohet si pjesa e kulturës së qytetëruar, dhe gjendet gjithandej, ka një dallim themelor nga kriteret e sjelljes njerëzore të paraqitura nga islami. Sipas islamit, kontribuuesi duhet t'i shërbejë njerëzimit për një qëllim më madhështor, dhe më të madhërishtëm, se sa të kënaqë dëshirën natyrore ose të fitojë lavdinë dhe famën me anë të bamirësisë. Islami thekson vazhdimisht, që nxitja dhe shtytja për të bërë vepra të mira duhet të burojnë nga përkushtimi ndaj Zotit, dhe i vetmi qëllim dhe synim duhet të jetë, që njeriu duhet të fitojë pëlqimin dhe bekimet e Zotit.

Kjo tregon që kur një mysliman i vërtetë i dhuron diçka dikujt në vështirësi, ai nuk e bën këtë për veten e tij, as për dikë tjetër, por vetëm me qëllim që të kënaqë Krijuesin e tij, i Cili i dha gjithçka që zotëron ai.

Sipas këtij parimi, gjithçka që shpenzon dikush për dikë tjetër, është në të vërtetë mënyra për të shprehur mirënjohjen e tij ndaj Zotit, dhe jo për t'i bërë favor dikujt. Ky qëndrim madhështor, ka rrënjën e tij në një nga ajetet e para të Kuranit, që i rikujton besimtarët duke thënë:

Ata japin nga ajo që u kemi dhënë Ne.

(Kurani i Madhërishtëm 2 : 4)

Prandaj, besimtari i vërtetë nuk pranon mirënjohje, vetëm për shkak të

mirësjelljes, por ai beson sinqerisht që nëse marrësi i bamirësive të tij, duhet të shprehë mirënjohjet, atëherë, është vetëm Zoti Ai që i takojnë falënderimet dhe askush tjetër. Besimtarët e vërtetë, të cilët dinë domethënien e besimit, gjithmonë bien në siklet të madh kur favoret e tyre u kthehen me falënderime.

Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob edhe pse vetë janë nevojtarë. duke thënë: "Ne ju ushqejmë vetëm për hir të pëlqimit të Zotit. Për këtë, nuk kërkojmë prej jush ndonjë shpërblim e as falënderim!

(Kurani i Madhërishtëm 76 : 10)

Nuk është e mjaftueshme vetëm t'i ushqesh ata, por duhet t'i ushqeni pasi ju vetë i dini mirë mundimet e varfërisë, dhe vuajtjet e mjerimit, dhe merrni pjesë nga dhembja e tyre, duke mos pritur asnjë shpërblim ose mirënjohje prej tyre.

Bukuria dhe joshja e këtij ajeti, është magjepsëse. Nëse besimtarëve do t'iu kërkohej të mbanin qëndrim sa për t'u dukur, dhe të mos pranonin mirënjohjen e marrësit, duke shfaqur përlësinë dhe modestinë artificiale, atëherë kjo do t'i jepte shtysë hipokrizisë. Kur ne përgjigjemi: Jo, s'ka gjë, ne në fakt dimë se duke vepruar kështu, figura jonë bëhet më madhështore në sytë e atij që i është bërë favor.

Mësimi i islamit ka madhësi të jashtëzakonshme. Dhuruesit, i rikujtohet që ai nuk mund t'ia shesë të njëjtin mall dy palëve të ndryshme. Puna bamirëse, mund të realizohet, ose për të fituar pëlqimin e Zotit, ose nga lakmia për nam të madh në shoqëri. Sipas këtij ajeti, njeriu nuk mund t'u nënshtrohet të dyja qëllimeve në të njëjtën kohë.

Kur robi besnik i Zotit i tregon nevojtarit që qëllimi i tij ishte të fitonte

pëlqimin e Zotit, ai gjithashtu i thotë atij që dhuruesi i vërtetë është Zoti i Madhërishëm. Prandaj, sa herë që lind ndjenja e inferioritetit, ajo zhduket po ashtu.

S'KA SHPËRBLIM PËR FAVORET

Sipas islamit, të qenët mirënjohës ndaj të tjerëve, nuk duhet të jetë dukuri sipërfaqësore që shfaqet si vlerë e civilizimit, por duhet të jetë ndjenja e fuqishme e rrënjosur thellë në besimin tek Zoti. Duhet të japim lëmoshë por pa asnjë lloj motivi për të fituar diçka nga marrësi.

Dhe mos bëj mirënjohje (ndaj dikujt), me synimin që të përfitosh më shumë

(Kurani i Madhërishëm 74 : 7)

Islami të udhëzon që, nëse dikujt i ke bërë favor, duhet ta harrosh atë sikur të mos kishte ndodhur një gjë të tillë. Nëse dikush mburret për favorin që i ka bërë dikujt, apo sillet me mospërfillje ndaj atij, dhe krenohet e vetëlavdërohet, sipas islamit, qëndrimi të tilla e prishin dhe asgjësojnë krejtësisht vlerën e bamirësisë, dhe janë kundër bamirësisë. Përkundrazi, besimtari i vërtetë sillet ashtu siç është përshkruar në ajetin e mëposhtëm, që krahason sjelljen e mirë me atë të gabuar në një shqyrtim të thellë.

Ata që shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugë të Allahut, i shëmbëllojnë një kokrrë nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kallë ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijsëm.

Ata që shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugë të Allahut, dhe nuk e përkujtojnë mirënjohjen e tyre dhe nuk e përcjellin atë me fyerje, do të kenë shpërblim të Zotit i tyre dhe nuk do të kenë as

frikë e as nuk do të pikëllohen.

Fjala e mirë dhe falja (e gabimit) janë më të vlefshme se lëmosha që përcillet me fyerje. Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë (nuk nxiton në dënime).

O ju besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke e shprehur mirënjohjen (atë të cilit keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit. Ai shëmbëllen me një shkëmb të lëmuar të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shiu me rrebeshe, duke e lënë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë, se Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues.

(Kurani i Madhërishëm 2 : 262-265)

Si edhe:

Dhe për sa i përket lypësit, mos e qorto.

(Kurani i Madhërishëm 93 : 11)

LYPJA

Madje edhe lypësit duhen trajtuar me mirësjellje. Mos i fol lypësit me fjalë të ashpra. Ndonëse, në përgjithësi lypja shkujarohet në Islam, por e drejta për të lypur kur je në vështirësi dhe në mjerim gjithashtu sigurohet. Jo vetëm kaq, islami gjithashtu siguron që askush të mos e lëndojë nderin e atij që detyrohet të lypë.

Në fillim të islamit, kur nderi i lypësit ruhej dhe mbrohej, shoqëria arriti të kuptonte se të mos lypësh, është pa dyshim më e mirë se sa të lypësh. Këtë krahasim Profeti i shenjtë ^{savs} e nënvizoi duke thënë:

*Dora e dhuruesit është më e mirë se sa e atij marrësit.*³

Si rezultat i këtij mësimi, një shumicë dërrmuese myslimanësh, parapëlqeu të vdiste në varfëri se sa të lypte ndihmë për

³ Buhari, Kitabuz Zakat, Babun La Sadakata illa 'An Zahri Ghinan

mbijetesën. Për plotësimin e kërkesave të tyre, Kurani i Madhërishëm rikujton gjithë shoqërinë, se ndër ata janë edhe ata që nuk po gjejnë shtegdalje nga varfëria.

(Lëmoshat) janë për të varfrit, të cilët u angazhuan tërësisht në rrugën e Allahut dhe nuk janë në gjendje të bredhin lirisht në vend. Njeriu mendjelehtë i konsideron ata si të pasur, për shkak se ata nuk lypin, ndërsa ti mund t'i njohësh me anë të pamjes së tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. Dhe çfarë pasurie ta shpenzoni, vërtet, Allahu e di mirë.

(Kurani i Madhërishëm 2 : 274)

Ky parim bëhet gjithnjë më i qartë nga ajeti i mëposhtëm:

Pasuria që Allahu i dhuroi Profetit të Tij prej plaçkave të banorëve të vendbanimeve, i takon: Allahut, të Dërguarit të Tij, të afërmeve, jetimëve, të varfërve, dhe udhëtarëve (të mbetur rrugës) me qëllim që ajo (pasuri) të mos qarkullojë vetëm ndërmjet pasanikëve nga mesi juaj. Dhe çfarëdo ju jep (urdhëron) Profeti, merreni, e çfarëdo ju ndalon, përmbahuni. Frikësojuni Allahut se vërtet Allahu është ndëshkues i ashpër.

(Kurani i madhërishëm 59 : 8)

I Dërguari i Allahut gjithashtu përmendi këtë parim të shëndoshë në një thënie (hadith):

Hazret Hakim bin Hizam (Allahu qoftë i kënaqur me të) rrëfen: - I Dërguari i Allahut ^{savs} tha: Dora e sipërme është më e mirë se dora e poshtme (domethënë ai që i jep dikujt lëmoshë është më i mirë se ai që e merr atë). Së pari njeriu duhet t'u japë atyre që varen prej tij. Gjëja më e mirë nga lëmosha është ajo që jep njeriu i pasur (domethënë nga pasuria që mbetet pas shpenzimeve). Cilido që përmbahet nga të lypurit të tjerëve ndihmë financiare, Allahu do ta sigurojë atë nga të lypurit të tjerëve, dhe do ta bëjë atë të pavarur.

(Buhari, Kitabuz Zekat, Babun La Sadakata illa 'An Zahri Ginan)

Ju keni përparësi në këtë shërbim, domethënë të jepni lëmoshë dhe t'iu shërbeni të tjerëve, dhe jo të qëndroni në palën e marrësit, duke përfituar nga lëmoshat dhe favorët.

ÇFARË MUND TË JEPET NË LËMOSHË?

Përveç mënyrës se si do të jepni, është e rëndësishme edhe se çfarë do të jepni. Sipas kritereve të përcaktuara nga Kurani, nuk mund të përfshihet në lëmoshë ajo që mund t'ju japë dikush juve, dhe që do t'ju vijë turp ta pranoni atë. Një veprim i tillë nuk mund të vlerësohet më shumë se sa të hedhësh mbeturina në kosh plehrash.

O ju besimtarë! Shpenzoni (sa keni mundësi) gjëra të pastra prej asaj (pasurie) që e keni përfituar ju dhe prej asaj që ju kemi furnizuar nga toka; dhe mos dhuroni diçka të keqe (për lëmoshë), të cilën ju nuk do ta kishit marrë për vete veçse symbyllur (nga turpi). Dhe ta dini se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë.

(Kurani i Madhërishëm 2 : 268)

Mbani mend që tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por tek Ai arrin vetëm devotshmëria dhe përkushtimi i zemrës suaj. Kështu Ai i vuri (kurbanet) në shërbimin tuaj që ta madhëroni Allahun, për shkak se Ai ju udhëzoi juve. Dhe jepu lajmin e gëzuar, punëdrejtëve.

(Kurani i Madhërishëm 22 : 38)

DHËNIA E LËMOSHËS HAPTAZI DHE FSHEHURAZI

Për islamin, të dyja variantet janë të pranueshme: të shpenzosh hapur ose në fshehtësi. Kurani i Madhërishëm na mëson:

Dhe çfarëdo që të shpenzoni (Për hir të Allahut) ose çka zotoni, Allahu, vërtet, e di atë; dhe keqbërësit nuk do të kenë ndihmëtarë. Nëse

lëmoshat do t'i jepni haptazi, është gjë e mirë; por është më e mirë dhe më e udhës që t'ua jepni të varfërve fshehurazi. Allahu me anë të këtyre lëmoshave do t'i shlyejë gabimet (gjynahet) tuaja. Dhe Allahu është i Vetëdijshëm për atë që bëni ju.

(Kurani i Madhërishëm 2 : 271,272)

PËRGJEGJËSITË SHOQËRORE

Islami e nënvizon si veti themelore, që autoritetet civile duhet të jenë shumë të ndjeshëm ndaj problemeve dhe ankesave të popullit, deri në atë shkallë sa nuk do të jetë nevoja për të formuar grupet që të ushtrojnë presionin për kauzën e tyre.

Sipas Kuranit të Madhërishëm, përgjegjësia bie mbi sunduesin, dhe ai është i përgjegjshëm para Zotit, për gjendjen e atyre njerëzve që janë të varur prej tij, dhe nën kujdesin e tij. Profeti i shenjtë ^{savs} ka thënë:

Secili prej jush i ngjan një çobani të cilit i takojnë delet. Ai është ngarkuar me përgjegjësi që t'i ruajë, kullotë dhe mbarësjtojë bagëtinë. Në të njëjtën mënyrë, jeni përgjegjës dhe do të jepni llogari.

(Buhari, Kitabun Nikah, Babun Al-Mar'atu Ra'ijatun fi Baiti Zauxhiha)

Kjo thënie, përfshin të gjitha marrëdhëniet dhe raportet më të larmishme, në të cilat njeriu mund të jetë përgjegjës për njerëz të tjerë p.sh pronari mbi shërbëtorët, bashkëshortja si e zonja e shtëpisë dhe babai si i zoti i shtëpisë; që të dy palët janë përgjegjës ndaj gjithë familjes; punëdhënësi është përgjegjës ndaj punonjësve që punojnë nën kujdesin e tij dhe kështu me radhë, dhe për çdo rast I Dërguari i Allahut ^{savs} rikujton duke përsëritur: *mbani mend që do të jeni të përgjegjshëm dhe do të mbani përgjegjësi.*

NJË SHEMBULL NGA HISTORIA E ISLAMIT

Një herë Hazret Umeri ^{Allahu qoftë i Kënaqur me të} Kalifi i Dytë r.z. në Islam, kalonte natën nëpër rrugicat e periferisë së Medinës. E kishte zakon që shëtiste nëpër rrugë në mënyrë të fshehur që të merrte vesh gjendjen e popullit nën kalifatin e tij. Duke kaluar afër një shtëpie, ai dëgjoi të qarat e fëmijëve që, si dukej, kishin një hall. Kur shikoi me vëmendje, ai pa që ishin tre fëmijë ulur rreth e qark zjarrit me nënën e tyre; ndërkohë mbi zjarr diçka po ziente në kazan. Si u afrua më shumë, ai e pyeti nënën e fëmijëve se: - Çfarë ka ndodhur? Ajo iu përgjigj: -“Fëmijët e mi po vdesin nga uria, dhe unë nuk kam gjë që të shuaj urinë e tyre. E kam bërë kastile që të qetësohen. Në kazan kam futur ca gurë në ujë që këta të mendojnë se po gatuhet buka. Kjo është që po shikoni.”

Pushtuar nga hidhërimi dhe dhimbja e thellë, Umeri ^{Allahu qoftë i Kënaqur me të} u kthye menjëherë në magazinat e shtetit, gjeti pak miell, gjalpë, mish dhe hurma arabe dhe i futi në thes. Më pas ai i tha shërbëtorit që ai t'ia ngarkonte atij këtë thes. Ai e pyeti se përse kalifi donte ta çonte atë thes vetë dhe iu lut që t'ia shpinte vetë ai shërbëtori. Umeri ^{Allahu qoftë i kënaqur me të} i tha: - “Pa dyshim sot ti mund të marrësh këtë barrë për mua, po kush do të ma mbartë barrën time në ditën e gjykimit?” Domethënë ai shërbëtor, në ditën e gjykimit, nuk do të jetë në gjendje të përgjigjet se si i kreu detyrat Umeri ^{Allahu qoftë i kënaqur me të}. Këtë duhet të bënte ai vetë. Ishte edhe një lloj pendese e vetëimponuar, sepse ai e ndjeu veten përgjegjës për vuajtjen e asaj familjeje. Ai mendoi se të gjitha çështjet e qytetit i përkisnin atij, dhe ai ishte përgjegjës i

drejtpërdrejtë për këto çështje ndaj këtë detyrë duhej ta plotësonte vetëm ai.

Është e pamundur të ndiqet modeli i Umerit Allahu qoftë i Kënaqur me të në mënyrë shabllone por ai mbetet përgjithmonë një shembull frymëzues, qëndrese dhe sjelljeje. Ky është ai frymëzim dhe shpirt, që duhet ndjekur kudo nga shoqëritë moderne. Nëse qeveritë do të bëhen të ndjeshme ndaj problemeve dhe vuajtjeve të popullit, atëherë, ata që janë në pushtet do të detyrohen të marrin masat parandaluese, para se qytetarët të fillojnë të tregojnë dhimbjen e ndjenjën e tyre të humbjes, por jo duke u frikësuar nga sloganet dhe presioni i tyre por nga zëri shtytës i ndërgjegjes.

KUFIJTË E ZGJERUAR TË SHPENZIMIT

Kurani i Madhërisëm zgjeron kufijtë e asaj që duhet shpenzuar në rrugë të Allahut, dhe e zgjeron hapësirën e saj. Ne në Kuran ndeshemi shpeshherë me një shprehje, që vështirë se gjendet tjetërkund:

...dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne.

(Kurani i Madhërisëm 2: 4)

Kjo mbulon të gjitha zotësitë dhe cilësitë, dhe padyshim të gjitha llojet e pronësisë, apo marrëdhëniet dhe raportet njerëzore. Kjo thënie gjithashtu përfshin të gjitha vlerat si nderin, paqen dhe prehjen etj.

Shkurt, asgjë nuk mbetet jashtë kufirit të domethënies së shprehjes arabe: *ve mim-ma rezeknahum* (d.m.th. nga ajo që u kemi dhënë Ne).

Përsëri, është për t'u habitur se si përdorimi i fjalës *min*, (kuptim leksikor prej, nga) përgjithëson këtë këshillë për secilin. Kjo, nuk do të thotë që ju duhet të shpenzoni gjithçka, ose një pjesë të

caktuar, prej asaj që Ne ju kemi dhënë; përkundrazi, këtu kërkohet që ju duhet të shpenzoni diçka prej asaj që ju ka dhënë Zoti. Në fakt, sfera e fjalës *diçka*, është aq e gjerë dhe gjithëpërfshirëse, sa që mundëson çdo njeri të varfër, që nuk ka mundësi ose fuqi të bëjë sakrifica të mëdha, të mund të marrë pjesë në çfarëdo shkalle që i lejon vetes. Kjo është atmosfera dhe mjedisi i shërbimeve shoqërore që paraqet Islami, dhe bën përpjekje për të realizuar. Kjo i përket pjesërisht sjelljes shoqërore të njeriut si dhe në njëfarë mase veprimtarisë së tij financiare.

Në një ekonomi, ku gjithë shoqëria drejtohet nga dëshira për të zotëruar diçka, dhe kujdeset vetëm për atë që i takon asaj, është mjaft vështirë, bile gati e pamundur të heqësh vijën ndarëse midis asaj që është shkëlja e rregullave dhe asaj që përfaqëson të drejtën. Pritet përgjithësisht që kufijtë e shoqërisë së tillë, në vend që të qëndrojnë në vend të palëvizshme, do të futen në territorin e të drejtave të të tjerëve.

Në anën tjetër, shoqëria, që kujtohet vazhdimisht t'u japë të tjerëve më shumë se sa i përket asaj, do të jetë larg nga uzurpimi i të drejtave të të tjerëve. Është vështirë të përfytyrosh se si mund të mbijetojë shfrytëzimi në kushte të tilla.

SHËRBIMI NDAJ TJETRIT

Pikëpamja e Islamit rreth shërbimit ndaj shoqërisë, është përmbledhur në mënyrë koncize në ajetin e mëposhtëm ku përshkruhet:

Ju jeni populli më i mirë që është ngritur për të mirën e tërë njerëzimit: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni prej veprave të këqija dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e

Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; disa prej tyre janë besimtarë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.

(Kurani i Madhërishëm 3 : 111)

Do të mbeteni më i mirë derisa jeni i ndërgjegjshëm ndaj shërbimit të të tjerëve. Nëse dështoni në shërbimin ndaj të tjerëve, atëherë, nuk do të keni më të drejtën për të mburrur epërsinë dhe superioritetin e Islamit dhe të pasuesve të tij.

NDALIMI I PËRDORIMIT TË ALKOOLIT DHE I BIXHOZIT

Kur dikush flet për *addiction* (vesin, huqin) ai ka parasysh vetëm përdorimin e drogave. Por fjala *addiction* ka një domethënie më të gjerë, që rrallë lidhet me këtë fjalë. Unë i referohem këndvështrimit të shoqërisë, në lidhje me mënyrat e caktuara të argëtimit, p.sh. pirja e alkoolit dhe lojëra e fatit, që asnjëherë nuk ndjellin diçka të mirë, për paqen dhe qetësinë e shoqërisë.

Sot lojërat e fatit, po ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyre të organizuar, gati në të gjitha vendet e zhvilluara të botës. Ndërsa, në vende që i përkasin Botës së Tretë, ndonëse kazinotë nuk veprojnë në shkallë të gjerë, kumari gëlon në çdo nivel si një punë e parëndësishme individuale. Pirja e alkoolit është huqi i dytë ku sot shoqëritë e botës kanë rënë pre.

Kurani i Madhërishëm i ndalon të dy, si kumarin, ashtu dhe pirjen e alkoolit.

O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!

Vërtet, djalli me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe

kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?

(Kurani i Madhërishëm 5 : 91)

Profeti i shenjtë ^{savs} e quajti pirjen e alkoolit *umul khebais* d.m.th. *nëna e gjithë të zezave*.

Këto dy prirje, janë shtrirë aq gjerësisht, dhe kanë një karakter thellësisht të përgjithshëm sa është vështirë të vësh kufi midis tyre, për të përcaktuar se ku ndahet njëra prej tjetrës. Politikisht, Lindja dhe Perëndimi nuk do të bashkohen kurrë, por për sa i përket prirjes së madhe ndaj bixhozit dhe pirjes së alkoolit, Lindja dhe Perëndimi, si dhe Veriu dhe Jugu, janë bashkuar tashmë.

Pirja e alkoolit dhe bixhozi, që të dy janë sëmundje shoqëro-ekonomike. Paratë që shpenzohen për të pirë pijet dehëse për një ditë në Angli, janë të mjaftueshme për të ushqyer turma të mëdha njerëzish për disa javë, në vendet afrikane të prekura nga kriza e urisë. Sidoqoftë, në pjesën më të madhe të vendeve të varfra të Afrikës, dhe të kontinenteve të tjera, pirja e alkoolit nuk konsiderohet luks që vetëm të pasurit mund ta gëzojnë. Ndonëse nuk arriten dot t'u siguronin atyre nevojat më jetike, dhe fëmijëve të tyre arsimin e duhur, janë ende miliona afrikanë që e përdorin alkoolin rregullisht. Në Jug të Indisë, ku për shkak të varfërisë, njerëzit nuk kanë mundësi të blejnë pijet alkoolike të fabrikës, lëngu i palmës, i bërë në shtëpi, u shërbejnë si zëvendësues. Megjithatë, varfëria frenon përhapjen e “nënës së të gjithë të zezave” deri diku. Nëse niveli i të ardhurave për frymë rritet, rriten edhe shpenzimet për alkoolin. Askush nuk e përfill aspak këtë fenomen, derisa përdoruesi kthehet në pijanec.

Dikush mund të shprehë se përse bixhozi dhe përdorimi i alkoolit duhen trajtuar

si problemet e shoqërisë moderne, ndërsa, këto dukuri janë aq të lashta sa vetë historia njerëzore. Sigurisht, pirjen e alkoolit dhe luajtjen e bixhozit, mund t'i gjejmë në çdo periudhë kohore, dhe në çdo vend të botës, por me gjithë lashtësinë e tyre, ato gjithmonë janë quajtur sëmundjet e të gjitha kohërave. Për ekonominë, bixhozi është më i padëshirueshëm se sa alkooli. Në bixhoz, paratë ndryshojnë duart pa e lëvizur sistemin e ekonomisë, sikurse paratë këmbehen me paratë, pa bërë këmbimin themelor të mallit në tregun e mallrave. Në rastin e bixhozit, paraja ndërron duart pa marrë pjesë në procesin e zhvillimit ekonomik dhe të prodhimit të pasurisë. Ndonëse paratë e derdhura në tregun monetar i shërbejnë së paku ndonjë qëllimi; në bixhoz, ato nuk i shërbejnë askujt. Në ambientin e tregut dhe industrive të lira, paratë nuk mund të ndërrojnë duart, pa i shërbyer ekonomisë në formën materiale. Në tregti, këmbimi i vlerës në shumicën e raste u sjell dobi të gjithëve. Është përtej logjikës, që shumica e tregtarëve të pësojnë humbje, në raste të shpeshta. Ndërsa në bixhoz, si parim, një shumicë lojtarësh patjetër pësojnë humbje. Bie fjala, shumë pak kazino falimentojnë. Për dobinë e disave, miliona njerëz detyrohen të bien viktima të mjerimit dhe vuajtjes. I vetmi "përfitim" që ata nxjerrin, duke humbur paratë e tyre, është shpresa e fitores dhe dridhma e humbjes, që i pushtojnë deri në momentin kur ata marrin vesh që kanë humbur bastin. Por duke varur shpresën te fati, për të rifituar humbjet e tyre, ata përsëri vënë bast. Tendosja arrin kulmin, ndërsa stresi nuk mbetet më kënaqësi ose ngacmim, që ai përjetonte gjatë shitblerjes. Tani ankthi, dëshpërimi dhe

pikëllimi, nuk është çështje personale, për një individ, por fillon të ndikojë në marrëdhëniet familjare. Në shtresa të varfra të shoqërisë, nevojat jetike të familjes "bien kurban" në altarin e bixhozit. Kurani i Madhërishëm, duke i ndaluar pirjen e alkoolit dhe bixhozin, pranon që, pa dyshim, kanë edhe përfitime të pjesshme, por kjo është plotësisht e vërtetë që rreziqet ia kalojnë në peshë përfitimit.

Të pyesin ty për alkoolin dhe kumarin. Thuaju: "Ato kanë (edhe) gjynahe të mëdha, por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, dëmi i tyre është më i madh se dobia". Të pyesin se çfarë duhet të shpenzojnë (si lëmoshë). Thuaju: "Tepricën!" Ja, kështu jua shpjegon Allahu shpalljet e Tij, që të mund të mendoni.

(Kurani I Madhërishëm 2: 220)

Dikush mund të argumentojë që përse të shqetësohet, nëse ndonjë tjetër dëshiron të argëtohet dhe bejë qejf, nga paratë që ka fituar. Kjo i përket vetëm atij. Le të bejë qejf secili, ashtu siç i pëlqen. Shoqëria nuk ka asnjë të drejtë të ndërhyjë në lirinë personale, dhe të detyrojë dikë, që si dhe ku duhet ta shpenzojë ai fitimin e tij.

Por duhet mbajtur parasysh, që shumica dërrmuese e mësimeve fetare, bëhen përmes qortimeve dhe vërejtjeve me paralajmërim. Masa të rrepta dhe shtrënguese, nuk ka në asnjë vend në fushën e fesë, përveç se ndaj disa krimeve të caktuara që kryhen kundër të tjerëve, krime që njihen të tillë edhe nga pikëpamja jofetare. Vrasjet, vjedhjet, mashtrimet, korrupsioni dhe mohimi i të drejtave futen në këtë kategori. Veç këtyre janë edhe krimet shoqërore, të cilat, sipas feve, janë helmuese për tërë shoqërinë, por fatkeqësisht, dënimi i këtyre fajeve, nuk i jepet dikujt

individualisht; pasi në fakt ndëshkohet gjithë shoqëria. Duhet të ekzistonin ligjet shoqërore, për të zbatuar këtë dënim. Nuk kalon shumë kohë që kjo çmenduri dhe marrëzi pushton gjithë shoqërinë. Por kjo nuk është aspak për t'u habitur.

Veç kësaj, shoqëritë e tilla gjithmonë në mënyrë të shkallëzuar bëhen më të shtrenjta për të funksionuar. Një pjesë e konsiderueshme e pasurive shtetërore, shkapërderdhet dhe njerëzit e bëjnë atë rrush e kumbulla. Dëshpërimi rritet dukshëm. Krimet shoqërojnë ngushtë alkoolin dhe bixhozin. Mjerimi dhe vuajtjet e shumë shtëpive, në të cilat jeta familjare është shkatërruar plotësisht, janë pasoja të përdorimit të alkoolit dhe bixhozit. Familje të shkatërruara dhe martesat të prishura, janë rrjedhime të drejtpërdrejta të këtyre veseve. Alkoolizmi, ka pasojat shumë të rënda ekonomike dhe shoqërore, sikurse janë shënuar në revistën prestigjioze *Scientific American*. Përveç dhunës familjare, ka edhe abuzime me fëmijë; gjaktrazimi dhe përdhunimi shfaqen nën ndikimin e alkoolit dhe sindromës fatale të alkoolit. Statistika e vdekshmërisë

- Moshë e përdoruesve të alkoolit zvogëlohet prej 10 vjetësh.
- Ndër përdoruesit e alkoolit, përqindja e vdekjeve është dy-herë më shumë te meshkujt ndërsa te femrat kjo është tri-herë më shumë se sa zakonisht.
- Përqindja e vetëvrasjeve është 6-herë më e madhe midis alkoolistëve.
- Përdorimi i alkoolit është një nga 4 shkaqet kryesore ndër meshkujt e grupmoshës 25 deri 44 vjeç: aksidente (50 për qind), vrasje (60 për qind), vetëvrasje, sëmundja e

mëlçisë për shkak të përdorimit të alkoolit.

Humbjet financiare nga alkoolizmi janë:

- Humbjet në prodhim: \$ 14,9 miliard
- Kostoja e shërbimeve shëndetësore: \$ 8,3 miliard
- Humbjet në aksidente: \$ 4,7 miliard
- Humbjet nga zjarri: \$ 0,3 miliard
- Humbjet nga krimet e dhunshme: \$ 1,5 miliard
- Kostoja e reagimit të shoqërisë ndaj këtyre krimeve: \$ 1,9 miliard
- Shuma e përgjithshme e humbjeve të shkaktuara nga përdorimi dhe abuzimi i pijeve të alkoolit arrin në: \$ 31,6 miliard

Në përgjithësi përdorimi i alkoolit, muzika, kërcimi si dhe mënyra të tjera të argëtimit, quhen veprimtari të padëmshme në të shumtën e shoqërive në botë. Ato paraqiten sikurse janë elemente të qenësishme të kulturave të ndryshme. Ndonëse mënyrat e shfaqjes së tyre janë të ndryshme nga një shoqëri te tjetra, tiparet themelore të tyre mbeten po ato. Duke përjashtuar veprimtaritë me temë për skulpturën, pikturën etj., shumica e veprimtarive që u përmenden më lart, nuk mbeten më vetëm si veçoritë e padëmshme të kulturës, por i bëhen barrë e rëndë që i hipin në kurriz, dhe nënshtrojnë drejtimin e saj. Tashmë, shoqëria nuk ka mundësi t'i drejtojë prirjet e saj. Pirja e alkoolit, bixhozi, muzika, vallëzimi dhe veprimtaritë e tjera., fillojnë të tërheqin gjithnjë e më shumë vëmendjen e shoqërisë. Shpejtësia me të cilën këto fenomene pushtojnë mendësinë e rinisë, shumë shpejt shndërrohet në vull.

Duke vëzhguar shoqëritë e tilla, dikush lehtësisht mund të arrijë në përfundim,

që të jepesh pas dëfrimeve dhe argëtimeve dhe t'u nënshtrohesh epsheve dhe dëshirave, është në fakt, i vetmi qëllim i krijimit të njeriut.

Por jo ashtu sipas Islamit.

Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) "O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar këto pa qëllim -lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.

(Kurani i Madhërishëm 3: 191-192)

Ky është deklarim që Kurani i Madhërishëm u bën robërve të Allahut mendar, të cilët pasi kanë medituar dhe kanë studiuar gjëzën e krijimit dhe jetës, deklarojnë vetvetiu në mënyrë spontane se cilido qoftë qëllimi i krijimit, ai nuk është i kotë.

Ajetet Kuranore na sjellin ndër mend shprehjen e famshme të gëzimit të Arkimedit, kur ai lëshoi britmën: *Eureka!*

Kështu që, kemi dy kampe (grupe) krejtësisht në kundërshtim me njëri-tjetrin. Sipas Kuranit famëlartë, njeriu është krijuar të arrijë synimin madhështor, të ndjekë udhën që e çon te Krijuesi i tij. Kurani duke shtjelluar kuptimin e gjerë të adhurimit, parashtron:

*Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të
Më adhurojnë.*

(Kurani i Madhërishëm 51: 57)

Duke shqyrtuar të gjitha metodat e dëfrimit dhe argëtimit, askush, nuk mund të zbulojë gabimet e asnjërës prej tyre, për të justifikuar ndalimin e tyre. Veçanërisht ndër shoqëri të lira të botës, është shumë e vështirë për njerëzit që të kuptojnë se përse Islami mban qëndrimin

puritan (të prerë) deri në shkallën më të lartë. Islami nuk është i thatë dhe i mërzitshëm; mirëpo ai mund të duket i tillë nga larg. Së pari, ata që kanë aftësinë e mirësisë, arrijnë të zbulojnë e të shijojnë kënaqësinë madhështore nga veprime, që njerëzve u duken fare të mërzitshme. Së dyti, ata njerëz janë më me fat se kanë përjetuar dashurinë e vërtetë të Zotit, ata arrijnë në atë nivel madhështor, ku kënaqësitë materiale u duken shumë të ulëta, të rëndomta, të përkohshme dhe kalimtare. Së treti, në zbatim të gjerë, shoqëria që nuk është dhënë pas ndjekjes së kënaqësisë materiale, në fund të fundit, nuk mbetet duarbosh dhe e zhgënjyer.

Në analizën përfundimtare, ne arrijmë në mendimin se ky nuk është thjeshtë shkëmbim i vlerave – ngacmimi, dehja, përjetimet e forta epshore dhe shpërthimet e ekstazës shkëmben me paqen, qetësinë, barazimin, ndjesinë e sigurisë, fisnikërinë dhe kënaqësinë, të cilat janë në fakt virtytet më të larta dhe nuk mund të ketë një dhunti më madhështore se këto.

Kur krahasohet me imtësi mjedisi shoqëror i sotëm, me atë të Islamit duke e vështruar nga të gjitha anët, është lehtë të kuptosh që pema e dashurisë së Zotit, dhe e devotshmërisë ndaj Tij, kurrë nuk mund të lëshojë rrënjët në tokën e një shoqërie që është dhënë pas dëfrimit dhe qejfit. Sigurisht, ka edhe përjashtime, por ato përjashtime kurrë nuk vendosin parimet. Shkurt, mjedisi shoqëror që e parashtron Islami, nuk i ngjan fare atij mjedisi ku përparësi kanë të mirat materiale.

(Marrë nga "Islam's Response to Contemporary Issues" ("Përgjigja e Islamit ndaj çështjeve bashkëkohore"), f. 136-163, Angli, 2007)

Përkthet: Shahid Ahmad Butt

INVESTIMI, INTERESI DHE ISLAMI

HAZRET MIRZA TAHIR AHMAD, KALIFI IV I XHEMATIT MYSLIMAN AHMADIA

Hazret Mirza Tahir Ahmadi, Kalifi i Katërt i Xhematit Mysliman Ahmadia, merrte pjesë në takime, në mjaft raste, ku anëtarët e xhematit dhe të tjerët i shtronin pyetje të ndryshme. Këtu poshtë po paraqesim përgjigjet e dy pyetjeve që iu drejtuan në një seancë që u zhvillua në *Nasir Baagh*, qendra e xhematit musliman Ahmadia në Gjermani, më 11 shtator të vitit 1993. Ky material u botua për herë të parë në shkurt të 1994 në revistën *Review of Religions*.

Pyetje:

Në Islam është shumë e rëndësishme të mos grumbullosh paratë por t'i mbash ato në qarkullim. Si i shpjegon Islami investimet e parave në bursën financiare te sistemi kapitalist?

Përgjigje:

Sistemi financiar i Islamit punon përmes disa parimeve të tjera, dhe para se të gjeni përgjigjen e pyetjes suaj, ju duhet ta kuptoni këtë sistem. Për të tërhequr kapitalin që mund të ushqejë mekanizmin lëvizës të ekonomisë, ekzistojnë vetëm dy mundësi – të shpërndash dhe të qarkullosh paratë, që ato të vënë në lëvizje motorin e ekonomisë dhe ta mbajnë atë gjithmonë në lëvizje.

Një mënyrë është ta shpërblesh kapitalin me përfitime, për të nxitur

më shumë investime dhe më pas, për ta shfrytëzuar atë sipas dëshirës, që do të thotë se në shoqëri ekzistojnë dy mjete – ai i vogli është tërheqja e magnatëve kapitalistë, ndërsa ajo e fuqishmja dhe më e përhapura është tërheqja e shoqërisë së tërë. Nxjerrja e parave, nga përfitimet e një shoqërie dhe pastaj për drejtimin e tyre në kanalet e industrisë, kërkon krijimin e magnatëve bankarë, dhe këta magnatë ushqehen nga dëshira dhe lakmia e njerëzve për të fituar përfitime mbi paratë e tyre. Parimi kryesor që qëndron në themel të këtij sistemi është që paraja “pjell fëmijë”, domethënë ajo krijon paratë vetvetiu. Besohet që ajo vetë zotëron këtë aftësi. Islami e hedh poshtë këtë nocion. Një herë Profeti i shenjtë ^{saws} iu përgjigj një pasuesi që ia kishte kërkuar shpjegimin e interesit. Profeti u shpreh: “A paraja jote pjell para”, domethënë nëse ajo rri kot, a mund të shumëfishohet dhe të shtohet vetvetiu? Sigurisht përgjigjja ishte “JO”.

Nga kjo ne mësojmë që Islami e konsideron pasurinë si element i palëvizshëm në një ekonomi. Vërtet një element, por i mpirë, që mund të luajë rolin pozitiv si dhe atë negativ, duke u varur prej atij që e përdor. Prandaj, paraja duhet të jetë e pleksur në mënyrë të harmonishme me vlerat njerëzore, para se të japë rezultate të dëshiruara. Nëse ato vlera nuk janë të dobishme, dhe paratë bien në duart e njerëzve të papërgjegjshëm, atëherë paratë do

shkojnë kot, dhe gjithë kapitali do të kthehet në asgjë. Në rastin tjetër, nëse përdoruesit e parasë janë mjaft të zgjuar, që mund të shfrytëzojnë atë në dobinë e ekonomisë, atëherë ata do të nxjerrin përfitime, por përfitimet e atij personi, që derdh lekë në bankë etj. për këtë qëllim, do të jenë pak dhe të caktuara. Ato nuk do t'i ngjajnë një rezultati aspak. Nëse dikush merr paratë tuaja, me kusht që do t'ju japë interesin por dështon duke humbur çdo gjë, atëherë ai, ose duhet t'ju rikthejë atë që ju takon gjatë gjithë jetës ose të shpallë falimentimin e tij. Kështu që ky sistem gjithashtu preket nga lloj-lloj mashtrimesh dhe këtë ne e hasim në jetën e përditshme në Europë. Në Angli, veçanërisht këto ditë, kjo metodë është shumë e përhapur dhe mashtruesit po e përdorin këtë për të nxjerrë përfitime, dhe për të gëlltitur para të shumta dhe në fund deklarojnë se kanë falimentuar. Kështu me këta njerëz fundoset edhe ekonomia e miliona njerëzve.

Islami nuk pranon tezën që paraja riprodhohet vetvetiu. Islami përkrah zotërimin e aksioneve, një marrëveshje me anë të së cilës kreditori do të marrë pjesën në rezultatet përfundimtare. Nëse rezultati është i keq, atëherë edhe ai do të pësojë humbje, por nëse ai shënon fitime, edhe ai do të përfitojë



*Hazret Mirza Tahir Ahmad r.t.a.
Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar*

prej tyre. Tashti, kjo kërkon vendime të matura dhe të kujdesshme, nga ana e kreditorit, dhe standarde të larta të ndershmërisë dhe moralit në veprimtarinë ekonomike, përndryshe ky sistem nuk mund të veprojë. Kështu që rrjedha e këtij sistemi gjithmonë do t'i sjellë dobi shoqërisë; në treg do të mbeten vetëm ata që kanë fituar reputacionin e ndershmërisë dhe kanë famë të mirë. Të tjerët, thjesht do të zhduken. Ky është qëndrimi i Islamit.

Por pjesa e dytë e pyetjes mbetet ende për t'u përgjigjur: "Si do ta detyrojë Islami kapitalin, të depozitohet në kanale të ekonomisë?

Islami e fut në punë metodën e vendosjes së taksës progresive mbi kapitalin e bllokuar. Andaj, sipas tij, kapitali është krijuar për të çuar përpara zhvillimin dhe forcimin e ekonomisë dhe askush nuk ka të drejtë ta pengojë atë. Nga kjo del, që kapitali është pronë e përbashkët e gjithë kombit. Ai mund të jetë pronë individuale, derisa t'i shërbejë një qëllimi. Kur ai ngel së qarkulluari atëherë ai duhet gjobitur. Sistemi Islamik i *Zekatit* i përgjigjet pikërisht kësaj detyre, dhe i ngjan taksës që vihet mbi kapitalin e bllokuar

(që nuk qarkullon). Sipas Islamit, nëse kapitali që u takon individëve, nuk u shërben projekteve ekonomike, atij i ulet vlera për atë individ, çka do të thotë, që individët i paguajnë kombit çmimin e ndalimit dhe pengimit. Kështu që ata detyrohen të derdhin kapitalin e tyre në ekonomi, dhe aty, siç kam shpjeguar edhe më parë, duhen njerëz më të ndershëm dhe më të ndërgjegjshëm, mjaft kompetent dhe të aftë, që të shfrytëzojnë kapitalin dhe të nxjerrin përfitime prej tij.

Tani, nëse kthehemi në të kaluarën dhe vështrojmë historinë e Islamit, ju do të mësoni që edhe atëherë kishte gjithashtu njerëz të ndershëm dhe fisnikë që ishin sitë thuash, “kapitalistë” më të mëdhenj, që investonin kapitalin për dobinë e ekonomisë. Hazret Imam Abu Hanifa (Allahu e mëshiroftë), një nga juristët më të nderuar në Islam, sistemi i ligjeve i të cilit sot ndiqet nga një shumicë dërrmuese myslimane, ishte edhe tregtar i zgjuar. Njerëzit i jepnin paratë për tregti. Disa lëshonin qese të mbushura me lekë te pragu i derës së tij me mesazhin, që “të lutemi për Zotin, investojini këto dhe na jepni nga përfitimet. Prandaj, nëse ai i përdorte ato para, ai gjithashtu u jepte përfitimet e tyre. Në përgjithësi, njerëzit përfitonin nga zotësia dhe përvoja e tij dhe kështu ndodhi në shumë raste të tjera. Në sistemin ekonomik të Islamit inkurajohet ndershmëria, ndërsa sistemi që bazohet në interes, dhe që e vë pandershmërinë dhe aftësinë e mashtrimit në krye.

Gjithsesi, mendoj që kjo pyetje kërkon më shumë shqyrtim dhe hulumtim, në një aspekt të veçantë. Përparimi ose paleverdshmëria krahasuese midis këtyre dy sistemeve të kundërta, del në shesh gjatë krizës financiare,

ashtu siç e pamë në Angli. Ato firma që veprojnë mbi kapitalin e huazuar me interes, falimentojnë gjatë krizës financiare. Nuk ka asnjë mundësi për mbijetesën e tyre, sepse ato detyrohen të shlyejnë borxhet, ndonëse nuk fitojnë asnjë lek dhe as nuk përfitojnë nga borxhet. Ndërsa Islami mban një qëndrim krejt të kundërt. Nëse ai që merr borxh nuk i shfrytëzon paratë dhe nuk fiton prej tyre, dhe gjatë krizës financiare detyrohet të ulë prodhimin, atëherë në këtë situatë, edhe kreditori duhet të mbartë barrën e vështirësisë. Kreditoret nuk do t'i jepet asgjë. Këtyre firmave, do t'u jepet më shumë kohë që të marrin veten sërish, tamam si ato kafshë, që bien në letargji gjatë dimrit. Kështu që sistemi i paraqitur nga Islami siguron mundësinë e letargjisë dhe rimëkëmbjes, ndërsa sistemi kapitalist perëndimor nuk ka masa të tilla.

Pyetja e mëposhtme gjithashtu ishte bërë për të njëjtin rast, dhe andaj është vazhdim i përgjigjes së mëparshme dhe kjo i përgjigjet sistemit kapitalist perëndimor dhe përkon me çështjet bashkëkohore.

Pyetje:

Përse Islami ndalon përdorimin e interesit?

Përgjigje:

Kjo është një pyetje e shkurtër që kërkon përgjigje të hollësishme, dhe kam frikë se nuk kemi kohë të mjaftueshme në këtë takim për të trajtuar vetëm këtë pyetje. Meqë nuk mund ta shpjegoj në mënyrë shteruese, por do të përpiqem të jap përgjigje më të qartë ndonëse të shkurtër.

Kjo pyetje nuk u përket vetëm nevojave individuale, por çështja e interesit dhe

ndalimit të tij në Islam, ka një shtrirje më të gjerë si dhe një ndikim më të thellë. Të gjitha sistemet financiare që veprojnë me interes, quhen sisteme kapitaliste. Të gjitha këto kanë mangësi të brendshme, por jo vetëm disa, por ato mangësi janë të shumta, dhe gjithmonë i çojnë njerëzit drejt vuajtjeve dhe mjerimit, pavarësisht që ata nuk do të kenë marrë pjesë në këtë sistem në mënyrë të drejtpërdrejt. Unë mund të flas me hollësi mbi këtë çështje, dhe mund t'ju jap një shembull për ta shtjelluar pikëpamjen time.

Shoqëria e cila merr hua me interes, në një farë mënyre shpenzon të ardhmen e saj në të tashmen. P.sh. kam nevojë për para që të blej një makinë luksoze, për të qëndruar në një hotel të rehatshëm, për të pasur një shtëpi ose ndonjë send tjetër luksoz, ndërkohë që shkalla e të ardhurave të mia është shumë e vogël, kurse dëshirat janë të papërmbajtura dhe të pakufizuara. Unë nuk mund të pres derisa të kem fituar mjaft, për të realizuar dëshirën time, kurse sistemi i interesit më jep mundësi të marr borxh nga bankat. Në fakt duke vepruar kështu, unë po marr hua nga e ardhmja ime, kështu që me kalimin e kohës, bëhem më i varfër dhe dikur bëhet pothuajse e pamundur të laj borxhin që kisha marrë. Tani ky nuk është më problem individual. Tani dhe më tutje, ky shndërrohet në një problem kombëtar dhe vijon të bëhet gjithnjë e më i ndërlikuar.

Industritë që lulëzojnë mbi këtë sistem, në fakt, plotësojnë nevojat e ditës, ose të një viti, dhe zhvillohen mbi kërkesat që nuk janë të vërteta, por janë ngritur në mënyrë artificiale. Pas pak kohe, fuqia blerëse dobësohet pak nga pak derisa ajo arrin në rrugë qorre. Shtetit i shter fuqia blerëse, gjersa vetë shlyerja

e borxhit bëhet një problem për gjithë kombin. Industritë e ndiejnë rëndë këtë zbythje si dhe tregtia në tërësi. Si rrjedhim, në raste të tilla, shfaqet kriza ekonomike.

Tani, ato vende që tregtia e tyre ka shtrirje të gjerë në vende të huaja, për t'u mbështetur gjatë këtyre krizave financiare, mund t'ia dalin mbanë përkohësisht. Por kur një sërë vendesh bien njëherazi në krizë, atëherë është pothuajse e pamundur që këto vende me ekonomi artificiale të gjejnë mbështetje. Kriza financiare që u shfaq së fundi në Angli, në fakt, ishte parashikuar prej meje para disa vjetësh, në një fjalim që mbajta në Sallën e Mbretëreshës Elizabeth II, kur tregova qartazi që sistemi i tyre i interesit do t'i fundosë në thellësitë më të mëdha që ata do t'i kishin përfytyruar. (Shih Islam's Response to Contemporary Issues [*Përgjigjja e Islamit ndaj problemeve bashkëkohore*] nga Hazret Mirza Tahir Ahmadi, botoi El-Shirkatul Islamiah). Ndodhi pikërisht ashtu dhe ky problem do të zgjerohet edhe më shumë.

Për shkak të ndryshimeve politike në Evropën Lindore, kriza financiare i kurseu ata për pak kohë. Por nuk dua të shkoj në thellësi, për të shpjeguar ato motive që shkaktuan këtë vonesë. Por ajo do të shfaqet medoemos. Tregjet e jashtme do të mbeten të kufizuara. Fuqia e tyre blerëse po siset. Kanë thithur boll gjakun e Afrikës, që ajo tani vuan nga anemia, bile nga anemia vdekjeprurëse.

Nëse gara për të siguruar tregje të jashtme që zhvillohet në Europë nuk merr fund, po zëmë brenda pesë vjetësh, do të kuptoni që sa i thellë është ky problem dhe sa kërcënues do të bëhet ky rrezik. Vetë Gjermania është në

fazën e rindërtimit të ekonomisë së saj, duke thithur një shumicë dërrmuese gjermanësh nga pjesa lindore. Ndër ta ka punëtorë që kanë njohuri dhe aftësi teknike në shkallën më të lartë, që deri tani janë paguar shumë pak. Tani ata janë pjesa e ekonomisë së gjerë gjermane, dhe gëzojnë të njëjtin trajtim, prandaj pas një goditje fillestare, niveli i prodhimit do të rritet në mënyrë të vrullshme, aq shumë, sa që Europa do të ngjethet duke përfytyruar skenën e ekonomisë së përforcuar gjermane. Pikërisht atëherë do të nis gara serioze për të gjuajtur tregjet e reja.

Gjithashtu, Rusia e atëhershme nuk do të jetë Rusia e sotme, që ende po rreket të rimëkëmbet midis tronditjeve të forta pas rrëzimit të komunizmit. Rusia po rigrupon forcat. Ekonomia e saj do të ripërtërihet. Gjendja e Rusisë së sotme, më kujton veprën madhështore të Miltonit, *Parajsa e rifituar*, në të cilën forcat e djallit, pas goditjeve fillestare, rigrupohen për të rifituar parajsën. Prandaj, mos mendoni që Rusia është jashtë garës.

BRSS-ja (*Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike*) është vend i madh, ose është një grumbull vendesh, ekonomia e të cilëve është e fuqishme që të tejkalojë shumë vende evropiane. Por pasi të kalojnë periudhën e rimëkëmbjes duke kaluar në sistem kapitalist, do të zhvillohen një varg ngjarjesh siç kanë ndodhur në Gjermani. Tani silleni nëpër mend gjendjen e një Evrope me fuqinë blerëse që po pakësohet, me problemet e shumta financiare dhe me një konkurrim që gjithnjë po rritet. Kriza të tilla gjithmonë përfundojnë me luftëra dhe ky është parimi themelor që kurrë nuk mund të shpërfilllet.

Pikërisht, duke e pasur parasysh Kurani i Madhërisëm kur ndalon përdorimin e kamatës ose interesit, ai deklaron: *“Nëse nuk do të hiqni dorë nga kamata atëherë bëhuni gati për luftë me Allahun dhe me të Dërguarin e Tij!”* domethënë sistemi hyjnor do të veprojë kundër jush, dhe ju do të detyroheni të kaloni në gjendjen e luftës. Pra, kjo ishte përgjigjja më e shkurtër që mund të kisha paraqitur para jush, por ende mbeten shumë gjëra që duhen shpjeguar.

ZEKATI

Zekati është një nga pesë shtyllat e Islamit – të tjerat janë: pohim se “*nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Tij*”; *namaz* (falje); agjërim gjatë muajit të Ramazanit; dhe pelegrinazh në Shtëpinë e Allahut në Mekë. Për shembull, Kurani i Shenjtë porositi:

Fal namazin dhe paguaj zekatin dhe bindu të Dërguarit që ty të mund të të tregohet mëshirë.

(En-Nur 25:57)

Fjala arabe “*zekat*”, fjalë për fjalë do të thotë “*të pastrosh diçka*”, dhe në kontekstin e një taksimi të detyrueshëm do të thotë që teprica e pasurisë pas heqjes së zekatit e ka bërë atë të pastër dhe të ligjshme për besimtarët.

Është taksuar normalisht 2.5% mbi asetet e disponueshme mbi pragjet specifike, që ka mbetur në duart e pronarëve përtej një viti. Ndonëse është folur shumë për normën apo përqindjen e kësaj “takse”, ne nuk gjejmë referencë për ndonjë përqindje të caktuar në Kuranin e Shenjtë. Në lidhje me këtë, unë kërkoj të mos jem dakord me këndvështrimin dogmatik të dijetarëve mesjetarë. Unë besoj se çështja e përqindjes mbetet e lakueshme dhe do të përcaktohet sipas gjendjes së ekonomisë në një vend të

veçantë.

Zekati, duke qenë një taksë e veçantë, e vënë mbi kapitalin përtej pragjeve të caktuara, ajo mund të përdoret vetëm për kategori të caktuara të shpenzimeve. Këto janë shprehur qartë në ajetin që pason të Kuranit të Shenjtë:

Lëmoshat janë vetëm për të varfrit dhe nevojtarët dhe për ata të punësuar në lidhje me mbledhjen dhe shpërndarjen e tyre dhe për ata zemrat e të cilëve duhet të ngushëllohen dhe për lirimin e skllëvërve, dhe për ata të ngarkuar me borxh dhe për ata që përpiqen në rrugën e Allahut dhe për udhëtarët. Kjo është një urdhëresë nga Allahu. Allahu është i Gjithëdijshmi dhe i Urtë.

(Et-Teuba 9 :60)

Ministria e Financave është ngarkuar me administrimin e kësaj urdhërese. Në historinë e hershme të Islamit, *Hadret* Abu Bakr dhe Umar, dy Kalifët e parë, ishin të njohur për sigurimin personalisht të pagesës së shpejtë të lëmoshave në atë që u bë e njohur si shteti i ndihmës së parë sociale. Ky sistem kishte funksionuar me sukses të madh për shekuj gjatë periudhës Abbaside.

Siç është shpjeguar gjithmonë, forca e motivit të interesit është zëvendësuar

nga forca lëvizëse e zekait. Kur ne këqyrim këtë sistem në funksionim, dalin në dritë shumë ndryshime midis rendit ekonomik Islamik dhe sistemeve ekonomike të tjera. Fillojnë të shfaqen tiparet e një ekonomie krejtësisht të ndryshme.

Asnjë shumë parash të pa përdorura, të pavarura nga qenia e madhe apo e vogël, nuk mund të mbijetojë për një kohë të gjatë pa u shtuar më shpejt se norma në të cilën është taksuar. Kjo është saktësisht sesi zekati vë në lëvizje ekonominë në një shtet të vërtetë Islamik.

Përfytyroni një situatë ku një individ me një shumë të vogël të kapitalit, nuk është në gjendje të marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në tregti, dhe nuk ka banka për ta kredituar me interes mbi depozitën e tij. Sidoqoftë, nëse depozita është e madhe në mënyrë të mjaftueshme të jetë e taksueshme si zekat, ka mbledhës të të ardhurave që trokasin në derën e tij çdo vit për përqindjen e kapitalit të tij, zekati nuk është përtej një pragu të caktuar. Individë të tillë kanë vetëm dy alternativa: ose të përdorin personalisht paratë e tyre me fitim, ose të bashkojnë burimet e tyre për të krijuar ndërmarrje të mëdha apo të vogla.

Kjo do të nxisë shoqëri me kapital të përbashkët, ortakëri, formimin e kompanive të vogla apo aksionerë publik në kompani më të mëdha mbi

një fitim të caktuar dhe bazë humbje. Të tilla kompani nuk do t'i detyrohen asgjë ndonjë instituti financiar të cilit ata duhet t'ia kthejnë borxhet me interes. Në mënyrë hipotetike, kur ju krahasoni fatin e kompanive të tilla me atë të homologeve të tyre në ekonomitë kapitaliste, ato do të përballen me platforma plotësisht të ndryshme gjatë periudhave të provës dhe krizës. Në rastin e tregtisë dhe industrisë, përballimi i një recesioni në një ekonomi kapitaliste, ngadalësimi në prodhim për arsye të kërkesës së zvogëluar mund të shtyjnë ato në kufijtë e likuidimit. Interesi që ata duhet të paguajnë për t'u shërbyer borxheve të tyre, do të vazhdojë të ngrihet në mënyrë të pamëshirshme deri sa nuk do të ketë më mundësi që kompani të tilla të vazhdojnë të ekzistojnë.

Nga ana tjetër, nëse një ekonomi është drejtuar mbi parime Islamike, ngadalësimi në mundësitë e biznesit dhe tregtisë do ta çojnë tregtinë dhe industrinë në një gjendje letargjie. Ja se si natyra siguron mbijetesën e më të përshtatshmit në kohën e streseve ekstreme dhe fatkeqësive. Kur sasia e energjisë zvogëlohet, prodhimi duhet të ulët që energjia të mos bjerë poshtë nivelit kritik të nevojshëm për të mbijetuar. Duke qenë se këtu nuk ka presion të pamëshirshëm të shërbimit të borxhit në një sistem financiar Islamik, kjo mund të përballojë shumë më tepër presion dhe sfida gjatë një recesioni.

(Marrë nga "Islam's Response to Contemporary Issues" ("Përgjigjja e Islamit ndaj çështjeve bashkëkohore"), Hazret Mirza Tahir Ahmad, f. 175-177, Angli, 2007)

NJË RISHIKIM I SHKURTËR I KRITIKËS HISTORIKE TË FAJDESE

NGA WAYNE A. M. VISSER DHE ALASTAIR MCINTOSH (QENDRA PËR EKOLOGJINË HUMANE).

(Ky shkrim për herë të parë është botuar në Kontabiliteti, Biznesi dhe Historia Financiare, 8:2, Londër, Routledge, korrik 1998, f. 175-189. Botuar me lejen e autorëve në revistën e Xhematit Mysliman Ahmadia "The Review of Religions", korrik 2004.)

Pjesë e shkëputur

Fajdeja – e dhënë me interes apo interes i tepërt – sipas të dhënave të njohura, është praktikuar në pjesë të ndryshme të botës të paktën katër mijë vjet më parë. Gjatë kësaj kohe, ka dëshmi të shumta të kritikës së ashpër që i është bërë nga tradita të ndryshme, institucione dhe reformatore socialë mbi baza morale, etike fetare dhe ligjore. Shpjegimi nga këta kritikë të shumtë ka përfshirë argumente rreth etikës së funksionimit, drejtësisë shoqërore, paqëndrueshmërisë ekonomike, shkatërrimit ekologjik dhe paanësisë ndërbrezore. Ndërsa lidhja bashkëkohore e këtyre debateve, kryesisht historike, nuk është analizuar në hollësi; autorët debatojnë se domethënia e tyre është më e madhe se kurrë në kontekstin e ekonomisë moderne globale bazuar tek interesi.

PARATHËNIE

Koncepti i "fajdesë" ka një jetëgjatësi historike, gjatë së cilës është kuptuar t'i referohet praktikës së [ngarkimit-pagesës] të interesit financiar si shtesë e shumës themelore të një huaje, ndonëse në disa raste dhe më posaçërisht në kohët më të fundit, është interpretuar si interes mbi normën legale apo shoqërisht të pranueshme. Duke pranuar

këtë përcaktim të gjerë për momentin, praktika e ecurisë së fajdesë mund të ndiqet përafërsisht për katërmijë vjet (Jain, 1929). Ajo gjatë historisë së saj ka qenë e ndëshkuar, e ndaluar, e përçmuar dhe e kufizuar vazhdimisht, kryesisht mbi baza morale, etike fetare dhe ligjore. Midis kritikëve të saj më të dalluar dhe të shumtë kanë qenë institucionet fetare të Hinduizmit, Budizmit, Judaizmit, Islamit dhe Krishterimit. Kësaj liste mund t'i shtohen filozofët dhe politikanët e lashtë Perëndimorë, si edhe reformatore të ndryshëm modernë social-ekonomik. Është objekti i këtij trajtimi të përvijojë me pak fjalë historinë e kësaj kritike të fajdesë, të hetojë arsyet për kërcënimin e saj të vazhdueshëm dhe përfundimisht, të vlerësojë në mënyrë intuitive lidhjen e këtyre argumenteve në ekonominë e sotme globale, të bazuar kryesisht tek interesi. Qëllimi nuk do të shtrihet në një vëzhgim të plotë të disa prej alternativave moderne për fajdenë, përveç të përshkruajë praktikën në rritje të veprimeve bankare Islamike si një shembull.

HISTORIA E KRITIKËS SË FAJDESE

Fajdeja në Hinduizëm dhe Budizëm

Midis referencave më të vjetra të njohura për fajdenë, që gjenden në dorëshkrimet e lashta fetare indiane, dhe Jain (1929) siguron një raport përmbledhës të

shkëlqyer të këtyre në veprën e tij mbi *Veprimet bankare indigjene në Indi*. Të dhëna të tilla më të hershme gjenden në tekste Vedike të Indisë së Lashtë (2,000-1,400 vjet para erës sonë), në të cilat “fajdexhiu” (*kusidin*) është përmendur disa herë dhe është përcaktuar si një huadhënës me interes. Referenca më të hollësishme dhe më të shpeshta të pagesës me interes, do të gjenden në tekstet më të vona të *Sutra-ve* (700-100 vjet para erës sonë) si edhe në *Jatakat* Budiste (600-400 vjet para erës sonë). Gjatë kësaj periudhe të vonë shprehen mendimet e para të përbuzjes për fajdenë. P.sh, Vasishtha, një ligjvënës i njohur hindu i asaj kohe, hartoi një ligj special i cili ndalonte kastat më të larta të *Brahmanëve* (priftërinjë) dhe të *Kshatrijasve* (luftëtarëve), të ishin fajdexhinj apo huadhënës me interes. Gjithashtu, në *Jatakat*, për fajdenë shprehen në mënyrë përbuzëse duke thënë: “*asketë hipokritë janë akuzuar për praktikimin e saj*”.

Nga shekulli i dytë pas Krishtit, sidoqoftë, fajdeja ishte bërë një term i njohur, meqenëse u përfshi në *Ligjet e Manut* të asaj kohe: “*Interesi i përcaktuar përtej normës ligjore që është kundër (ligjit) nuk mund të mbulohet: ata e quajnë këtë një mënyrë kamatarie (të huadhënies)*”, (Jain, 1929: 3-10). Ky dobësim i konceptit të fajdesë duket të ketë vazhduar gjatë rrjedhës së mëtejshme të historisë indiane, kështu që sot, ndërsa ende dënohet në parim, fajdeja i referohet vetëm interesit të kërkuar mbi kufirin ekzistues të pranuar shoqërisht dhe nuk është ndaluar apo kontrolluar më në ndonjë mënyrë domethënëse.

Fajdeja në filozofinë politike Perëndimore të Lashtë.

Midis filozofëve të lashtë Perëndimore, që e dënuan fajdenë mund të përmenden:

Platoni, Aristoteli, të dy Katot, Ciceroni, Seneka dhe Plutarku (Birnie, 1958). Dëshmi se këto mendime gjetën pasqyrimin e tyre të njëkohshëm në ligjin civil të asaj periudhe, mund të shihen, p.sh, nga reformat *Lex Genucia* në Romën Republikane (340 para Krishtit) që interesi nxirrej krejtësisht jashtë ligjit. Megjithatë, në praktikë, mënyra të shmangies ndaj një ligjshmërie të tillë u gjenden dhe nga periudha e fundit e Republikës, fajdeja ishte përsëri dukuri e zakonshme. Ishte Partia Demokratike në Romë, që iu përkushtua përsëri kauzës së atyre që vuanin barrën e huas dhe nën flamurin e Jul Cezarit, u vendos për të një tavan prej 12% normë interesi, dhe më vonë nën Justinianin u ul edhe më tej midis 4% dhe 8% (Birnie, 1958). Haptazi, kjo la terren të përshtatshëm për mësymje mbi fajdenë, që Kisha do ta vinte në skenë, duke pasuar Kristianizimin e Perandorisë Romake.

Fajdeja në Islam

Kritika e fajdesë në Islam ishte shumë e fortë gjatë jetës së Profetit Muhammed dhe mbështetej nga mësimet e Kuranit të Shenjtë ⁽¹⁾ që daton në rreth 600 vjet pas Krishtit. Fjala e përdorur për fajdenë në këtë tekst ishte “*riba*”, që fjalë për fjalë do të thotë “*teprim apo shtim*”. Kjo ishte pranuar t’i referohej në mënyrë të drejtpërdrejtë interesit mbi huat kështu që, sipas ekonomistëve islamikë Choudhury (Çaudrri) dhe Malik (1992), në kohën e Kalifit Umar, ndalimi i interesit ishte një parim aktiv i mirë-vendosur, i integruar në sistemin ekonomik islamik. Nuk është e vërtetë që ky interpretim i fajdesë është pranuar në mënyrë universale apo zbatuar në botën islamike. Vërtet, një shkollë e mendimit islamik, që lindi në shekullin e 19, udhëhequr nga Sir Sayyed, argumenton ende një diferencim interpretues

ndërmjet fajdesë, që pretendohet t'i referohet huadhënies dhe interesit konsumues, që ata thonë i referohet huadhënies për investim tregtar (Ahmad, 1958). Megjithatë, duket të jetë dëshmi në kohët moderne, ajo që Choudhury dhe Malik përshkruajnë si “*një evolucion gradual i institucioneve të sipërmarrjeve financiare të interesit të lirë nëpër botë*” (1992: 104). Ata citojnë, p.sh, ekzistencën aktuale të institucioneve financiare në Iran, Pakistan dhe Arabi Saudite, Dar-al-Mal-al-Islami në Gjenevë dhe kompanitë e besuara islamike në Amerikën e Veriut. Kjo praktikë në rritje, e veprimit bankar islamik, do të diskutohet më e plotë në një pjesë tjetër si një zbatim modern i ndalimit të fajdesë.

Fajdeja në Judaizëm

Kritika e fajdesë në Judaizëm i ka rrënjët e saj në pasazhe të ndryshme biblike, në të cilat marrja e interesit është ose e ndaluar, e dekurajuar ose e përbuzur.⁽²⁾ Fjala hebraike për interesin është *neshekh*, që do të thotë fjalë për fjalë “*një kafshatë*” dhe besohet t'i referohet kërkesës së interesit nga këndvështrimi i debitorit. Në tekstet e bashkuara Eksodi dhe Levitiku, fjala thuhet pa dyshim aplikohet vetëm të huadhënësia për nevojtarin dhe të varfrin, kur në Ligjin e Përtërirë (Deuteronomy), ndalimi përfshin gjithë huadhënien, duke përjashtuar vetëm marrëveshjet tregtare me të huajt. Në tekstin Levitik fjalët *tarbit* apo *marbit* janë përdorur gjithashtu për t'iu referuar mbulimit të interesit nga kreditori.

Veç këtyre burimeve biblike, ka shtrirje të ndryshme *talmudike* të ndalimeve të interesit, të njohura si *avak ribbit*, fjalë për fjalë “*pare e interesit*” që përdoret, p.sh në lloje të caktuara kontratash të shitjes, rentës dhe punës. Kjo dallohet nga fjalët *rubbit kezuzah*, që tregon interesin tipik në një shumë apo në një normë të rregulluar

midis huadhënësit dhe huamarrësit. Ndryshimi në ligj është se ky i dyti, nëse është paguar nga huamarrësi të huadhënësi, është i rikuperueshëm nga huadhënësi, ndërsa i pari, me t'u paguar, nuk është i rikuperueshëm, ndonëse një marrëveshje e prishur nga paraja e interesit nuk do të imponohet. (Enciklopedia çifute, 1912).

Pavarësisht nga ndalimi i marrjes së interesit, ka dëshmi të konsiderueshme që tregojnë se ky parim nuk vërehej gjerësisht në kohët biblike. Veç disa referencave në Testamentin e Vjetër për kreditorët që ishin kërkues dhe të paepur në nxjerrjen e interesit të tyre,⁽³⁾ nga dorëshkrimet prej papiruseve Elefantiane (Elephantine) duket se midis çifutëve në Egjipt, në shekullin e pestë para erës sonë, ishte çështje e kursit që interesi do të ngarkohej mbi huat. (Enciklopedia çifute, 1971). Kjo natyrë bamirëse e ndalimit mbi interesin sugjeron se shkelja e saj nuk gjykohej si një kundërvajtje kriminale me sanksionet penale të caktuara, por më saktë si një shkelje morale.

Dukuria e evazionit, gjithashtu mund të shpjegohet pjesërisht me ndryshimin e kushteve ekonomike, të filluara në periudhën amoraikë në Babiloni, kur ndalimi i interesit mendohej të mos ishte më i pajtueshëm me nevojat ekonomike të komunitetit. Me kohë, u vendos një formë standarde e legjislacionit të interesit, e njohur si *hetter iskah*, që do të thoshte *leje për të formuar një ortakëri*, që është bërë aq e pranuar sa që në ditët e sotme të gjitha transaksionet e interesit kryhen lirshëm sipas ligjit çifut, thjesht duke i shtuar vërtetimit apo marrëveshjes së interesuar fjalët *alpi hetter iskah* (Enciklopedia çifute, 1971).

Fajdeja në Krishterim.

Pavarësisht nga rrënjët çifute të saj, kritika e fajdesë ishte marrë përsipër më

me pasion si një kauzë nga institucionet e Kishës së Krishterë, ku debati mbizotëroi me intensitet të madh mbi njëmijë vjet⁽⁴⁾ Dekretet e Testamentit të Vjetër ishin ringjallur dhe një referencë e Testamentit të Ri për fajdenë u shtua të ushqente kauzën.⁽⁵⁾ Bazuar mbi autoritetin e këtyre teksteve, Kisha Katolike Romake, nga shekulli i katërt para Krishtit, kishte ndaluar marrjen e interesit nga kleri: një rregull që ata e shtrinë në shekullin e pestë të laikët. Në shekullin e tetë, nën Karlin e Madh, ata ngulmuan më tej dhe e deklaruan fajdenë si një kundërvajtje e përgjithshme kriminale. Kjo lëvizje kundër-fajde vazhdoi të merrte vull gjatë Mesjetës së hershme, dhe ndoshta arriti zenitin e saj në vitin 1311, kur Papa Klementi i Pestë bëri nxjerrjen absolute jashtë ligjit dhe deklaroi gjithë legjislacionin laik në favor të saj pa forcë ligjore. (Birnie, 1952).

Pas kësaj gjithnjë e më shumë dhe pavarësisht nga ndalime të shumta, të vazhdueshme nga Papët dhe legjislatorët civilë, u gjenden shtigje në ligj dhe kontradikta në argumentet e Kishës dhe bashkë me rritjen e baticës së komercializimit, kundër lëvizja pro-fajde filloi të rritej. Lindja e Protestantizmit dhe ndikimi i tij pro-kapitalist është i shoqëruar gjithashtu me këtë ndryshim (McGrath, 1990). Por duhet të vihet re se të dy, Luteri dhe Kalvini, shprehën disa rezerva rreth praktikës së fajdesë, pavarësisht nga besimi i tyre se kjo nuk mund të ishte e dënueshme në mënyrë universale. Kalvin, për shembull, renditi shtatë raste vendimtare në të cilat interesi mbetet “mëkatar” por këto u shpërfillën përgjithësisht dhe pozita e tij u mor si një sanksionim në masë i interesit (Birnie, 1952). Si rezultat i të gjithë këtyre ndikimeve, aty nga viti 1620, sipas teologut Ruston, “fajdeja kaloi nga qenie e një kundërvajtje kundër parimeve

morale publike, që një qeveri e Krishterë pritej t’i jepte fund, të ishte një çështje e ndërgjegjes personale [dhe] një gjeneratë e re e moralistëve të Krishterë e ripërcaktuan fajdenë si interes i tepërt” (1993: 173-4).

Ky pozicion ka mbetur depërtues gjatë mendimit të ditëve të sotme në Kishë, siç sugjerojnë pikëpamjet dëshmuese të Kishës së Skotlandës (1988) kur ajo deklaroi në raportin studimor të saj mbi etikën e investimit dhe veprimet bankar: “Ne pranojmë se praktika e interesit të ngarkuar për biznes dhe huave personale nuk është, në vetvete, e papajtueshme me etikën e Krishterë. Ajo që është më e vështirë të përcaktohet është nëse norma e interesit të ngarkuar është e drejtë apo e tepërt.” Në mënyrë të ngjashme, është ilustruese se, në kundërshtim me moralin e qartë të urdhrit kundër fajdesë i shprehur ende nga Kisha të Rerum Novarum i Papës Leo i XIII si “fajdeja e pangopur... një e keqe e dënuar shpesh nga Kisha por megjithatë ende e praktikuar në mënyra mashtruese nga njerëz dorështrënguar”, Sollicitudo Rei Socialis e Papës John Paul II 1989 i mungon ndonjë përmendje e caktuar e fajdesë, përveç një nënkuptimi të vakët përmes pranimit të krizës së Huas të Botës së Tretë.

Fajdeja në mendimin reformist modern

Dikush mund të befasohet kur të zbulojë se Adam Smithi, pavarësisht nga imazhi i tij si “Ati i Kapitalizmit të Tregut-të Lire”, dhe avokatisë së tij të përgjithshme të ekonomisë *laissez-fair*, doli me forcë në mbështetje të kontrollit të fajdesë (Jadlow, 1977; Levy, 1987). Kur ai kundërshtoi një ndalim të plotë të interesit, ai ishte në favor të imponimit të një norme interesi tavan. Kjo, mendoj ai, do të siguronte që huamarrësit e riskut të ulët, që mund të ndërmerrnin investime shoqërisht të dobishme, nuk ishin të përjashtuar nga fondet si rezultat

i “pjesës më të madhe të parave që duhej të jepej hua [duke qenë] se jepej hua për dorëlëshuarit dhe projektuesit [investitorëve në sipërmarrje spekulative të rrezikshme], të cilët vetëm do të ishin të gatshëm të jepnin normë të lartë interesi [jo të rregullt]”. (Smith, 1937: 339).

Ekonomisti i madh i shekullit të njëzetë, John Maynard Keynes, mbajti një pozicion të ngjashëm duke besuar se “hulumtimet e skolasitikëve [mbi fajdenë] ishin drejtuar drejt shpjegimit të një formule që do të lejonte programin [planin] e efikasitetit marginal të ishte i lartë, ndërsa duke përdorur rregullin, zakonet dhe ligjin moral për të mbajtur poshtë normën e interesit, kështu që një Qeveri e mençur është e interesuar ta mbajë atë nën fre me statut dhe zakon dhe madje duke evokuar sanksione të Ligjit Moral” (1936; 351-3)

Një tjetër ekonomist reformator më pak i njohur kundër fajde ishte Silvio Gesell (1904). Megjithëse Keynes shkruante se bota mundej të mësonte më shumë prej tij sesa nga Marksi. Gesell, si një tregtar i suksesshëm i shekullit të nëntëmbëdhjetë, në Gjermani dhe Argjentinë, e dënoi interesin mbi bazën se shitjet e tij ishin më shpesh të lidhura me “çmimin” e parasë (d.m.th, interesin) sesa nevojat e njerëzve apo cilësinë e produkteve të tij. Propozimi i tij, i bërjes së parave një subjekt të shërbimit publik ndaj një tarife përdorimi, çoi në eksperimentim të gjerë në Austri, Francë, Gjermani, Spanjë, Holandë dhe në Shtetet e Bashkuara nën flamurin e së ashtuquajturës “*lëvizja shkrim stampë*”. Por këto iniciativa të gjitha u ndrydhën kur suksesi i tyre filloi të kërcënonte monopolet kombëtare të veprimit bankar (Kennedy, 1995). Margrit Kennedy (1995), një profesor Gjerman në Universitetin e Hanoverit, është një nga kritikët bashkëkohorë më në zë, i interesit që mbështeti idetë e Gesellit, duke besuar se “interesi ...

vepron si kancer në strukturën tonë shoqërore”. Ajo pranon shkakun për “interesin dhe paranë e lirë inflacion” duke sugjeruar një modifikim të praktikës së veprimit bankar për të inkorporuar një tarifë qarkullimi mbi paranë, duke vepruar disi si një mekanizëm negativ i normës së interesit.

Përfundimisht, një tjetër shkollë e kritikëve modernë të interesit, i ka rrënjët e saj në punën plotësuese të disa reformatorëve socio-ekonomik të hershëm të shekullit të njëzetë, domethënë Douglas (1924), Simons (1948), Fisher (1935) dhe Soddy (1926). Premisa kryesore e tyre e përbashkët ishte se është plotësisht e gabuar dhe e papranueshme për bankat tregtare, të mbanin një monopol mbi paranë apo procesin e krijimit të kreditit. Për bankat e asaj kohe interesi i ngarkuar (përfshirë për qeverinë) në para, që ato kishin krijuar në radhë të parë nga asgjë-ja, duke mos provuar kosto dobie apo sakrifice,ⁱ në praktikë është njësoj: imorale dhe mashtruese. Sisteme të ndryshme alternative janë propozuar nga autorë origjinalë dhe janë çuar përpara nga pishtarmbajtës të epokës së tyre moderne, për shembull, Sekretariati i Kreditit Shoqëror dhe Komiteti mbi Reformën Monetare dhe Ekonomike.

PËRSIATJE PËR KRITIKËN E FAJDESE

Gjatë historisë të kritikës së fajdesë, arsye të ndryshme dhe racionale janë nxitur në përkrahje të këtij pozicioni. Ndërsa disa janë unike për tradita të veçanta apo individë, shumë ecin në terren të përbashkët, që kjo pjesë do të përpiqet shkurtimisht t'i sintetizojë.

ⁱ Opportunity cost - kosto dobie = humbje alternativash të tjera kur është zgjedhur një alternativë. (Shën.përkth.)

Fajdeja si e ardhur e pafituar [e pamerituar]

Kundërshtimi më i thjeshtë dhe ndoshta më i hershëm i Kishës ndaj fajdesë ishte mbi baza që kjo përbënte të ardhurën e pa fituar, një ide që buron nga doktrina e saj e përgjithshme e Çmimit të Drejtë. Këshilli Luterian i 1515 e shpreh qartë një pikëpamje të tillë të Kishës: “Ky është interpretim tipik i fajdesë kur fitimi kërkohet të sigurohet nga përdorimi i një [sendi], jo produktiv në vetvete (si një kope apo një fushë) pa punë, pa shpenzim apo rrezik nga ana e huadhënësit.” Birnie e përforcon këtë argument duke përmendur se “të jetosh pa punë ishte gjykuar si e panatyrshme, po kështu Dante i vendos fajdexhinjtë në të njëjtin rreth të ferrit si banorët e Sodomit dhe praktikuesit e tjerë të vesit të panatyrshëm” (1952:4).

Ky është arsyetimi që edhe Ahmadi përdor për të shpjeguar përse në Islam Zoti “lejon tregtinë por ndalon fajdenë”; “Ndryshimi është se përfitimet janë rezultat i iniciativës, sipërmarrjes dhe rendimentit. Ato rrjedhin pas një procesi krijim-vlere të përcaktuar. Nuk ngjet kështu me interesin”; edhe “interesi është i caktuar, fitimi luhatet. Në rastin e interesit ju e dini fitimin tuaj dhe mund të jeni i sigurt për të. Në rastin e fitimit ju duhet të punoni për ta siguruar atë” (1958:25). Ndoshta Aristoteli kishte të njëjtat mendime në mendje kur ai argumentoi se “një monedhë nuk mund të lindë një tjetër”.

Ka një dimension tjetër psiko-politik për këtë argument. Jetëshkruesi i Kenseyit, Skidelski, në mënyrë intriguese komenton se “Ndjenja e Kenseyit se, që në një nivel shumë të thellë të jetë kapur nga matematika, “dashuria për para”, si një qëllim, jo një mjet, është në themelin e problemit ekonomik të botës” (1992:454). Prandaj, në një nivel themelor të analizës të ashtuquajturat të këqijat e fajdesë duhet të kuptohen si të jenë të lidhura me paranë duke qenë një konstrukt social psikologjik i ligjëruar

nga dinamika e pushtetit të një ekonomie politike të dhënë, e cila mund të jetë ose jo e ligjëruar në mënyrë demokratike dhe të ndërgjegjshme. Një ilustrim i këtij të kuptuari mund të shihet në traditën e Krishterë, ku Jezusi është pyetur nëse duhet t'i paguhen taksa Cezarit. Para se të shqiptonte fjalët e famshme, “I jepni Cezarit atë që i përket Cezarit,” (Lluka 20:25) ai, në mënyrë domethënëse, në fillim kërkon t'i tregojnë një monedhë, dhe pyeti: “E kujt është fytyra dhe mbishkrimi që ka?” (Lluka 20:24). Me fjalë të tjera, “Çfarë strukture pushteti e ligjëron këtë monedhë?” Përgjigja e Jezusit sidoqoftë tha shumë më tepër sesa thjesht “paguani taksat tuaja”. Kjo i dha shkas tamam pyetjes të dinamikës së forcës psiko-shpirtërore, që formojnë rrënjët e thella të marrëdhënies njerëzore në ekonomi dhe të cilat kanë bërë që gjithmonë çështjet e ekonomisë politike të jenë qendrore për dëshmi profetike.

Fajdeja është ajo çka shënon dallimin midis parasë, që është thjesht një mekanizëm abstrakt i kontraktuar në mënyrë shoqërore, për lehtësi midis ofertës dhe kërkesës dhe parasë si një qëllim në vetvete. Si një qëllim në vetvete, si një produkt shoqëror i ligjëruar përmes fajdesë, për të taksuar tjetër veprimtari ekonomike, procesi i ndershmë i të jetuarit me anë të djersës së ballit, është qark që bëhet i shkurtër. Dinjiteti i vërtetë dhe shpërblimi i plotë i punës së zakonshme është rrezikuar. Paraja kështu bëhet forcë vete-përjetësuese në vetvete dhe jo vetëm një faktor ndërmjetës i pushtetit. Dhe është pamëshirshmëria e interesit të shtuar, pa marrë parasysh fatkeqësinë që vendos mizorinë e fuqishme të fajdesë, pavarësisht nga fitimi i bazuar në drejtësi. Në një linjë me komentin e Skidelskit për Keynesin, dikush mund të shikojë se është dashuria për para si një qëllim në vetvete, jo përdorimi i parasë

vet, kjo thuhet të jetë burimi i gjithë të keqes (*Dhjata e Re, I Timoteut* 6). Ishte në pranimin e varfërisë të ketë mekanizma reagimi korrigjues që Islami jo vetëm që e ndalon fajdenë, por edhe imponon zekatin, apo taksën e pasurisë. Dhe ende më radikal, Testamenti i Vjetër propozon një korrigjim ekonomik komplet përmes procesit “Jubile” çdo pesëdhjetë vjet (Levitiku 25), ndonëse nuk ka dëshmi që rishpërndarje e tillë në masë e pasurisë në të gjitha format, ishte kryer vërtet ndonjëherë. Ndoshta është një vizion profetik, koha e të cilit do kohë të vijë.

Fajdeja si faturim i dyfishtë

Një arsyetim pak më i errët u përdor nga Kisha, më vonë në Mesjetë, për të forcuar doktrinën e saj kundër-fajde. Duke hartuar disa prej koncepteve të Ligjit Civil, argumentoj se paraja ishte një e mirë e konsumueshme (e këmbyeshme reciprokisht), sepse zotërimi [pasuria] kaloi nga huadhënësi të huamarrësi gjatë transaksionit të huas (*mutuum*ⁱⁱ) me çmimin e drejtë të “shitjes” duke qenë si pasojë sasia ekzakte e parase së vënë më parë. Prandaj të kërkojë për më shumë në formën e interesit ishte ilegale dhe imorale, “si të shisje një copë bukë dhe pastaj ta ngarkojë [me pagesë] veç për përdorimin e saj” (Birnie, 1952:6). Apo, siç aludon Aquinasi në *Summa Theologiae* të tij, do të ishte si të shisje të njëjtën gjë dy herë (Ruston, 1993).

Fajdeja si shfrytëzim i nevojtarit

Dënimi i fajdesë në formën e ngarkimit për huat për të varfrin dhe nevojtarin është një temë periodike në disa tradita.

ⁱⁱ *mutuum* – Një kontratë, sipas së cilës një send [gjë] që është dhënë hua, duhet të konsumohet dhe duhet të kthehet në formë të ngjashme.

Është i qartë kuptimi kontekstual i pasazheve çifute biblike të Eksodi dhe Levitiku (Enciklopedia çifute, 1971), dhe Ruston sugjeron se “objektivi fillestar i ligjeve mesjetare të fajdesë ishte ekuivalenti mesjetar i “fajdexhiut” [por] teoria mesjetare ishte e pakënaqshme, sepse ajo nuk mund të dallonte huan e dobishme nga ajo tiranike” (1993:173). Shkolla e Sir Sayyed në Islam, në mënyrë të ngjashme interpreton riba si “forma primitive e huadhënies kur paraja jepej për qëllime konsumuese” (Ahmad, 1958:21). Në traditën indiane, ky të kuptuar i fajdesë gjithashtu mund të zbulohet, siç është e dukshme nga ky citim i shekullit të njëzetë: “Fajdeja është – më brutalja, më shtrënguesja, më e pamëshirshmeja ajo – që hapalcën nga kockat e raiyat [kultivuesit] dhe e dënon atë në një jetë mjerimi dhe skllavërie.” (Jain, 1929:110-111).

Ruston pohon (1993) se fajdeja si shfrytëzim i nevojtarit ekziston ende në kohët moderne. Ai citon si një shembull zbulimet e raportit të Institutit të Studimeve të Politikës, 1992, që arrin në përfundim se të varfrit paguajnë më shumë në terma absolut për paranë e tyre, ndërsa kërkojnë kredi vetëm për nevojat absolute sesa të financojnë blerjen e mallrave luksoze që ata nuk mund t’ia lejojnë vetes. Kjo ka dalë nga një studim i aktual nga Këshilli Konsumator Kombëtar, (1995) mbi shërbimet financiare dhe konsumatorët me të ardhura të ulëta; siç e ka thënë një person: “Është si të jesh kapur, u kape, pastaj ata [huadhënësit/bankat] fillojnë të të mbështjellin.” Prandaj, i varfri duhet të dërsijë dyfish vetëm që i pasuri të mund të jetojë me interesin.

Një argument njëloj modern lidhet me impaktin shoqëror shkatërrues të së ashtuquajturës “kriza e borxhit e Botës së Tretë”, një situatë që edhe Papa John Paul II (1989), e pranon në *Sollicitudo Rei Socialis* të tij, kur ai deklaron: “Kapitali i

lypur nga vendet debitorë, për të përmirësuar standardin e tyre të jetesës, tani duhet të përdoret për pagesat e interesit mbi borxhet e tyre". Kjo shfaqje kritike moderne e fajdesë është trajtuar më në thellësi dhe hollësi në veprat gjithë-përfshirëse të Susan George-it, *Më mirë një Fat më i keq sesa Borxh* (1988) dhe *Borxhi Bumerang* (1992) midis shumë të tjerave. Për tani, ia vlen vetëm të nxirren në pah kritikët e sistemit të veprimit bankar Islamik të lirë nga interesi; që nëse borxhi kryesor gjatë 1970-tës, ishte dhënë mbi një bazë investimi drejtësie, vendet debitorë nuk do të ishin kapur në shqetësimin e interesit të shtuar në norma të vendosur nga faktorë jo të brendshëm makroekonomik. Kostot e shërbimit nuk mund të jenë zhvilluar, kur në të njëjtën kohë shumë çmime mallrash paguar ndaj vendeve debitorë, u rrënuan. E ardhura në kapital dhe ndoshta vetë shpërblimi kapital, duke qenë i krahasueshëm me një mirëqenie ekonomike të vendit, do të jetë luhatur sipas aftësisë për të paguar. Vendet debitorë do të kenë shijuar si pasojë sigurim fiskal të ngjashëm me atë të një kompanie të pajisur dobët. Natyrisht, fakti se shumë borxh themelor përfshin dollarë të ricikluar nga nafta, që prodhojnë vendet myslimane është një ironi, dhe një turp, që nuk duhet t'i shpëtojë dhe vëzhgimit të thjeshtë me sy dhe të shihet hipokrizia e vendeve që promovojnë fajdenë, si Britania dhe Shtetet e Bashkuara udhëheqësit e të cilave shpesh proklamojnë vlerat e krishtera. Sidoqoftë, duke zbatuar qasjen islamike, shumë prej mjerimit njerëzor mund të ishte shmangur. Duke zbatuar të njëjtin parim, ky do të mund të ishte shembulli për individë të panumërt dhe ndërmarrje të kapura në grackën e varfërimit përmes borxhit jothemelor.

Fajdeja si një mekanizëm i rishpërndarjes së padrejtë të pasurisë.

Vërejtja se fajdeja vepron si një mekanizëm me anë të të cilit "i pasuri bëhet më i pasur dhe i varfri bëhet më i varfër", është e përbashkët për shumë tradita. Islami nuk e pranon interesin financiar mbi baza që ai hedh poshtë parimin e shpërndarjes së drejtë që ekonomia politike e tij përpiqet ta ruajë: "*Interesi në çdo vlerë vepron në transferimin e pasurisë nga sektori pa aset i popullsisë*". (Choudhury dhe Malik, 1992:51). Duke ardhur nga një perspektivë plotësisht e ndryshme si një vet deklaruës "individualist", Birnie arrin një konkluzion të ngjashëm: "*Interesi, duke e bërë kapitalin pothuajse një monopol, në mënyrë të efektshme ndalon vendosjen e një sistemi të vërtetë konkurrues*" (1958:1). Kenedi (1992) jep disa dëshmi empirike të shkëlqyera të kësaj dukurie, që lidhen me Gjermaninë më 1982. Ajo tregon se, kur 2.5 milion familjet më të varfra paguan (neto) 1.8 bilion DM (marka gjermane gjatë viteve 1948-2002) në interes, 2.5 milion familjet më të pasura morën (neto) 34.2 bilion DM. Ajo madje vazhdon të sugjerojë se ky mekanizëm i mbuluar i rishpërndarjes, teknikisht vepron kundër të drejtave kushtetuese të individit, në shumë vende të caktuara, që paraja është një shërbim shtetëror të i cili publiku duhet të ketë akses të barabartë.

Efekti psikologjik i kësaj mbi të varfrin, në mënyrë relative, mund të shihet të zmadhohet kur thjesht vlerësime sasiore të transfertave nga i varfri të i pasuri, zëvendësohen nga interesimi i kostos kualitative të një transferimi të tillë pasurie. Për të pasurin në mënyrë relative, leverdia e fitimit e siguruar nga fajdeja është marginale ndaj leverdisë tashmë substanciale të

shumës themelore. Parimi i zvogëlimit të leverdisë marginale të pasurisë, si pasojë aplikohet në çdo njësi shtesë të pasurisë të siguruar nga fitime interesi. I varfri, sidoqoftë, përjeton të kundërtën e kësaj. Për ta, humbja në leverdi [dobi] e shkaktuar nga që duhet të paguajë interes është në mënyrë kualitative më e madhe sesa fitimi për të pasurin. Çdo njësi e interesit të paguar shkakton rritjen e humbjes së leverdisë marginale. Lejimi i fajdesë që të operojë në një ekonomi, si pasojë zvogëlon leverdinë e përgjithshme në ekonomi. Kjo mund të konsiderohet si një nga argumentet më të forta kundër fajdesë. Çdo justifikim i saj, si një instrument ekonomik eficient, do të duhet së pari të demonstrojë se ajo funksionon për të shtuar leverdinë totale. Në mungesë të demonstrimit të tillë, ajo mund të dënohet në mënyrë të justifikueshme si një mjet i tiranisë.

Fajdeja si një faktor i paqëndrueshmërisë ekonomike

Kundërshtimi kryesor i Gesellit (1904) ndaj interesit është se ai është një faktor endemik në paqëndrueshmërinë e ekonomive të bazuara në interes, d.m.th ciklet e bumit dhe dështimit, recesionit [rënies] dhe rigjenerimit. Në mënyrë të ngjashme, Ahmad, duke argumentuar nga një perspektivë islamike, pretendon “problemi më i madh në ekonominë kapitaliste është ai i krizave [dhe] interesi luan një rol të veçantë në shkaktimin e tyre” (1958:36). Edhe Keynesi, luftëtar për politikën monetare të bazuar te interesi, pranon faktin se “norma e interesit nuk është vetrregulluese në nivelin që i shkon më mirë përfitimit shoqëror por vazhdimisht synon të ngrihet më lart” (1936:350). Kenedy (1995) është më i guximshëm, duke sugjeruar se rritja shtesë e interesit në fakt mund të shkaktojë inflacion. Ajo tregon, për shembull, sesi në Gjermani, kur e ardhura

qeveritare, Produkti i Përgjithshëm Bruto, dhe fitimet dhe pagat e ardhura mesatare e fituesit [personit] u ngrit afërsisht rreth 400% midis viteve 1968 dhe 1989, pagesat e interesit të qeverisë u ngritën me 1,360%, që ajo pohon, le të nënkuptojë një efekt inflacioni.

Fajdeja si ulje [zhvlerësim] e së ardhmes

Arsyeja e fundit e përmendur për të dënuar fajdenë lidhet me konceptin dhe praktikën e zhvlerësimeve [pakësimin] të vlerave të ardhme. Nga që interesi i shtuar çon në një vlerësim në kapitalin monetar të investuar, është konsideruar e arsyeshme për njerëzit për të parapëlqyer të kenë një sasi specifike parash [kesh] tani, sesa të njëjtën sasi ndonjë ditë në të ardhmen. Kjo logjikë e thjeshtë, rrallë dyshuese, ka disa ngatërresa shkatërrimtare. Për shembull, Pearce dhe Turner (1990), vunë re se zhvlerësimi prek normën në të cilën ne harxhojmë burime natyrore - sa më e lartë norma e zhvlerësimit (e rrjedhur pjesërisht nga norma e interesit), aq më shpejt burimet janë të mundshme të shterojnë. Daly dhe Cobb (1990), e morën këtë vërejtje në konkluzionin e tyre logjik dhe treguan se zhvlerësimi [ulja] mund të çojë në zhdukjen “e arsyeshme ekonomikisht” të një lloji, thjesht nëse norma e fitimit ekzistuese, ndodh të jetë më e madhe sesa norma e riprodhimit të llojit të shfrytëzuar. Një pasojë tjetër e parimit të zhvlerësimit, argumentuar nga Kula, është se “në vlerësimin e projekteve të investimit afatgjatë, veçanërisht ato në të cilat përfitimet dhe kostot janë të ndarë nga njeri-tjetri, me një interval të gjatë kohe, rregullat e vlerës së pranishme neto, udhëheqin marrësin e vendimit të shtojë në maksimum dobinë [leverdinë] të brezave aktualë në dëm të atyre të së ardhmes” (1981:899).

Në këtë kontekst, është e përshtatshme të vërejmë se, tipari kryesor që dallon ekonominë financiare nga ekonomia e natyrës, është se njëra operon mbi një bazë interesi të shtuar, ndërsa tjetra është bazuar në interesin e thjeshtë. Paraja e depozituar në bankë mund të japë 10% plus interes mbi shumën e shtuar vitin pasardhës, por në natyrë, nëse ju lini prodhimin e këtij viti të mollëve në pemë, ju vështirë se merrni një prodhim më të bollshëm, në mënyrë të shtuar vitin tjetër! Prandaj, fajdeja lejon një ndarje midis ekonomisë financiare dhe asaj ekologjike. Rezultati është: ose shkatërrim progresiv i natyrës, ose në mungesë të drejtësisë së rishpërndarjes shoqërore, një nevojë e pranishme [e përfshirë në strukturë] për dështime periodike financiare gjatë gjithë historisë. Kuptimi është treguar mirë nga ilustrimi se nëse Juda Iskariot do të kishte investuar tridhjetë monedhat e tij të argjenda, me vetëm pak normë përqindje (percentage point) rritje, të ripagueshme në argjend si i sotmi, shuma e argjendit e kërkuar do të ishte e barabartë me peshën e Tokës.

Etika e nënkuptuar, apo mungesa e kësaj, e zhvlerësimit [uljes] mund të përdoret për të ilustruar qartë, përse fajdeja prish botën natyrale si edhe marrëdhëniet shoqërore. Për shembull, kini parasysh impaktin e vlerës së pranishme neto të ulte metodologjinë e qarkullimit të parasë në vlerësimin e shkëmbimit midis kapitalit natyral dhe atij të krijuarit nga njeriu, që, gjatë plotësisë së kohës, mund të justifikohet, zakonisht vetëm nëse dobia e brezave të ardhshëm është ulur (McIntosh, 1996). Kjo shkel drejtësinë ndër-breznore, një parim kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm të njohur nga Komisioni i Brundtland-it 1987 dhe Samiti i Rio Earth-it 1992 i Kombeve të Bashkuara. Ajo gjithashtu

shkel një perceptim të vjetër të jetesës së drejtë, që fluturon pa marrë parasysh supozimin e vlerës kohore të parasë, në të cilën normat e interesit janë bazuar: domethënë, ajo shkel mundësinë e shumë përdoruesve tradicionalë të tokës që toka duhet t'i kalohet brezit tjetër, të paktën me aq dashamirësi siç ishte trashëguar nga stërgjyshërit. Zhvlerësimi si sfond i fajdesë, mund të paraqitet kështu si mjet i trishtuar i përdorur për të justifikuar vjedhjen e të ardhmes së fëmijëve. Kërkimi i bazave teorike dhe ilustrimet praktike të këtij argumenti, ndoshta sigurojnë shumë mundësi për hulumtim mikro dhe makro ekonomik në ekonominë ekologjike.

NJË APLIKIM MODERN I NDALIMIT TË FAJDESE

Veprimi Bankar Islamik

Një pjesë e mëparshme mbi ndalimin islamik të fajdesë përmend mospranimin nga Islami të interesit financiar apo *riba*, kryesisht mbi baza të shpërndarjes negative të drejtësisë dhe efekteve të drejta. (Khan, 1986). Nga ky ndalim janë zhvilluar ndoshta sistemet më të sofistikuar dhe tërësisht teorike të ekonomisë politike të interesit të lirë në botë (Choudhury dhe Malik, 1992).

Metodat e veçanta për të implementuar operacionet bankare Islamike janë qendëruar rreth qasjeve të bazuara në drejtësinë financiare, më veçanërisht *Mudarabah* – një *xhoint vencer*⁽ⁱⁱⁱ⁾ midis bankës dhe një “partneri” të dy që kontribuojnë në kapitalin e projektit dhe ndajnë fitimin apo humbjen – dhe *Musharakah* – në të cilin, gjithë kapitali për një investim është siguruar nga banka

ⁱⁱⁱ Xhoint vençer (*Joint venture*) = Ndërmarrje e përbashkët, me kapitale të përbashkëta të dy a më shumë ndërmarrjeve. (Shën.përkth.)

si shpërblim për një pjesë të paracaktuar të përfitimit apo humbjes së biznesit të ndërmarrë (Khan & Mirakhor, 1986).

Banka e parë moderne Islamike e themeluar më 1960 në Egjipt (Bankieri, 1989) dhe në tre dekadat e ardhshme, veprimtaria bankare Islamike është rritur në një industri me 80 bilion \$ në depozita dhe 100 banka dhe kompani financiare (Khalaf, 1995). Shumë nga kjo rritje ka qenë rezultat i përpjekjeve tërësore nga Irani, Pakistani dhe Sudani gjatë 10 viteve të kaluara për të ristrukturuar sistemet e tyre të operacioneve bankare kombëtare për t'i sjellë ato në përputhje me ligjin Islamik të Sheriatit (Aftab, 1986; Ekonomisti, 1992). Veç kësaj, numrat e shtuar të bankave jashtë këtyre vendeve, përfshirë vendet Perëndimore, kanë filluar të ofrojnë shërbime bankare Islamike paralele (O'Brien & Palmer, 1993). Deri më 1996, Mbretëria e Bashkuar bashkoi këto seri të fundit, me Banka Tregtare Flemmings (1996) duke ofruar shërbimin e parë bankar Islamik, Fondi Oaze, për klientët britanikë.

Avantazhet e pranuar të qasjes bankare Islamike për financën janë se çojnë në: më shumë të drejtë dhe shpërndarje të paanshme të burimeve; më shumë përgjegjësi dhe huadhënie fitimprurëse, në saj të marrëdhënies medoemos më të ngushtë klient-bankë; më pak cikle biznesi të paqëndrueshme; dhe më shumë sisteme bankare të qëndrueshme (Taylor & Evans, 1987); si edhe “*efiçencë relative të sistemit të parasë interesi i lirë ndaj sistemit alternativ bazuar te interesi*” (Darrat, 1988). Nga ana tjetër industria bankare Islamike është kritikuar mbi një numër problemesh gjithashtu; për mungesën e saj të uniformitetit dhe standardizimit të produkteve, sisteme llogaritje dhe aprovime nga borde të ndryshme *sharia* (Khalaf vepër e cit); komplikacione të

ndryshmetë borxheve-të këqija (Shreeve, 1988); ngarkesë mbledhje-informacioni mbi konsumatorë potencialë dhe bankat vetë për të garantuar sigurinë dhe fitimprurshmërinë e fondeve të tyre, si edhe mungesa e një mekanizmi normë interesi për ta përdorur si mjet makroekonomik (Ekonomisti, 1992). Megjithatë, këto kufizime duhet të shihen ndaj sfondit të operacioneve bankare Islamike si një treg i ri novator dhe i zhvilluar.

PËRFUNDIME

Kumtesa e mësipërme është përpjekur të përshkruajë me pak fjalë historinë ekstensive të kritikës së fajdesë, dhe për të kristalizuar dhe sintetizuar bazat kryesor të argumenteve të përdorura në mbështetje të këtij pozicioni. Fakti që jetojmë në një sistem ekonomik global, që është më shumë se kurrë më parë i bazuar në interes\kamatar si pasojë, shtrën pyetjen: A janë secila prej këtyre kritikave të së kaluarës, ose serioze dhe mjaft bindëse, ose aktualisht mjaft të përshtatshme për të merituar një sfidë legjitime për gjendjen ekzistuese? Në opinionin e autorëve, secila prej arsyeve të cituara në kritikën e fajdesë, ndoshta me përjashtimin e “faturimit të dyfishtë”, duket më urgjente dhe e përshtatshme tani sesa kurrë. Në veçanti, është besimi i autorit se individët apo organizatat në Perëndim me para për të investuar, veçanërisht ata që iu pëlqen ta quajnë veten si të moralshëm, mund të kenë disi më shumë për të mësuar nga Islami, sesa është e pranuar në përgjithësi. Por së pari, shoqëria ka nevojë të rindërgjegjësohet për lidhjen e debatit të fajdesë së vjetër në kohët moderne.

Bibliografi:

- Aftab, M. (1986) "Lëvizjet pakistaneze në veprimtarinë bankare Islamiqe", *Bankieri* 136: 57-60.
- Ahmad, S.A. (1958) *Ekonomia e Islamit (Një studim krahasues)*, Lahorë, India: Sh. Muhammad Ashraf.
- Banka Tregtare Flemmings (1996) *Prospekt Fond Oazë*
- *Bankieri* (1989) "Veprimtaria Bankare Islamiqe" Maj, 12-13
- Birnie, A. (1958) *Historia dhe etika e interesit*, Londër: William Hodge & Ko.
- Blaxton, J (1634) *Fajdexhiu anglez, apo fajdeja e dënuar*, Rishtypur Amsterdam: Theatrum Orbis Terrarum, 1974.
- Choudhury, M.A. dhe Malik, U.A. (1992) *Themelet e ekonomisë politike islamiqe*, Londër: MacMilan.
- Culpeper, T (1621) *Një trakt kundër fajdeve*, rishtypur, Amsterdam: Theatrum Orbis Terrarum, 1974.
- Daly, H. E. dhe Cobb, J. B. (1990) *Për të mirën e përbashkët*, Londër: Greenprint.
- Darrat, A. F. (1988) "Sistemi bankar Islamik i Interesit të Lire: Disa dëshmi empirike", *Ekonomi e Aplikuar* 20 (3): 417-25.
- Douglas, C. H. (1924) *Kreditit shoqëror*, Belfast: Publikime K. R. P.
- *Ekonomisti* (1992) "Interesi i Islamit", 18 janar, 59-60
- *Ekonomisti* (1992) "Veprimtaria bankare përtej vellos", 4 prill.
- *Enciklopedia e fute* (1912), vol. XII, Nju Jork dhe Londër: Funk & Wagnals Ko.
- *Enciklopedia e fute* (1971) Volumi 16, Jerusalem: Shtëpia botuese: Keter.
- Fenton, R. (1611) *Një traktat i fajdeve*, rishtypur, Amsterdam: Theatrum Orbis Terrarum, 1974.
- Fischer, I. (1933) *Para 100%*, Nju Jork: Botuesit Adelphi
- George, S. (1988) *Një fat me i keq sesa borxh*, Londër: Penguin
- George, S. (1992) *Borxhi Bumerang*, Londër: Penguin
- Gesell, (1904) *Die Naturliche Wirtschaftsordnung*, Nurenberg: Rudolf Zitsman Verlag.
- Jaddlow, J. M. (1977) "Adam Smith mbi Ligjet e Fajdese", *Revista e Financës*, 32: 1195-200.
- Jain, L. C. (1929) *Veprimtaria bankare indigjene ne Indi*, Londër: MacMilan & Ko.
- Kennedy, M. (1995) *Interesi dhe inflacioni i parës së lirë*, Okemos Seva International
- Keynes, J. M. (1936) *Një teori e përgjithshme e punësimit, interesit dhe parës*, Londër: MacMilan & Ko.
- Këshilli Kombëtar i Konsumatorit (1995) "Raport mbi shërbimet financiare dhe konsumatorëve me të ardhura të ulëta" Londër: NCC.
- Khalaf, R. (1995) "Shtesa e analizuar e veprimtarisë Bankare Islamiqe", *Financial Times*, 28 Nëntor.
- Khan M.S. (1986) "Veprimtaria Bankare Islamiqe e interesit të lirë", *IMF Staff Papers* 33; 1-27.
- Khan, M. S. dhe A. Mirakhor. (1986) *Kuadri dhe praktika e veprimtarisë Bankare Islamiqe. Financa dhe Zhvillimi*, shtator, 32-36
- Kisha e Skotlandit (1988) *Raport i Komisionit Special mbi etiken e investimit dhe operacionit bankar*.
- Kula, E. (1981) "Brezat e ardhshëm dhe zhvlerësimi i rregullave në vlerësim të investimeve të sektorit publik", *Mjedisi dhe Planifikimi*. A. 13; 899-910.
- Levy, D. (1987) "Rasti i Adam Smithit për ligjet e fajdese", *Historia e Ekonomisë Politike*, 19; 387-400.
- McGrath, A. E. (1990) *Një jetë e John Calvin*, Londër: Shtypi Blackwell.
- McIntosh, A. (1996) "Gabimi i supozimit të zhvlerësimit simetrik në zhvendësimin e kapitalit natyral dhe të krijuar nga njeriu." "Revista e Ligjit dhe Fesë", XI.2 (e ardhshme).
- O'Brien, J. dhe M. Palmer (1993) *Gjendja e atlasit të fesë*, Londër Simon dhe Shuster.
- Pandya, N. (1996) "Rritja e interesit në Islam", *Guardian Money*, 25 Maj.
- Papa Leo XIII. (1981) *Revum Novarum: Enciklikë mbi gjendjen e klasave punetore*, Botim studim qindvjeçar, Londër: Shoqëria e Vërtetë Katolike, 1983.
- Pearce, D. W dhe Turner, R. K. (1990) *Ekonomia e burimeve natyrale dhe mjedisi*, Londër: Harvester Wheatsheaf.
- Price, C. (1990) *Koha, zhvlerësimi dhe vlera*, Oksford: Blackwell
- Ruston, R. (1993) "A ka rëndësi se çfarë bëjmë ne me paratë tona?" *Priftërinjtë dhe njerëzit*, Maj, 171-77.
- Simons H. C. (1948) *Politika ekonomike për një shoqëri të lirë*, Çikago: Universiteti i Shtypit të Çikagos.
- Skidelsky, R. (1992) *John Maynard Keynes: Ekonomisti si shpëtimtar, 1920-1937 Volumi 2*, Londër: MacMillan.
- Smith, H. (1951) *Një Përgatitje për martesë; Nga Darka e Zotit; Nga fajdeja*, rishtypur, Amsterdam: Theatrum Orbis Terrarum, 1975.
- Soddy, F. (1926) *Pasuria, pasuria virtuale dhe borxhi*, Nju Jork: Dutton.
- Shreeve, G. (1988) "Pagimi i çmimit të suksesit tënd" *Bankieri* 138: 17018.
- Taylor, T. W. Dhe Evans J. W. (1987) "Banka Islamiqe dhe ndalimi i fajdese ne mendimin ekonomik perëndimor", *Banka Kombëtare Wesmenister, Reviste tremujore*, Nëntor 15-27.
- Wilson, T. (1572) *Një diskutim mbi fajdenë*, rishtypur, Londër: G. Bell & Sons, 1925.

Fundshënimet:

- (1) Nga më të rëndësishmet e këtyre mësimëve në: Suren 2 ajetet 188, 274-280; Suren 3 ajeti 130; Suren 4 ajetet 29, 161; Suren 9 ajetet 34, 35, 43; Suren 30 ajeti 39.
- (2) Eksodi 22:24-25; Levitiku 25:35-37; Ligji i përtërirë 23:19-21; Ezekieli 18:20; Fjalët e urta 28:8; Psalmet 15:5; Nehemia 5:7.
- (3) 1 i Samuelit 22:2; 2 i Mbretërve 4:1; Isaia 50:1.
- (4) Për më shumë të dhëna të hollësishme të dorës së parë në debatin teologjik mbi fajdenë, veçanërisht gjatë shekujve të 16 dhe 17, disa tekste të ribotuara origjinale nga kjo periudhë përfshijnë autorët: Blaxton (1974); Culpeper (1974); Fenton (1975); Smith (1975) dhe Wilson (1925).
- (5) Lluca 6:34.

Për autorët:

Wayne A. M. Visser është themeluesi dhe Drejtuesi i CSR International (Corporate Sustainability & Responsibility) si dhe autor i shtatë librave, ndër të cilët pesë libra të tij trajtojnë rolin e biznesit në shoqëri.

Alastair MacIntosh është autori i *“Tokë dhe shpirt: Njerëzit kundër pushtetit të korporatës”*, e shkruar së bashku me George Monbiot dhe Peshkopi i Liverpoolit si “një libër që të ndryshon-jetën”. Ai është një Mik i Qendrës së Skotlandës për Ekologjinë Humane, dhe ka botuar shume artikuj mbi çështje të gjendjes në botë dhe nevojën për t’i kuptuar ato nga një perspektivë shpirtërore. Një Kuaker në traditën e krishterë, ai shërben

si një këshilltar për Xhaminë Qendrore të Glaskout dhe zhvillon leksione për rëndësinë e bashkëjetesës paqësore në Joint Services Command & Staf Kolegji – Kolegji ushtarak kryesor Britanik. Shumë nga veprat e tij mund t’i gjeni direkt në:

<http://www.alastairmcintosh.com>

Redaksia e Vërtetësisë u është mirënjohëse autorëve dhe i falënderon me respekt që na dhanë leje për ta ribotuar në gjuhën shqipe këtë artikull të botuar në revistën e Xhematit Mysliman Ahmadia *“The Review of Religions”*. Redaksia gjithashtu falënderon dhe ekonomistin Ilir Dule.

E përktheu në gjuhën shqipe – Çapajev Zera.

Interesi dhe vërejtje mbi “Krizën e Kredisë” (“Credit Crunch”)

Poshtë shënim mbi Krizën e Kredisë, 2009:

E ashtuquajtura *“Kriza e Kredisë”* globale (e përcaktuar si “një sasi e munguar e theksuar e parasë apo kreditit”) mendohet në përgjithësi të ketë “filluar” më 9 gusht të vitit 2007, kur shifrat shqetësuese nga Banka Franceze Paribas BNP ngritën koston e kredisë dhe zgjuan komunitetin financiar për një seriozitet më të madh të situatës (shiko *timeline* të detajuar të BBC-së në <http://news.bbc.co.uk/1/business/7521250.stm>).

Përfund kësaj kishte pasur një ngritje në normat e interesit të Shteteve të Bashkuara ndërmjet viteve 2004 dhe 2005 nga 1% në 5.35% që rezulton në nivelet e larta të mospagimit në kufi të “këstit të kredisë”, që do të thotë, kufi i rrezikut të lartë të tregut të shtëpive të banimit. Nga që kreditorët hipotekorë kishin shitur borxhet e tyre nëpërmjet fondeve të investimeve private të siguruara në institute të tjera financiare,

si pasojë e pa përgjegjësisë, huadhënia u përhap me shpejtësi përmes sistemeve bankare, veçanërisht në Perëndim, duke qene se çmimet e shtëpive filluan të bien dhe vlera themelore e pasurisë së paluajtshme që përforconte borxhet u bë negative. Kur Paribas BNP u tha investitorëve të saj se ata nuk do të mund të tërhiqnin para nga dy prej fondeve të tyre për shkak të një “zhdukje të plotë të likuiditetit”, ishte nisja e një efekti domino, që i detyroi qeveritë të ndërhyjnë dhe të evitojnë vërshimet potencialisht katastrofike në bankat kryesore.

Nga perspektiva e kumtesës tonë mbi fajdenë, të cilën ne tanie rishikojmë sërish më shumë se një dekadë pas publikimit të saj të parë me 1998, ne e konstatojmë atë udhëzuese për të pasqyruar sesa larg mund të shtrihen probleme të tilla në përgjegjësinë e një sistemi bankar të bazuar te interesit. Interesimi i plotë është përtej qëllimit tonë aktual, por në këtë poshtëshënim ne do të kufizohemi

të bëjmë tri vërejtje të shkurtra.

E para, kriza e kredisë ishte pasojë e një projekti krediti paraprirës në mënyrë të pashmangshme shpërthyes. Ne disa vende Perëndimore, përfshirë Britaninë dhe Amerikën, qeveritë kishin çrregulluar agjencitë financiare në një nivel ku huadhënia e pa përgjegjshme u bë gjendje normale. Për shembull, në Britani, gjatë tërë vitit 2008, ishte e lehtë për njerëzit të merrnin hua hipotekare në vlerë të 120% të vlerës së pronës duke pasur vetëm pak kërkesa. Çmimet e pasurisë po ngriheshin befas, ekonomia globale po lulëzonte dhe kujdesi tradicional bankar po shpërfilllej. Njerëzit ri-hipotekonin shtëpitë e tyre për të shlyer borxhet e kartës së kreditit, që mbanin norma shumë të larta të interesit, dhe që u ishin shitur atyre nga një marketing agresiv. Njerëzit kishin filluar të besonin se vlerat e shtëpive gjithmonë në rritje, dhe kohët e mira ekonomike do të krijonin gjithnjë vlera pasurie që do t'ua kalonin vazhdimisht detyrimeve të tyre. Duke mos e larguar këtë ide, huadhënësit drejtues e shfrytëzuan atë. Stafi City [Komuniteti Financiar Britanik] u shpërblye me shtesa të mëdha “si për persona të pasur” të bazuara në madhësinë dhe sasinë e huave të dhëna. Shqetësimeve rreth vlerës së përgjithshme të aksioneve të portofolit të kredisë së tyre u ishte mbyllur goja përmes sigurisë – shitjes dhe përhapjes nga rreziku në tregjet që vijnë në mënyrë spekulative.

Ndërsa kushdo luante lojën dhe normat e interesit mbetën të ulura, sistemi dukej të funksiononte. Ai arriti mundësi investimi me shpërblime të larta. Por duke qenë se normat e interesit të Shteteve të Bashkuara u ngritën në një përpjekje të nevojshme për të neutralizuar efektet ekonomike të pa menduara të inflacionit të çmimit të shtëpisë, pasojat e blerjes

në një sistem kamatar dhe të nxitur nga lakmia filluan të kuptoheshin plotësisht. Normat e mosplotësimit të borxhit arritën pikat e krizës. Ata që ishin në gjendje ta shikonin atë duke ardhur, kryesisht pasanikët dhe të mirë-këshilluarit që kishin një variacion më të madh të opsioneve financiare të hapura për ta, ishin në gjendje të dilnin nga balta në kohë. Ata që ishin kapur me pak zgjedhje nëse donin të blinin një shtëpi për të banuar në të, ishin shtrënguar, të lënë shumë familje të reja tani në luftë për të shlyer borxhet me qenë se vlerat e shtëpive të tyre ranë në vlera negative të kapitalit fillestar. Siç vëren media me të drejtë, fitimet e *Wall Street-it* janë humbjet e *Main Street-it*, me efekte negative të spekulimit financiar të kaluara në shoqërinë si e tërë.

Nga kjo, ne mund të mësojmë se një ekonomi që kanonizon lakmi, instalon gati dobësi katastrofike që godasin përfundimisht më rëndë të varfrin.

Argumenti ynë i dytë është se globalizimi ndërsa krijon pasuri të mëdha ekonomike të reja nga tregtia e çrregulluar, ka pakësuar elasticitetin [ose aftësinë ripërtëritëse] në sistemin financiar botëror. Barrierat mbrojtëse ndërmjet ekonomive të vendeve të ndryshme që po mbaheshin në vend nga masat si kontrollet në transaksionet me monedhën e huaj, në thelb u braktisën në vitet që pasuan ekonominë “politike e tregut të lirë” të Reganit dhe Theçerit. Të lehtësuar nga planifikimi i prodhimit të kompjuterizuar dhe kontrollit të gjendjes së mallit, ide të reja të sistemeve tregtare të furnizimit në kohë me fitim maksimizuan efikasitetin ekonomik. Por këtu kishte një kosto të fshehtë. Kjo gjithashtu zvogëlonte elasticitetin [aftësinë ripërtëritëse] që lejon ngecja në zinxhirët tepër të ndërrarura të furnizimit. Pa ngecje rrjetet e furnizimit,

si sistemet socio-ekologjike në të cilat ato varen, bëhen të brishta. Ata bëhen të prira për t'u thyer dhe të përthyer kur vendosen nën tryzni. Dhe për një sistem furnizimi ekonomik të bazuar monetarisht, një bankë e zbratur nga likuiditeti, është si një makinë që befas ka mbetur pa vaj. Pa lubrifikim motori vërtitet deri në një ndalesë të beftë. Ja sepse më 2008 qeveritë lanë opsionin e vetëm të nxirrnin nga balta bankat.

Kjo humbje e elasticitetit është ajo çka dallon situatën aktuale prej shembjes së bankave të 1920-ës. Atëherë, shoqëria dhe veçanërisht prodhimi i ushqimit të saj ishte më pak i industrializuar. Njerëzit jetonin më afër me token. Shërbimet më thelbësore si prodhimi i ushqimit ishin produkte lokale për konsum lokal. Por sot, zinxhirët themelore të furnizimit janë të gjatë, shpesh globalë, dhe si pasojë subjekt të tregut ndërkombëtar dhe trilleve financiare. Një shikim i shpejtë i pasojave të një varësie të tillë mund të shihet nga ajo që ndodhi në Britani në shtator të vitit 2000, kur shoferët e kamionëve cisterne bënë grevë. Brenda pesë ditëve, blerja në panik boshatisi disa rafte të supermerkatove dhe media përcolli raporte sporadike të luftimit në arkat e pagesave. Qeveria e Blerit, duke iu trembur një shqetësimi civil, kapitulloi. Aplikuar në situatën më 2008, ne mund të pyesim, mund të kishte shpërthyer më shumë shqetësim, nëse dështimi bankar kishte rezultuar në humbje të beftë të lubrifikimit financiar me efektet e saj logjike të menjëhershme e të pa menduara?

Ne mund të mësojmë prej kësaj se rreziqet janë shumë të larta për qeveritë për të larë duart e rregullimit të ekonomive moderne. Të çliuara [nga prangat] tregjet e lira ekspozojnë strukturën e vërtete të shoqërisë civile ndaj ligjit të xhunglës në një ditë të keqe. Tregjet e çrregulluara rastësisht mund të jenë vetëm dukuri

të përkohshme, si shpërndarje e picës së lirë. Për arsye të natyrës së tyre abstrakte, të bazuar në konfidencë – fjala do të thotë “besim bashkërisht” – tregjet financiare janë përherë e më shumë të paqëndrueshme. Paturpësia me të cilën projektuesit financiarë apo më mirë, tregtarët, u përpoqën të përhapnin rrezikun duke krijuar “produkte” derivate të nxitura së fundi nga normat hipotekore të interesit dhe efektit të tyre në vlera pasurie zbulojnë një rrënim masiv të përgjegjësisë. Ky rrënim ndodhi sepse besimi devijoi lidhjen e interesit të drejtpërdrejtë në asete të prekshme në lidhjet abstrakte financiare që mund të ndodhë shumë herë të largohen dhe të dobësohen nga realiteti në vend. Derivate të tilla ishin bërë anije fantazie. Të lira nga spirancat, ato enden kot, pa koordinata në pika referimi të realitetit derisa të godasin shkëmbinjtë.

Vërejtja jonë e **tretë** është se shumë njerëz pyesin nëse “*kriza e kreditit*” (termi tingëllon çarmatosës si një paketë ushqimi mëngjesi, me një dhuratë të lirë brenda), sinjalizon “fundin e kapitalizmit”. Përkundrazi, nemendojmë se kjo paraqet vetëm një spazmë ciklike në procesin me anë të të cilit kapitalizmi periodikisht ristrukturon vetveten në një përplasje që më shumë dëmton të dobëtin. Pasoja e humbjeve të punës dhe rizotërimit në tregun e shtëpive janë të tilla që disavantazhet relativisht, tani të ngarkuara shumë me vlerë negative, do të detyrohen për të punuar më shumë me afat të gjatë për të shlyer borxhet, duke përfshirë dhe pjesën e tyre të borxhit kombëtar që do të paraqitet në ngritjen e taksave. Si i tillë, kreditorët – shume prej limaneve të tyre të taksave në det të hapur – ruajnë dhe rikonsolidojnë një kapje që ata nuk do ta kishin pasur nëse pjesëmarrja e tyre në proces të kishte qenë përmes ndarjes së rrezikut të interesit të pronësive, si me parimet bankare

Islamike. Këta investitorë në të ardhmen, do të jenë njerëz që gjejnë veten në një pozitë të kaparosit kapitalin e shtëpive të riposeduara (që do të thotë, faliment) dhe në këtë mënyrë shtrëngojnë krahët e tyre në të ardhmen si rentierë të ata që kanë humbur. I varfri relativisht do të detyrohet të punojë akoma më fortë mbi një punë rutine që dëmton jetën familjare dhe bashkë me të, dobëson strukturën e ardhshme të shoqërisë.

Kapitalizmi mund të kuptohet në nivele të ndryshme, nga tregtia e ndershme dhe aktiviteti sipërmarrës gjatë gjithë versionit të tij kazino të përparuar Anglo-Amerikan. Në këtë të fundit, roli i parësë pëson një ndryshim. Ai ndryshon nga roli i tij parësor si një mjet i regjistrimit dhe lubrifikimit të shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve. Ai kërkon në rend të dytë cilësi abstrakte që janë spekulative. Këtu paratë vetëm gjenerojnë më shumë para, dhe parimi i fajdesë - duke e përcaktuar atë si hua paraje në norma vërtet pozitive të interesit (d.m.th. norma më të mëdha sesa duhet për të mbuluar inflacionin dhe rrezikun) është motori i brendshëm nxitës i këtij sistemi.

Megjithatë ne besojmë se kapitalizmi në një formë apo tjetër është këtu për të qëndruar, “*kriza e kreditit*” mund të arrijë në histori si sfida më serioze ende në kapitalizmin spekulativ të përparuar financiarisht. Që këtë elektoratet dhe qeveritë e tyre duhet të japin me shumë mendim të pjekur ndaj parimit oligarkik të lejimit të aq shumë pushteti dhe hapësire ndaj aksionareve dhe analistëve të tyre financiarë, motivimi i investimeve të të cilëve është thjesht për të “spekuar në fonde [ose tregje].”

2009 ka të ngjarë të shënojë pikën në të cilën lavjerrësi fillon të lekundet pas në tregjet më të rregulluara fuqimisht nga ana financiare. Siç del e qartë, kjo qasje është tërësisht e qëndrueshme me

filozofinë e ikonës së ekonomistëve Adam Smithin (që ishte mbi të gjitha një “filozof moral”) dhe John Maynard Keynes (që paralajmëroi rrezikun ndaj aktiviteteve spekulative). Për ironi, këto janë cituar shpesh nga fundamentalistët e tregut neo-liberal në mbështetje të qëndrimit të tyre çrregullues ekonomik. Secili prej nesh, që ka marrë pjesë me dijeni në ekonominë kazino të lidhur me fajdenë, ndan përgjegjësinë për atë që ka ndodhur. Ndërsa asnjë nga autorët aktualë të kësaj teme nuk është mysliman, ne nuk mund të bëjmë gjë tjetër veçse të sjellim ndërmend hadithin islamik (thënien e Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}) që deklaroi: “Marrësi i fajdesë, dhënësi i saj, shkruesi i dokumenteve të saj dhe dëshmitari janë njëlloj pjesëmarrës në krim.” Për ta vënë atë në gjuhën e feve të tjera Abrahamike, ne kemi adhuruar perëndinë e pasurisë në faltoren e Mammonit. Mammoni tani është shndërruar në Moloch, perëndia gur i zbratur i mbushur me zjarrin e Biblës Hebraike. Në prehrin e tij fëmijët me sa duket ishin sakrifikuar... dhe kjo, në emër të idhujtarisë duke kërkuar progresin ekonomik të së ardhmes.

Përmes lenteve të kësaj metafore “*kriza e kreditit*” duhet si “*kriza e ndryshimit të klimës*” të kuptohet shpirtërisht, ose në kuptimin e vlerave të qëndrueshme. Është lakmia jonë e konsumit që ka shkaktuar problemet që përballen tashti. Cilado qofshin bekgraundet tona fetare, nëse ka ndonjë, krizat e kohëve të tanishme mund të shihen si një thirrje për zgjim shpirtëror dhe të bazuar në vlera. Si i tillë, modernizmi mund të këtë diçka për të mësuar nga të lashtët.

Alastair McIntosh & Wayne Visser
Shtuar të dokumenti i kësaj teme online,
janar 2009

Përktheu: Çapajev Zera

Atributi i Zotit "Furnizues" (Er-Rrezak) dhe kriza globale ekonomike

I MBAJTUR NË XHAMINË E BEJTUL FUTUHUT TË LONDRËS ME 31 TETOR 2008



Mbas recitimit të suresë El-Fatiha, Hazreti Mirza Masroor Ahmad, Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar a.b.a., recitoi ajetet 38-41 të suresë Er-Rrum, pastaj tha:

Përkthimi i këtyre ajeteve është:

“A nuk e dinë ata se Allahu ia shton furnizimin dhe ia ngushton kujt të dojë? Me të vërtetë, këtu ka shenja për njerëzit që besojnë. Jepja të drejtën e tij të afërmit dhe të varfrit dhe udhëtarit! Kjo është më e mirë për ata që e duan pëlqimin e Allahut dhe pikërisht ata do të jenë fitimtarët. Dhe pasurinë që e jepni për të fituar kamatën me qëllim që ajo të shtohet me anë të pasurisë së njerëzve, ta dini se ajo nuk shtohet tek Allahu; ndërsa kur e jepni si zekat (për bamirësi) duke kërkuar pëlqimin e Allahut, vetëm ajo do t’ju shumëfishohet. Allahu është Ai që ju ka krijuar ju, mandej ju ka dhënë ushqim, mandej sjell vdekjen e pastaj do t’ju ringjallë. A ka ndonjë nga të ashtuquajtur zotat tuaja që bën diçka të tillë? I lavdëruar është Ai dhe është larg prej atyre gjërave që i shoqërojnë Atij.”¹

Në ajetet e para që recitova, Allahu i Madhëruar deklaroi se; Ai është Furnizuesi (Përmbushësi i nevojave) dhe se është Ai që ia shton, apo pakëson riskun dikujt. Allahu thotë se, Ai i tregon besimtarit shumë shenja të çuditshme nga atributi i tij Furnizues, me kusht që besimtari duhet të ketë besim të madh.

Në këtë kohë bota është e kapluar nga një krizë e llahtarshme ekonomike, nga e cila janë ndikuar edhe vendet e pasura dhe ato të varfra, edhe vendet industriale si dhe ato që bazohen në bujqësi. Madje janë ndikuar edhe ato vende, të cilat mendojnë se janë kaq të zhvilluar teknologjikisht, saqë e gjithë bota medoemos varet praj tyre. Sepse në kohën tonë moderne, ato vende kanë shumë vlerë në gjithë botën. Disa fuqi të mëdha botërore kishin patur mendimin se ekonomia jonë është bërë aq e fuqishme saqë ne do ta nënshtrojmë gjithë botën, megjithëse ato drejtojnë edhe shumë vende të tjera, por ëndërronin të sundonin gjithë botën. Ato mendojnë se: Ne jemi kaq të përparuar në shkencë, saqë askush nuk mund të na bëjë ballë, dhe jemi të pavarur për sa i takon fuqisë prodhuese të ushqimit; në fushën e mjekësisë kemi përparuar kaq shumë, saqë e gjithë bota do të mësojë nga ne; ne jemi më të fuqishëm edhe në armatime dhe vendet e tjera janë krejtësisht të varura nga përvoja jonë; ne mbizotërojmë në të gjithë botën, madje

¹ Er-Rrum, 30:38-41

planet tona po pushtojnë edhe qiellin dhe në çdo mënyrë ne po e sundojmë botën. Andaj të gjitha vendet e tjera duhet ta pranojnë mbizotërimin tonë dhe të na nënshtrohen.

Këto vende menduan se kanë një kontroll të gjithanshëm mbi ekonominë botërore, dhe vendet e tjera duhet të varen nga ato. Duke u mbështetur në këto mendime dhe duke përparuar në fushën shkencore, ato bënë planifikim të tillë që u kishin dhënë fund shumë prodhimeve vendase, gjithashtu edhe për bujqësinë interesimi ishte i vogël dhe e ushtronin atë shumë pak. Si rezultat, ekonomia e tyre erdhi në një pikë ku filloi të bjerë shpejt. Këto vende edhe tani nuk po e kuptojnë shkaku kryesor të kësaj krize, që është mosbesimi të një Zot që është Furnizues dhe i Plotfuqishëm. Këto fuqi të mëdha botërore, të cilat nga ana ekonomike janë të fuqishme, ose ishin të fuqishme, i kushtojnë shumë pak rëndësi faktit që vepron edhe një ligj tjetër që është ligji i Krijuesit të botës e të qiellit. Njerëzit nuk u bëjnë dot ballë fatkeqësive natyrore, tërmete, përmbytjeve të mëdha, uraganeve etj. Dhe tani kemi një krizë tjetër që u shkakton nga drejtimi i ekonomisë kundër ligjit të natyrës. Pra, fatkeqësitë natyrore ndodhin për arsye se njerëzit e kishin harruar Zotin e tyre, dhe nga ana tjetër, kur ata drejtuan ekonominë botërore kundër porosit të Zotit, prapë pësuan humbje. Edhe zgjidhjet që po mendojnë ata për ta kaluar këtë krizë, nuk janë aspak të qëndrueshme. Ata nuk arrijnë të problemin kryesor, megjithëse po mundohen shumë por zgjidhjet e deritanishme duket sikur do t'i ngatërrojnë më shumë.

Kur i shikojmë këto gjëra, besimi në Zotin e Madhëruar na rritet akoma më shumë. Në këtë kohë, përgjegjësia jonë është që ta alarmojmë botën se të gjitha këto fatkeqësi dhe humbje janë për shkak se

njerëzit janë larguar nga Zoti; për shkak të neglizhencës ndaj kryerjes së detyrave që kanë ndaj njerëzve dhe për shkak të zilisë e lakmisë për burimet dhe rezervat e të tjerëve. Pra, nëse ata dëshirojnë një zgjidhje të qëndrueshme, atëherë duhet t'i mendojnë edhe këto gjëra. Vetëm miratimi i ca qindra miliardë dollarëve nuk është një zgjidhje e qëndrueshme. Sepse nëse do të mendojmë, edhe këto para do të vijnë nga i njëjti xhep, i cili tashmë është në krizë. Edhe vendet myslimane, në vend që t'i ndjekin udhëzimet e Zotit që janë përmendur në Kuranin e Shenjtë, po ndjekin gjurmët e vendeve perëndimore, për sa i përket sistemit ekonomik të tyre.

Nuk ka një nivel të lartë të ndër-gjegjshmërisë dhe besnikërisë ndaj kombit. Liderët e kombeve të ndryshme më shumë shikojnë interesat e veta. Vendet arabe që janë të pasura me naftë, duke lënë pas dore besimin, dhe duke mos u kujdesur për të drejtat njerëzore, nuk e kanë drejtuar ekonominë e tyre siç i ka porositur Allahu. Sigurisht, ata kanë përparuar duke e zhvilluar infrastrukturën e tyre, por siç thashë, nuk i kanë përdorur rezervat e tyre ashtu siç duhej, siç urdhëron Allahu i Madhëruar. Për shembull, ata kishin pasuri jashtëzakonisht të madhe që fituan nga nafta, të cilën e kanë përdorur për biznes me vendet perëndimore të cilat ishin kamatëmarrës për ta. Pra, vendet arabe i kanë hedhur paratë e tyre në një biznes jo prodhues dhe që ishte fitimprurës i përkohshëm. Domethënë ata i hodhën paratë në bankat e tyre, ose në disa organe të tyre prej të cilave do të fitonin fajde.

Këto vende islamike sa për të thënë, kanë nisur një sistem bankar të ashtuquajtur islamik, i cili është më shumë i sheqerosur sepse, në fakt, nuk është sipas urdhrit të Zotit. Po ta shikoni me vëmendje, fitimi i

tyre nga ky sistem është një lloj fajdeje.

Sidoqoftë, unë po thosha se ata pasurinë e kanë përdorur duke shkelur mësimet e Islamit dhe ia dorëzuan atë vendeve perëndimore për asnjë qëllim prodhues. Dhe tani, kur ra kjo krizë ekonomike, edhe ata patjetër duhet të kenë pësuar humbje. Është e qartë se kur e gjithë bota është pushtuar nga kriza ekonomike, nuk mund të shpëtojnë as vendet arabe.

Allahu i Madhëruar kur deklaroi se Ai është Riskdhënësi, njëkohësisht Ai iu jep disa porosi besimtarëve. Në ajetet e *Suresë Er-Rrum*, që recitova në fillim, Allahu thotë: Jepuni të afërmeve dhe të varfërve edhe udhëtarëve atë që iu takon. Domethënë për të shfrytëzuar paratë personale në mënyrë të drejtë, duhet të shikoni edhe këto tri porosi. Në fund të ajetit Allahu gjithashtu përmendi dy gjëra si shpërblim: do të fitoni kënaqësinë e Allahut dhe do të korrni sukses edhe në këtë botë dhe në botën tjetër.

Pra, për t'u bërë besimtarë nuk është e mjaftueshme vetëm nëse thoni: vetëm kaq se: "ne jemi myslimanë dhe besojmë në Zotin që është Furnizuesi". Duhet ta provoni praktikisht deklarimin tuaj. Nëse Allahu është Furnizuesi, atëherë, besimtari i vërtetë asnjëherë nuk frikësohet nga pakësimi i prodhimit apo ushqimit të tij, sepse ai e di mirë që Vetë Allahu do t'ia mundësojë riskun atij, të cilin pastaj ai e harxhon sipas porosive të Tij. Ai besimtar që fiton risk të mirë, shoqëron edhe të tjerët në atë risk, ku hynë farefisët, të afërmit, fqinjët. Madje, nëse myslimanët janë vëllezër me njeri-tjetrin, atëherë i gjithë *umeti* hyn në të. Vendet e pasura islamike duhet të kujdesen për vendet e varfra islamike. Vetëm atëherë mund të thuhet se urdhrat e Zotit u zbatuan. Allahu tha: "*F'átidhal kurba hak-kahu vel miskina vebnas-sibili*" (d.m.th. "Jepja të drejtën e tij të afërmit dhe të varfrit dhe udhëtarit!")

Këtu foljen që përdor Ai, është "*áti*" (arabisht) që ka kuptimin "t'i japësh duke e respektuar tjetrin". Pra, është detyra jote që t'u japësh atyre. Kjo nuk është lëmoshë, as bakshish e as favor që i bën tjetrit. Përkundrazi, është detyra jote që t'i japësh të varfrit nga pasuria e shumë që ke.

Pra, vendet islamike, nga lakmia në vend që t'i derdhnin pasuritë e tyre të naftës, në bankat perëndimore për të fituar kamatën, duhej t'i ndihmonin vendet e tjera të varfra islamike. Dhe kështu, ata do ta fitonin pëlqimin e Allahut dhe gjithashtu do të arrinin sukses. Shpesh këto vende deklarojnë se ata janë në gjendje shumë të mirë, në fakt ata e kanë gabim. Së pari, pasuria e tyre që është në bankat perëndimore ose në organet që japin kredi, patjetër që do të ndikohet nga kriza globale. Shkurt do t'ju tregoj se, ka këtu edhe disa ahmadianë që marrin kredi nga këto banka. Të gjitha këto kredi merren për qëllime jo prodhuese. Sepse shumica i marrin për të blerë shtëpi, makina ose gjëra të tjera shtëpiake, të gjitha këto janë gjëra jo prodhuese. Kur vendet perëndimore, panë që po u vijnë para të bollshme në bankat e tyre, nga vendet arabe, atëherë ato liruan dorën për t'u dhënë kredi njerëzve. Bankat për shpenzime vetjake nuk përdorin shumë nga kapitali i tyre, ndërsa 95.9% i përdorin paratë e huaja. Dhe siç thashë që këto para që erdhën nga vendet që kanë naftë nuk i përdorin për qëllime prodhuese. Një punonjës i një banke më tregoi se, 45% nga investimet e tyre bankat i japin kredi për shtëpi. Pastaj edhe një përqindje e madhe e parave jepet si kredi për gjëra të tilla jo prodhuese. Dhe për gjëra prodhuese jepen shumë pak kredi. Shumica që janë të pranishëm, këtu e dinë se këto banka i kishin hequr edhe kushtet. Përpara duhej të paguhej një përqindje e caktuar, që në fillim, për të marrë një kredi, ndërsa tani,

edhe për një kredi prej 30 mijë paund, duhet të bësh një parapagim vetëm prej 10-15 mijë paundësh dhe ti mund ta marrësh kredinë (në disa raste s'duhet të bësh asnjë parapagim).

Kredimarrësi, në përgjithësi, nuk e vret mendjen se sa është përqindja e interesit? Çfarë sasi do të paguajë për të? Dhe për sa kohë do të vazhdojë ta shlyejë këtë borxh? Ai mendon vetëm që *hajde ta blejmë shtëpinë e pastaj të shikojmë, do ta shlyejmë pak nga pak*. Por ai nuk mendon se shlyerja e borxhit do të zgjasë për shumë kohë, dhe së dyti të ardhurat e tij janë të kufizuara. Pastaj vjen një kohë kur ai nuk e mban dot kredinë. Sepse në përgjithësi edhe çmimet po rriten për çdo gjë, dhe kështu rriten edhe shpenzimet e shtëpisë. Nëse ai do mendojë ta shlyejë borxhin, si do të përballlet me shpenzimet e shtëpisë? Kështu që huamarrësi, në këtë mënyrë, ngelet me barrën e huas dhe borxhi i tij vazhdimisht i shtohet. Këtu, dhe në vende të tjera, disa marrin shtëpi me hipotekim (*mortgage*), gjë që ua rëndon atyre akoma më shumë borxhin. Ata i kanë marrë paratë nga bankat, sa për të thënë, por në të vërtetë janë të futur në borxh. Pastaj, në disa raste ndodh edhe kështu, që do të marrësh një shtëpi, për të cilën edhe qiranë dhe fajdenë gjithë jetën duhet t'ia paguash bankës. Dhe në fund të jetës s'të mbetet asnjë gjë, pasi ajo i kthehet prapë bankës. Disa banka të nxisin që t'u marrësh hua në atë mënyrë, që nuk duhet të paguash asgjë nga xhepi yt. Vetëm me një marrëveshje do ta blesh shtëpinë. Pastaj gjatë gjithë jetës, do t'u paguash qiranë dhe kamatën bankave. Në fund, do të ngelesh pa asnjë grosh në xhep.

Herën e kaluar, kur kisha mbajtur fjalimin e së premtes rreth kamatës, shumë ahmadianë hoqën dorë nga ajo. Pra, nëse shikoni realitetin, borxhi i marrë me kamatë gjithmonë shtohet

në këtë mënyrë. Shumëkush mund të ketë këtë fat që, mbas një kohe nuk do të ketë mundësi ta shlyejë huan e tij e të konsiderohet si *shpërdorues* ("in default").

Bankat që u japin kredi njerëzve, siç ju thashë, iu japin paratë e të tjerëve, ku përfshihen pasuri të shumta të vendeve që kanë naftë. Dhe duke gjetur kaq shumë pasuri, ato banka u lëshuan lirshëm në dhënien e kredive.

Kjo gjendje nuk është vetëm këtu. Edhe në Amerikë dhe në vende të tjera të botës, ndodh e njëjta gjë. Në këto rrethana vepron edhe ligji i Zotit pastaj. Këto banka, pasi dhanë një sasi shumë të madhe parash si kredi, tani e kuptuan që këto para nuk janë të tyre, por të të tjerëve. Atëherë, ata e ulën sasinë e dhënies së kredive për më tutje. Dhe tani, jo vetëm që nuk iu japin kredi njerëzve për gjërat jo prodhuese, por edhe për gjërat prodhuese. Si rezultat, gjithë ekonomia u ndikua dhe të gjitha vendet pësuan humbje, pasi ekonomia e tyre është e ndërlidhur me njeri-tjetrin. Prandaj, nëse ndonjë vend deklaroi se ekonomia e tij është në rregull, e ka gabim. Tani, s'ka shpresë që të kthehen shpejt ato pasuri që janë në botën perëndimore. Dhe së dyti, për atë gjë që i mbështeten, d.m.th. vendet e naftës, edhe ajo është pakësuar tashmë.

Revista "Times" e kësaj jave, ka dhënë disa shifra rreth krizës ekonomike. Ajo shkruan se: është një det borxhesh, në të cilin edhe anija e Amerikës, që pretendon se është ekonomia më e madhe e gjithë botës, ka filluar të mbushet me ujë dhe po lëkundet, gati të fundoset. Revista thotë se sado që të mundohen ekonomistët e Amerikës, nuk mund të dalin lehtë nga kjo krizë. Asnjë vend nuk mund të thotë se, ne nuk u lëkundëm nga kjo krizë e ekonomisë. Në revistë është folur për vendet perëndimore dhe sidomos për Amerikën, sepse atje njerëzit përdorin

shumë kartën e kreditit, dhe e përdorin pa e vrarë mendjen. Tani në shumë vende e kanë ndaluar përdorimin e saj. Kështu që luksin që e gëzonin njerëzit e këtyre vendeve, e kanë pakësuar disi. Thonë se shitja e makinave ka rënë në nivelin më të ulët gjatë këtyre 15 viteve të kaluara. Shumë kompani fluturimesh kanë mbyllur avionët e tyre, pasi njerëzit nuk udhëtojnë aq shumë si përpara. Këto dy gjëra janë kryesore në të cilat përdoret nafta. Tani, nëse nuk do të përdoret nafta si përpara, nga do t'iu vijë paratë. Kur njerëzit nuk kanë shumë nevojë për një gjë, bie edhe kërkesa e saj dhe rrjedhimisht ndikohet edhe ekonomia.

Janë edhe efektet në argëtimet e njerëzve, frekuentimet e tyre nëpër restorante luksoze që ishin të shpeshta në këto vende, e sidomos gjatë dimrit, janë bërë të rëndomta, gjë që do të shtojë më shumë mërzi ose depresion dhe pastaj janë edhe pasojat e tjera që do të vijnë.

Allahu i Madhërishëm thotë për ata që mbështesin sistemin e kamatës ose ua japin atë të tjerëve, shejtani i çmend në mënyrë që ata nuk marrin vesh asgjë. Ai thotë:

“Ata që hanë kamatë, nuk qëndrojnë veçse sikur ai i çmenduri nga të prekurit e shejtanit. Sepse ata thonë se tregtia është njëlloj si kamataria. Mirëpo Allahu tregtinë e ka lejuar kurse kamatarinë e ka ndaluar. Pra, ai të cilit i vjen këshilla nga Zoti i tij dhe i shmanget kamatës, le ta mbajë atë që tashmë ka fituar dhe çështja e tij është në dorën e Allahut. Ndërsa ata që i kthehen kamatës sërish, do të jenë banorë të Zjarrit ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”²

Pra, pasojat e tjera patjetër do të shfaqen. Por ata tashmë janë të frikësuar, se i kanë humbur paratë e tyre, ose të paktën e dinë se për një kohë nuk mund t'i gjejnë ato. Pavarësisht nga ngushëllimi nga vendet e ndryshme, kjo frikë është e

tmerrshme për ta.

Pastaj ata që kishin planifikuar që të bënin rihipotekimin (*rimortgage*) e pasurive të tyre dhe do t'i shlyenin borxhet që kishin, edhe ata janë në gjendje të frikësuar. Kjo për arsye se njerëzit nuk mund të marrin më kredi, ata nuk kanë para në dorë, gjë që shkaktoi ulje të mëdha të çmimeve në shitjen e shtëpive. Prandaj në këtë krizë ekonomike, siç tha Zoti i Madhërishëm, të gjithë ata që ishin të zënë me këtë punë kamate, janë të shtangur prej prekjes së shejtanit. Zoti i mëshiroftë! Dhe siç ju thashë se kjo gjendje do t'u shkaktojë depresion, dhe do të vini re një mërzi të madhe në shoqërinë e tyre. Nga fjala depresion m'u kujtua një batutë po e tyre. Në gjuhën angleze thuhet se ekonomistët thonë:

“If my neighbour loses his job, it is recession. If I lose my job, it is depression.”

D.m.th. Nëse fqinji im humbet nga puna e tij, atëherë ky është “*recesion*” (d.m.th. rënie) dhe nëse unë shkarkohem nga puna ime, ai është “*depression*”. “*Recesion*” dhe “*depression*” janë terma që përdoren në fushën e ekonomisë. Kuptimi i thjeshtë i tyre është: “*recesion*” i thonë humbjes së përkohshme ekonomike. Ndërsa për humbjen e përhershme ekonomike përdorin termin “*depression*”. Kjo krizë që pushtoi botën, ka larguar mijëra njerëz nga puna, gjë që do të shkaktojë edhe depresion, d.m.th. edhe depresion nga ana shëndetësore.

Prandaj, nëse njerëzit janë të mençur, ata duhet ta braktisin tashmë sistemin e kamatës. Bëni ato tregti që janë të lejuara nga Zoti. Gjithashtu edhe vendet myslimane që janë në gjendje të mirë, duhet të tregojnë shembullin e tyre duke i ndjekur urdhrat e Zotit për ndalimin e kamatës. Përndryshe mbas këtij ndëshkimi pason edhe ndëshkimi i Ahiretit.

² El-Bekare, 2:276

Ato vende që kanë burime të duhura për të përparuar, por prapë nuk janë besnike dhe po shpërdorin mjetet e tyre, duhet të kenë kujdes. I tillë është Pakistani ose vende të tjera si ky, liderët e të cilave kurrë nuk u treguan besnikë ndaj kombit të tyre. Ata gjithmonë vodhën shtetin dhe e drejtuan duke marrë hua të mëdha. Vetëm para pak ditësh, me shumë gëzim u deklarua në Pakistan se u miratua prapë një borxh prej ca qindra milionë dollarësh. Si do ta shlyejnë këtë? Nuk dihet. Madje bëheshin diskutime të mëdha, sesi do ta shlyenin borxhin e mëparshëm. Dhe pretendonin se u janë shtuar rezervat e këmbimit vulator (the *Reserves of Foreign Exchange*). Tani kur u zbardh kjo çështje, e kuptuan se nuk ka asgjë në pjtën e tyre. Kurse, me bekimin e Zotit, Pakistani është i pasur me burime natyrore, toka është shumë pjellore për bujqësi, klima e tij është shumë e përshtatshme dhe ka shumë terren. Por e kanë zakon për të lypur dhe për të shpërdorur burimet e tyre, dhe kështu u zhdukët edhe turpi ndaj kombit. E njëjta gjë po ndodh edhe në disa vende afrikane, si në Nigeri, e cila është shumë e pasur me rezervat e naftës por liderët e saj nuk e vrasin mendjen fare për kombin. Sidoqoftë, të gjitha këto ndodhin sepse ata kanë harruar Zotin dhe nuk e ndjekin mësimin e Tij për sa i përket ndalimit të kamatës, madje ata kanë një babëzi të madhe për para.

Zoti u thotë atyre që marrin kamatë: *"Ju mendoj se me anë të kamatës ju shtohet pasuria juaj, ndërsa tek Allahu ajo nuk shtohet."* Nëse pasuria nuk shtohet në sytë e Zotit, atëherë nuk do të ketë asnjë mbarësi në të.

Vendet islamike që derdhin pasuritë e tyre në bankat kamatëmarrës, meritojnë më shumë ndëshkim për shkak të këtij mësimi që gjendet në Kuranin e Shenjtë në mënyrë qaq të theksuar. Prandaj, nëse

ata mendojnë se janë të sigurt, atëherë e kanë gabim. Gjendja e sotme po tregon qartazi se edhe vendet jomyslimane kanë rënë në këtë kurth dhe do të bien herë pas here.

Ajeti 40, ndër ajetet që recitova, na kujton për zekatin që është e drejta e të varfërve. Kurse në ajetet e mëparshme janë përmendur edhe tri gjëra të tjera për bamirësi. Duhet të shikojmë edhe të drejtat e të varfërve, të drejtat e kombit dhe gjithashtu të drejtat e shërbimit të Islamit. Ndërsa me sistemin e kamatës, sipas paralajmërimit të Zotit, i pasuri deri një farë kohe vazhdon të bëhet më i pasur. Por kur i vjen ndëshkimi i Zotit shfaqen të njëjtat rezultate që po dalin në këtë kohë.

Allahu i Madhëruar na këshillon që të kujdesemi për çdo shtresë të shoqërisë, dhe thotë se kjo është ajo që do t'ju shtojë pasurinë tuaj, e jo kamata. Vendet myslimane, në veçanti, duhet ta kuptojnë këtë këshillë. Dikur edhe vendet perëndimore e kishin kuptuar dhe e kishin realizuar këtë, siç kishte propozuar Gjermania, para ca dekadash, që ta zhdukte fajdenë, por për fat të keq nuk arriti ta realizonte. Edhe në ditët e fundit në lajme dëgjuam, se me uljen e përqindjes së interesit ekonomia është përmirësuar nga pak. Por rrugëzgjidhja është vetëm ajo që, atë që kanë marrë si interes ju falet, Zoti do t'ua falë atyre. Por që nga sot e më tutje, duke u penduar duhet të heqin dorë nga interesi. Nëse do të veprojnë kështu, në radhë të parë myslimanët të cilët janë udhëzuar në veçanti, vetëm atëherë mund të shpëtojnë nga kjo krizë e herëpashershme, që i sjell pasoja të rënda ekonomike çdo kombi të botës.

Në ajetet që recitova, pasi tregon të gjitha këto gjëra, Allahu i Lartësuar thotë:

Allahu është Ai që ju ka krijuar ju, mandej

ju ka dhënë ushqim, mandej ju sjell vdekjen e pastaj do t'ju ringjallë. A ka ndonjë nga të ashtuquajturit zotat tuaj që bën diçka të tillë? I lavdëruar është Ai dhe është larg prej atyre gjërave që i shoqërojnë Atij.

Pra, Zoti jua kujton se Ai ju ka krijuar dhe pastaj nuk ju ka braktisur. Madje ju ka ushqyer dhe gjithmonë ju furnizon me ushqim. Në një vend tjetër Ai thotë se Ai i jep ushqimin çdo krijese të Tij, edhe kafshëve, edhe shpendëve. Dhe nëse do t'i bindeni, do t'jua japë edhe juve. Ju gjithmonë duhet të keni parasysh udhëzimet e Tij. Sepse është po Ai që do t'ju japë vdekje, pastaj do t'ju ringjallë dhe pastaj do t'ju bëjë ju të paraqiteni para Tij ku do t'i përgjigjeni. Andaj mos bëni *shirk* (d.m.th. mos shoqëroni askënd me Allahun), as *shirk* të fshehtë, dhe në asnjë mënyrë mos mendoni të mohoni urdhrat e Tij. Udhëzimet rreth ndalimit të fajdesë dhe alarmimet për pasojat e saj janë kaq të frikshme saqë myslimanët, dhe sidomos ne ahmadianët, medoemos duhet të ruhem nga ajo.

Në suren El-Bekare Allahu thotë:

“O ju besimtarë, frikësohuni nga Allahu dhe hiqni dorë nga ajo që është mbetur nga kamata, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”³

Në një ajet tjetër rreth ndalimit të kamatës Allahu thotë:

“Nëse nuk e bëni këtë ju është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse pendoheni, atëherë ju takon kapitali fillestar, në këtë mënyrë nuk do të bëni mizori e as nuk do t'ju bëhet mizori.”⁴

Kështu që besimtarëve u është bërë kërcënim i rëndë. Ndërsa sistemi ekonomik i mbështetur në fajde nuk po u sjell shkatërrime vetëm myslimanëve, por edhe atyre që nuk janë myslimanë.

Allahu thotë se, me prekjen e shejtanit ata do të çmenden pas kamatës, rrjedhimisht tani janë zhytur në të. Nuk merret vesh fare se si të shpëtojnë? Shqisa e tyre për të dalluar të keqen e të mirën u është zhdukur. Dhe kjo në fakt, siç thotë Zoti, është shpallja e luftës kundrejt Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Kështu që nuk do t'u mbetet as bota dhe as shpërblimi i *Ahiretit*.

Çdo shtet nëse do të mendojë mirë, sidomos shtetet islamike, do të kuptojnë se nga kamata po zmadhohet humnera midis të pasurit dhe të varfrit. Vende të varfra myslimane po varfërohen akoma më shumë. Ato të pasura që kanë naftë, mendojnë se kanë pasuri të bollshme. Kështu do të fillojë rebelimi midis vendeve islamike, dhe atyre jo islamike. Siç ju tregova rastin e Pakistanit, kur të pasurit tregohen të babëzitur për para, nuk mund të kujdesen për shtresën e ulët. Kjo është një nga arsyet që hoxhallarët po gjejnë mundësi për të luajtur lojën e tyre, duke përdorur fëmijë të varfër si kamikazë. Megjithëse janë edhe arsye të tjera të terrorizmit në këto vende, por edhe kjo është një nga kryesoret.

Luftërat që po bëhen sot nuk kanë qëllim për të zgjeruar kufijtë gjeografikë por për t'i zaptuar burimet apo rezervat natyrore. Nëse ndonjë shtet u bindet kushteve të tyre, atëherë vendoset edhe paqja dhe sipas interesit të tyre, zgjidhet edhe ndonjë president apo formohet i gjithë këshilli qeveritar. Përndryshe ata luftën e zgjasin shumë. Sepse paratë u vijnë nga mbrapa për t'i mbështetur. Por ndërkohë vepron fati i Zotit. Siç e dëshmuam ne të gjithë, të gjitha ato vende të pasura pësuan një goditje të rëndë, në mënyrë që edhe ekonomi të fuqishme filluan të binin njëra pas tjetrës. As ato organe që jepnin kredi nuk iu bënë dot ballë. Madje nga thesare shtetërore, pra nga paratë e popullit ato

³ El-Bekare, 2:279

⁴ El-Bekare, 2:280



Hazret Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar a.b.a. duke mbajtur fjalimin e së Xhumasë në xhaminë "Betul Futuh" të Londrës

organe u mbështetën. Dhe s'ka asnjë garanci se kur do të përmirësohen.

Thonë se as për Amerikën nuk ka shpresë që ajo të rimëkëmbet shpejt. Siç e përmenda në fillim se ata shikojnë me lakmi burimet e të tjerëve. Edhe ky është një shkak shumë i madh i krizës botërore. Allahu thotë në Kuranin e Shenjtë:

*"Dhe mos e shih me sy lakmitarë atë që Ne ua kemi dhënë disave mjete të përkohshme"*⁵

Në një hadith Hazret Omeri rrëfen se (Pejgamberi s.a.v.s.) thotë:

"Mos vrapo pas asaj pasurie që nuk është e jotja."

Ky është një mësim për të gjithë, ndërsa për myslimanët në veçanti. Besimtari duhet të ketë parasysh *Ahiretin*. Sot ne po shikojmë se edhe këto vende që kanë mjete të përkohshme, po shkojnë drejt shkatërrimit. Dhe të njëjtin

përfundim do të pësojnë edhe ata që i shikojnë me lakmi. Pra, sot ka nevojë që bota ta kuptojë atë, se çdokush duhet të mbijetojë me mjete të veta që ka, qoftë në jetën shtëpiake, qoftë në jetën shoqërore apo kombëtare, qoftë edhe në skenën ndërkombëtare. Duke u ruajtur nga fajdeja, nëse në jetën shtëpiake do të jetoni brenda mundësive, atëherë nuk do të keni as nevoja të tepërta, nuk do t'ju nevojitet as kredi. Duke parë (për shembull) divane të bukura të fqinjit, nuk do t'ju lindë dëshira që t'i keni edhe ju në shtëpinë tuaj. Nuk do të thoni duke parë makinën apo shtëpinë e bukur të mikut: "Ah, sikur të kisha edhe unë një shtëpi të tillë!" Sigurisht duhet të keni shtëpi, por jo me paratë e fajdesë.

Kështu është edhe gjendja e vendeve të ndryshme. Në vend të zaptojnë burimet e të tjerëve, duhet të bëjnë tregti të pastër me mjete të njeri-tjetrit. Sipas udhëzimeve të Zotit, edhe një shtet i vogël e i varfër, duhet të jetë i bindur

⁵ El-Hixhr, 15:89

për sigurinë e tij dhe për burimet e veta, që ato patjetër do të përdoren për zhvillimin e tij. Nëse vendet e varfra ndihmohen nga fondet ndërkombëtare, ata duhet të kenë besim të plotë se këto janë vetëm për përmirësimin tonë, e jo për të na zaptuar mjetet tona. Pastaj nëse edhe liderët do të përdorin me besnikëri pasurinë e shtetit, atëherë do të zhduken të gjitha korrupsionet. Duke zbatuar urdhrat e Zotit, nëse ia kthejnë të drejtën atij që i përket, atëherë do të shpëtojnë nga të prekurit e shejtanit. Do të trashëgohen edhe bekimet e tjera të Zotit nëse do heqin dorë nga sistemi i kamatës. Nëse bota nuk do ta kuptojë këtë atëherë gjithmonë do të ketë një gjendje lufte.

Zgjidhja e krizës së sotme gjendet vetëm te besimtarët. Allahu thotë në Kuranin e Shenjtë:

*O besimtarë! Mos hani kamatë të shumëfishtë mbi kamatë! Kijeni frikë Allahun, që të triumfoni.*⁶

Të paktën bota myslimane ta përvetësojë këtë frikë të Allahut, e sidomos vendet e pasura të myslimanëve, të cilat i kanë derdhur paratë e tyre nëpër bankat kamatëmarrëse. Por për këtë, ata gjithashtu duhet ta dëgjojnë edhe zërin e Zotit, i cili na ka ardhur nëpërmjet Mesihut të Premtuar. Përndryshe s'ka rrugë shpëtimi dhe s'ka siguri në këtë kohë.

Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

“Sot njerëzve u duhet uji shpirtëror. Toka është e vdekur krejtësisht. Kjo

kohë është ajo që është përmendur në ajetin “Korrupsioni është shpërndarë edhe në dhë edhe në det.” (Er-Rum, 30:42) Toka dhe detet janë të katandisur keq. Me dheun duhen kuptuar popujt idhujtarë ndërsa me detin popujt e Librit. Ose mund të kuptohen edhe dijetarët dhe të paditurit. Shkurt, në çdo shtresë të njerëzimit ka korrupsion. Mund ta shikoni nga çdo lloj këndvështrimi apo nga çdo anë, bota ka ndryshuar. Të qenët shpirtëror nuk ka mbetur e as nuk shihen shenjat e tij. Çdokush është dobësuar në moral dhe në veprat e tij. Adhurimi i vërtetë i Zotit dhe njohja e Tij nuk shihet më në botë. Prandaj, sot është shumë e nevojshme që uji shpirtëror dhe drita e profetizmit të zbresin dhe t'i ndriçojnë zemrat e pastra. Falënderojeni Zotin e Lartësuar që Ai në këtë kohë jua ka zbritur atë dritë. Por pak janë ata që përfitojnë nga kjo dritë.”⁷

Allahu e bëftë botën që të hyjë nën hijen e kësaj drite që njerëzit të shpëtojnë nga krizat e kësaj bote. Sot, kjo është e vjetmja rrugë për njohjen e Zotit dhe për të arritur deri tek Ai, ajo do t'i bëjë robërit e vërtetë të Zotit dhe ndjekësit e vërtetë të Hazret Muhammedit s.a.v.s. Allahu i mundësoftë botës që ta kuptojë këtë këshillë të rëndësishme. (Amin)

Përktheu: Samad Ghori

⁶ Ali-Imran, 3:131

⁷ Komentimi i Kuranit prej Hazret Mesihut të Premtuar a.s., vol. 3, f. 52.

Filozofitë Ekonomike të Kapitalizmit, Komunizmit dhe të Islamit

Rendi ekonomik Islamik nuk i përket as kapitalizmit as socializmit shkencor. Filozofia ekonomike e Islamit është shkencore pa qenë mekanike; është e disiplinuar pa qenë kufizuese. Ajo lejon pronësi private dhe ndërmarrje private por nuk nxit lakminë dhe grumbullimin e pasurisë në pak duar, përmes së cilës një pjesë e madhe e shoqërisë kthehet në të varfër, bujkrobër dhe skllevër të një sistemi mizor dhe të pamëshirshëm të shfrytëzimit.

Ka tri ndryshime themelore në filozofitë ekonomike të kapitalizmit, komunizmit dhe Islamit.

Kapitalizmi

Në kapitalizëm, kapitali shpërblehet me interesin. Është e pranuar para së gjithash, në parim, që kapitali ka të drejtë të shtohet. Interesi luan forcën motivuese kryesore për grumbullimin e kapitalit, i cili pastaj kanalizohet si forcë të pajisë dhe të mbajë linjën e montimit¹

¹ Linjë montimi (assembly line) = [term ekonomik] një grup makinash dhe punëtorësh që grumbullojnë në mënyrë progresive një produkt. (shën.përkth)

të prodhimit në lëvizje. Shkurt, interesi vepron si një stimul për mbajtjen e kapitalit në qarkullim.

Socializmi shkencor

Në socializmin shkencor, ndonëse nuk ka stimul të interesit për të cikluar dhe ricikluar kapitalin në një mekanizëm produktiv, shteti monopolizon kapitalin. Kështu që nuk ka nevojë për motivim.

Në ndërmarrjen e lirë private, nëse dikush paguan, apo nuk ka të paguajë interesin, vetëm ndenja e të qenit pronar e kujtudo, është e mjaftueshme për të krijuar një nxitje, që kapitali i kujtudo duhet të rritet në normën më të shpejtë të mundshme. Nëse dikush do të paguajë interesin mbi para të huazuara, norma e interesit vepron si një faktor. Ajo funksionon si një dritare përmes së cilës kushdo mund të monitorojë rritjen apo zvogëlimin krahasues të kapitalit. Në sistemin ekonomik socialist, megjithatë, nuk gjendet as kjo nxitje, sepse ata që përdorin kapitalin, nuk e zotërojnë atë, dhe as nuk ka këtu ndonjë mjet të krahasimit, përmes të cilit dikush mund të gjykojë, nëse norma e rritjes është

ekonomikisht e mjaftueshme apo jo.

Në rendin socialist shkencor, zotërimi i fuqishëm i gjithë kapitalit shtetëror nga shteti vetë e bën sistemin e interesit plotësisht të pavend dhe të pakuptimtë. Defekti është se, kur ju nuk jeni nën ndonjë presion për të fituar më shumë se interesi që ju mund të paguani, ju humbni të gjithë stimujt dhe çdo ndjenjë përgjegjësie.

Nëse tërë kapitali në qarkullim në një shtet komunist, për shembull, mund të jetë i vlefshëm nga pikëpamja se sa interes mund të fitojë duke qenë i depozituar në një bankë, kjo do të na njëhte me njërin anë të tablosë. Ana tjetër e tablosë mund të konceptohet me vlerësimin e ekonomisë mbi një bazë humbje dhe fitimi. Natyrisht, kjo do të paraqiste shumë ndërlikime si vlerësimi i pagave etj. Por nëse ekspertët financiarë vënë mendjet e tyre në punë për këtë, të tilla pengesa mund të kapërcehen. Një krahasim i këtyre të dyjave do të paraqiste mundësi shumë interesante.

Është më shumë se e mundshme që fajtorët e vërtetë për rënien e standardëve të jetesës mund të lokalizohen saktësisht në këtë mënyrë. Madje edhe pa një detyrë kaq madhore, nuk është aspak e vështirë për këdo për të përcaktuar shkaqet e një rënie të tillë. Unë besoj se nga që shteti bëhet kapitalisti, është i privuar nga një sistem monitorimi për ta paralajmëruar atë për dështimet, humbjet dhe gabimet, në lidhje me mënyrën që ai trajton kapitalin shtetëror, sepse ai nuk ka detyrime financiare për të përmbushur dhe mund të përdorë kapital pa përgjegjësi. Një situatë e tillë është plot me rreziqe të pandara. Mungesa e interesit personal dhe një sistemi paralajmërimi mbi fitimin apo humbjen, i rrjedhur nga përdorimi i

kapitalit, shkakton rrënim në raportin sasi materiali hyrje-sasi prodhimi dalje. Sasia e humbjes vazhdon të rritet.

Sërish, nuk ka kontroll të vendosur në politikën e kanalizimit të kapitalit. Për shembull, nuk ka pasqyrë për qeveritë socialiste, për të gjykuar normën e vërtetë të rritjes ekonomike në krahasim me ekonomitë e tregut të lirë të botës së jashtme. Një problem tjetër është se shtetet komuniste kërkojnë shpenzime shumë më të mëdha për mbrojtjen, vëzhgimin dhe degët e zbatimit të ligjit brenda vendit. Gjërat e tjera edhe nëse do të jenë të barabarta, kjo kërkon një nivel të shpërpjesëtuar të shpenzimeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e ligjit dhe rendit. Këta dhe faktorë të tjerë të ngjashëm përbëjnë një taksë të rëndë mbi ekonominë. Natyrisht, rrënimi përfundimtar i ekonomisë mund të shtyhet, por nuk mund të shmanget krejtësisht.

Koncepti Islamik

Ndërsa komunizmi nuk siguron nxitje për përfshirje të përkushtuar e të drejtpërdrejtë të prodhimit të mirave materiale, përveç mungesës së fajdesë (interesit të kredisë), Islami e siguron këtë nxitje. Islami shmang sistemin e fajdesë pa pasur problemet specifike të botës komuniste. Në mungesë të kapitalit të hequr të fajdesë, Islami kontrollon kapitalin e vdekur nëpërmjet kanaleve jo produktive. Ky kontroll është një formë takse e njohur si *zekat*, e cila është vënë jo mbi të ardhurat apo fitimin por mbi vetë kapitalin.

Kontrasti është shumë i qartë. Në shoqëritë kapitaliste, kapitali është grumbulluar në duart e pak vetave nga lakmia për të shtuar kapitalin nëpërmjet grumbullimit të interesit dhe riciklimit

të tij në ekonomi me vendosjen e taksës që jep një fitim më të madh sesa norma e interesit. Në mungesë të kësaj, ekonomia është e detyruar të kalojë në reëension. Në Islam, nga frika se çdo kapital i vdekur do të gërryhet vazhdimisht përmes vënies së detyrimit të zekatit, kushdo me kursime të tepruara duhet ta përdorë këtë në fitimin e siguruar për të larguar efektin e zekatit.

Sipas Islamit, zgjidhja e problemeve ekonomike të botës nuk gjendet as në socializmin shkencor dhe as në kapitalizëm. Është e pamundur të shtjelloj më tej këtë subjekt këtu, por ne duhet të kemi një pamje aktuale të mosbalancimit ekonomik të krijuar nga kapitalizmi për të nxjerrë disa mësimë për të ardhmen.

(Marrë nga "Islam's Response to Contemporary Issues" ("Përgjigjja e Islamit ndaj çështjeve bashkëkohore"), Hazret Mirza Tahir Ahmad f.165-168, Angli, 2007)

KRIZA EKONOMIKE E PARASHIKUAR NË VITIN 1990

MIRZA TAHIR AHMADI, Kalifi i Katërt i Xhematit Mysliman Ahmadia

Hadret Mirza Tahir Ahmadi, Kalifi i Katërt i Xhematit Mysliman Ahmadia thotë:

Ndryshimi i rendit ekonomik

Shfrytëzimi i qytetarëve më të varfër nga kapitalizmi i bazuar në interesin, që pjell rebelimin socialist, duket të jetë i larguar në histori. Por një studim më i thellë do të zbulojë se kjo është vetëm një ndryshim maske.

Tashmë bota si një e tërë është ndarë në ata që kanë dhe ata që nuk kanë, kryesisht në sajë të shfrytëzimit nga vendet e zhvilluara kapitaliste. Shtoji kësaj situate kthimin shumë të rëndësishëm në kapitalizëm nga blloku i penduar Lindor. Kushdo dridhet të përfytyrojë sa gjak akoma do të thithet nga kombet tashmë të dobësuar dhe anemike të Botës së Tretë. Por do të duket se vampirët e kapitalizmit do të thithin më tepër gjak.

Është e qartë se epoka e kundërvënies midis dy filozofive kryesore të kundërta ekonomike të kapitalizmit dhe socializmit shkencor ka mbaruar. Sistemet ekonomike bazuar në marksizëm-leninizëm janë tërhequr nga skena e çështjeve humane. Nga ana tjetër, e ashtuquajtura ekonomi e lirë e Perëndimit duket të jetë e ngazëllyer mbi fitoren e saj të dukshme. Veç Kinës, vendet e bllokut Lindor janë ende duke

luftuar për të zbutur mjerimet e turmave të të varfërve në vendet e tyre përkatëse, menjëherë mbas lirisë së tyre të kohëve të fundit.

Hendeku ekonomik midis Perëndimit dhe Lindjes nuk është po aq i madh sa ai midis Veriut dhe Jugut. Vendet e Botës së Parë të Veriut janë ndarë në një rrafsh tjetër nga vendet e Botës së Tretë të Afrikës dhe Amerikës së Jugut. Ndonëse në kuptimin e pabarazisë ekonomike, hendeku midis Amerikës së Veriut dhe asaj të Jugut është pa dyshim lëndues, ai nuk është askund afër hendekut midis Evropës dhe Afrikës. Afrika, kaq pranë me Evropën është, në kuptimin e pabarazisë ekonomike, më e largëta prej saj.

Ndjenja e sigurisë që gëzohej dikur nga vendet më të dobëta të botës, për arsye të rivaliteteve midis superfuqive dhe çdo mundësi përfitimi e vendeve më të varfra, nga shkrirja e luftës së ftohtë shpejt do të zhduket. Do të ketë konkurrencë më të madhe dhe më të ashpër midis Shteteve të Bashkuara, Rusisë dhe pjesës tjetër të Evropës për të fituar, monopolizuar dhe për të siguruar tregjet e vendeve të Botës së Tretë.

Japonia, nuk do të jetë më kundërshtari i vetëm serioz për Amerikën. Një Evropë e re, e dalë nga rritja e shpejtë e Komunitetit Evropian dhe perspektiva e pjesëmarrjes së Evropës Lindore në

një treg më të madh të përbashkët, do të vendosë një konkurrencë edhe më shumë të frikshme për Amerikën sesa shtetet rivale të Evropës.

Miliona njerëz banorë të Evropës Lindore dhe Rusisë po presin dhe janë në nevojë të skajshme të ngritjes së standardit të tyre të jetesës. Vetëm rehabilitimi i një tregu të mbyllur, nuk do të jetë i mjaftueshëm të plotësojë këtë qëllim të vështirë, që ka të ngjarë të bëhet më i vështirë me kalimin e kohës. Nevoja e ngutshme e tregjeve të jashtme për të mbështetur standardet në rritje të jetesës në Evropën Lindore dhe Rusi, mund të plotësohet nga Komuniteti Evropian, Amerika dhe Japonia. Kjo ofron pak shpresë për vendet e Botës së Tretë - një tablo vërtet e ftohtë për Botën e Tretë - shumë më tepër e tillë për popullin më me pak fat të Afrikës.

Politikanët e vendeve, ekonomikisht dhe politikisht të përparuara të botës, janë më tepër të shqetësuar nga revolucion i ekonomik kapitalist që po zhvillohet në Lindjen e Largët - Japoni, Korenë e Jugut, Formosa (Tajvan), Hong Kong dhe Singapor. Duket se distanca midis Lindjes së Largët dhe Perëndimit po lidhet me urë ngritur mbi shumë vende Aziatike me më pak fat si: Indonezia, Malajzia, Kamboxhia, Tajlanda, Burma, Bangladeshi, India, Sri Lanka dhe Pakistani.

Gjithashtu është e mundur që të plotësohet sfida në rritje nga ekonomia gjigante e Japonisë dhe të vendoset një kontroll mbi ekonominë e saj e zgjeruar me shpejtësi, vende të tjera të Lindjes së Largët nuk do të jenë më përfituese të njohurive-teknike dhe kapitalit Amerikan. Nga ana tjetër, është e mundur gjithashtu që Amerika mund të anojë edhe më shumë nga aleatët e saj të

Lindjes së Largët për të plotësuar sfida të reja të kombinuara nga Japonia dhe një Evropë e bashkuar ekonomikisht shumë më e madhe. Kjo ndjell të keqe për të ardhmen e njerëzimit dhe mund të prishë në fund të fundit perspektivat për paqe në një rrafsh krejt të ndryshëm, sesa rivalitetet ideologjike midis kapitalizmit dhe komunizmit.

Është shumë herët të parashikohet se si ndryshimet në Evropën Lindore dhe Rusi mund të ndikojnë në balancën ekonomike të botës, dhe nëse kthimi i tyre në kapitalizëm mund të jetë i plotë apo i pjesshëm, apo i ngadalte apo i shpejtë. Çfarëdo që të ndodhë, një gjë është e sigurt, se këto ndryshime do të ndikojnë më tej në mënyrë të pafavorshme në ekonominë e Botës së Tretë. Një gjendje e tillë e gjërave nuk mund të zgjasë pafundësisht. Tashmë, bota është drejtuar drejt një katastrofe globale.

Islami ka fjalën e tij për të thënë si një këshillë për vendet kapitaliste të ngazëlyera, tani të mbështetura mbi një themel të zbrazët të interesit dhe fajdesë. Ato janë së fundi, të detyruara për t'u shkatërruar dhe të bëhen copa-copa. E ashtuquajtura fitore e kohëve të fundit nga kapitalizmi mbi socializmin do të sigurojë vetëm paqe kalimtare. Filozofitë kapitaliste në vetvete do të nxjerrin demonë, të fuqishëm të cilët do të rriten me shpejtësi në përmasa gjigande në mungesën e rivaliteteve nga socializmi. Vullkani i kapitalizmit do të shpërthejë më në fund me forcë të tillë sa që e gjithë bota do të tronditet, dridhet dhe shkundet.

(Marrë nga "Islam's Response to Contemporary Issues" ("Përgjigja e Islamit ndaj çështjeve bashkëkohore"), f. 170-172, Angli, 2007.

Fjalimi u mbajt më 24 shkurt 1990 në Sallën e Konferencës së Mbretëreshës Elisabetë II, Londër.)

Filozofitë kryesore të sistemit ekonomik

Filozofitë kryesore të sistemit ekonomik Përjasje (1)

Kapitalizëm

- ❖ Lejon sipërmarrjet private dhe zotërimin e pasurisë
- ❖ Sistemi i bazuar në interes (fajde)

Komunizëm

- ❖ Nuk lejon sipërmarrjet private dhe as zotërimin e pasurisë
- ❖ Vepron monopolizmi shtetëror

Sistemi ekonomik i paraqitur nga Islami

- ❖ Lejon sipërmarrjet private dhe zotërimin e pasurisë
- ❖ Nuk lejon fajdenë dhe interesin

Filozofitë kryesore të sistemit ekonomik Përjasje (2)

Kapitalizëm

- ❖ Interesi është forca lëvizëse për investimin
- ❖ Kapitali mund të shtohet edhe pa përpjekjet e pronarit
- ❖ Pronari jo medoemos rrezikon – nxitja për investimin e paskrupullt

Komunizëm

- ❖ Nuk ka opsion për investim individual
- ❖ Mungon nxitja për të prodhuar

Sistemi ekonomik i paraqitur nga Islami

- ❖ Kontrollon kapitalin jo produktiv me anë të zekatit – forca lëvizëse për investimin
- ❖ Pronari patjetër duhet të bëjë përpjekje për investime
- ❖ Pronari rrezikon – rezulton në një planifikim të kujdesshëm

Filozofitë kryesore të sistemit ekonomik

Përjasje (3)

Kapitalizëm

- ❖ Rritja mbikëqyret kundrejt faktorëve si inflacioni dhe interesi
- ❖ Është e lejuar dhe e mundshme që të shfrytëzohen ata që janë nevojtarët për hua – i lejon të pasurit që të mund të përthithin pasuritë nga të varfrit

Komunizëm

- ❖ Mungojnë faktorët përcaktues të rritjes
- ❖ Mungesa e monitorimit dhe kontrollit – sjell edhe më shumë humbje

Sistemi ekonomik i paraqitur nga Islami

- ❖ Parandalon përqendrimin e pasurisë në pak duar, duke e shpërndarë atë sipas sistemit të trashëgimisë dhe taksimit të kapitalit (zekatit)
- ❖ Parandalon shfrytëzimin, pasi çdo hua është ose investim i përbashkët ose “ndihmë”

Filozofitë kryesore të sistemit ekonomik

Përjasje (4)

Kapitalizëm

- ❖ Interesi i rritur ushtron presion të skajshëm ndaj bizneseve të vogla në periudha rënieje – shkakton falimentime
- ❖ Lehtëson investimet e paskrupullta të ndërmarrjeve me financim të madh – investitorët janë larg investimit dhe të interesuar vetëm për fitimin, i cili fiksohet

Komunizëm

- ❖ Nuk zbatohet

Sistemi ekonomik i paraqitur nga Islami

- ❖ Nuk ka interes për të paguar, që do të thotë kapacitete për të përballuar rënien vetëm duke ndarë humbjen – një mënyrë natyrale për t’u mbrojtur nga “letargjia”
- ❖ Investimi i ndershëm është më i mundshëm për t’u rritur sesa konkurrenca e pandershme
- ❖ Pjekuria e investitorëve për të përzgjedhur me kujdes meqë ata do të ndajnë humbjen/fitimin – është mbështetje për bizneset e ndershme.

Filozofitë kryesore të sistemit ekonomik

Përqsje (5)

Kapitalizëm

- ❖ Ngritja e interesit përdoret për të kontrolluar inflacionin
- ❖ Interesi i lartë e ul fuqinë blerëse, gjithashtu e minon rritjen industriale
- ❖ Shkalla e interesit si një mjet për të kontrolluar ekonominë kombëtare nga ndërhyrjet e qeverisë me ekonomi të lirë
- ❖ Në periudha afatgjata, interesi i fituar është poshtë shkallës së inflacionit

Komunizëm

- ❖ Nuk zbatohet

Sistemi ekonomik i paraqitur nga Islami

- ❖ Inflacioni kontrollohet me rritjen e prodhimit të përgjithshëm – oferta dhe kërkesa
- ❖ Nuk i jepet fuqia qeverisë që të manipulojë ekonominë e lirë
- ❖ Fitimi i realizuar në biznes/investimi tregtar është real

Filozofitë kryesore të sistemit ekonomik

Përqsje (6)

Kapitalizëm

- ❖ Merr hua nga vetë e ardhmja jote
- ❖ Të inkurajon të jetosh jashtë mundësive të tua
- ❖ Marketingu luan me mendjet e njerëzve
- ❖ Inkurajon ekstravagancën dhe lakminë
- ❖ Konsumimi i tepruar i tillë shkakton rritjen e inflacionit

Komunizëm

- ❖ Nuk zbatohet

Sistemi ekonomik i paraqitur nga Islami

- ❖ Parandalon shfrytëzimin
- ❖ Të Inkurajon të jetosh brenda mundësive të tua
- ❖ Inkurajon modestinë, dekurajon konkurrencën materiale
- ❖ Lejon ndërmarrjet private, por duke u dhënë një kod për mënyrën e të shpenzuarit

Filozofitë kryesore të sistemit ekonomik Përqasje (7)

Kapitalizëm

- ❖ Rritja e inflacionit shkakton reçensionin (rënien)
- ❖ Kur kemi rënie për disa shtete, kemi edhe rënie globale
- ❖ Orvatje të dëshpëruara për ndreqjen
- ❖ Traktate të padrejta tregtare shfrytëzojnë vendet nevojtare
- ❖ Nganjëherë shkaktohen edhe luftëra
- ❖ Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin e Shenjtë: “O ju besimtarë, frikësohuni nga Allahu dhe hiqni dorë nga ajo që ka mbetur nga fajdeja, nëse jeni besimtarë të vërtetë. Nëse nuk e bëni këtë ju është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse pendoheni, atëherë ju takon kapitali fillestar, në këtë mënyrë nuk do të bëni mizori e as nuk do t’ju bëhet mizori”

(El-Bekare 2:270-280)

Komunizëm

- ❖ Nuk zbatohet

Sistemi ekonomik i paraqitur nga Islami

- ❖ I parandalon pasojat e tilla negative

Shënimet e mësipërme janë marrë nga libri i Hazret Mirza Tahir Ahmadit, Kalifit të Katërt të Mesihut të Premtuar, “Përgjigja e Islamit ndaj problemeve bashkëkohore” (“Islam’s Response to Contemporary Issues” botuar për herë të parë në vitin 1992). Për më shumë hollësi lexoni kapitullin “Economic Peace” (“Paqja ekonomike”) të këtij libri.

KONFERENCA PËR PAQEN

E ORGANIZUAR NGA XHEMATI MYSLIMAN AHMADIA I ANGLISË

Më 21 mars të vitit 2009, Xhemati Mysliman Ahmadia i Britanisë së Madhe organizoi një konferencë për paqe, në të cilën 425 miqtë jo-ahmadianë nga fe dhe shoqëri të ndryshme morën pjesë. Veç tyre morën pjesë gjithashtu deputet i Kuvendit Britanik z. Siobhain McDonagh, *Shadow Minister* për komitetet dhe qeveritë lokale të Londrës dhe depute e Kuvendit Britanik znj. Justine Greening dhe shumë personalitete të tjera të shquara.

Gjatë 35 minutave të fjalimit të tij, *Hazreti* Mirza Masroor Ahmad, Kalifi i Pestë i Xhematit Mysliman Ahmadia, diskutoi mbi pengesat që hasen për të vendosur paqe të qëndrueshme; për krizën financiare globale të sotme; dështimin e Kombeve të Bashkuara dhe konfliktin në rritje në pjesë të ndryshme të botës.

Hazuri e nisi fjalimin duke deklaruar se, megjithëse ka një “dëshirë” të madhe për paqe, madje politikanët janë të kufizuar në aftësinë e tyre për të sjellë ndryshim të qëndrueshëm dhe në mbarë botën. Më tej, ai tha:

“Megjithëse ne kemi dëshirë

për paqe, ne nuk e kemi mundësinë të ndërmarrim masa praktike për vendosjen e saj. Ndonëse ne urojmë që bota të jetë një strehë e qetë, kufizimet tona na ndrydhin për ta bërë botën një vend të tillë.

Ai tha se disa njerëz ishin të detyruar të mbanin qëndrim të tillë për shkak të politikave qeveritare të shumëpërkulura; të tjerët, vijoi ai, janë detyruar jo nga politika, po për shkak të natyrës së tyre egoiste, gjë që do të thotë se ata ndërhyjnë vetëm kur kanë një synim apo interes personal. Kjo, tha ai, është një çështje që shtrihet si në Lindje dhe në Perëndim; si në Veri edhe në Jug. Egoizmi ekzistonte midis myslimanëve dhe të krishterëve dhe midis njerëzve që u përkasin feve të tjera apo edhe atyre që nuk kanë ndonjë besim të veçantë.

Hazuri vazhdoi të përshkruante mjetet përmes të cilave mund të arrihet paqja sipas Islamit. Ai citoi ajete nga Kurani i Shenjtë, që kanë të bëjnë me durimin për të qenë një virtyt thelbësor. Ai tha se afërsisht 70 milionë njerëz vdiqën gjatë Luftës së Dytë Botërore, pjesa më e madhe e të cilëve ishin civilë. Në qoftë se

njerëzit do të kishin shfaqur vetëm durim, shumë nga shkretimet mund të ishin shmangur. Të njëjtat gabime po bëhen në botën e sotme. Për këtë problem ai tha:

“Njerëzimi duhet të kishte nxjerrë mësimet, por për fat të keq njerëzit e sotëm nuk arrijnë të mësojnë nga gabimet e së kaluarës. Madje dhe ata që e quajnë veten myslimanë, po derdhin gjak, dhe kështu janë edhe ata që po punojnë me pretekstin për të vendosur paqen... Pavarësisht nga përpjekjet tona për të fshehur kokat në rërë, ne jemi të detyruar të shikojmë skenat e tmerrshme që e tronditin njeriun deri në kockë.

Kombet e Bashkuara, komentoi ai, janë një organizatë e gjerë, parimi bazë i së cilës ishte të vendosë dhe të ruajë paqen dhe sigurinë në botë. Kjo ka dështuar plotësisht për të arritur këto ideale të larta, për shkak të mungesës së drejtësisë dhe të mostrajtimet të ndershëm midis shteteve. Duke iu referuar Japonisë si një shembull i një vendi të lulëzuar dhe të zhvilluar mirë, Hazuri tha se pavarësisht nga ndjenja në dukje e

lirisë, te njerëz të nivelit të caktuar në këtë vend është shfaqur një sens irritimi dhe ndrydhjeje. Për problemin e Kombeve të Bashkuara, ai vazhdoi:

“Organizata e Kombeve të Bashkuara është krijuar për të vendosur paqen, por përpjekjet e saj për të sjellë paqen në çdo vend ku ajo mungon, nuk kanë arritur kurrë nivelin e suksesit, që duhej të arrinte një institucion i tillë... Kombet e Bashkuara po dështojnë për shkak të ndikimit të Superfuqive dhe për arsye se rrethi i ankthit po shkallëzohet. Ne thjesht nuk mund të mbyllim sytë ndaj kësaj. Shkakut i Luftës së Dytë Botërore ishte një ankth i tillë dhe luftërat lokale.”

Hazuri përfundoi fjalimin duke analizuar krizën globale financiare që është në zhvillim dhe duke e krahasuar atë me depresionin e madh të vitit 1929. Shumë ngjashmëri midis përplasjes së vitit 1929 dhe krizës së tanishme aktuale janë të dukshme. Të dyja krizat e kanë burimin në Shtetet e Bashkuara dhe efektet e tyre u përhapën në gjithë botën. Industritë u detyruan të ndërpresin prodhimin në vitin 1929. Dhe e njëjta gjë është e vërtetë dhe për sot. Të tilla



Konferenca për paqen, e organizuar më 21 mars të vitit 2009, në Londër

ndërprerje kanë efekte dytësore. Në një nivel ndërkombëtar tregtia ka rënë; në nivelin e strehimit e banesave kompanitë po dalin nga bizneset ose ndeshin një ulje të tregut në fitim; dhe në një nivel të njerëzve të caktuar po bëhen të tepërta dhe që përballojnë rizotërimet të shtëpive të tyre.

Depresioni i madh i vitit 1929, u pasua pothuajse menjëherë nga një mësymje e Luftës së Dytë Botërore në të cilën, miliona njerëz të pafajshëm humbën jetën e tyre. Hazuri tha se depresioni që vijoi, çfarëdolloj pasurie që ishte e vlefshme, u kanalizua në shumë pak duar duke çuar në ndarje dhe disidencë. Veç kësaj konfliktet në një shkallë më të vogël po shpërthenin në Evropë dhe në Azi. Të gjithë këta faktorë çuan përfundimisht në Luftën e Dytë Botërore. Hazuri paralajmëroi se sot bota po ndjek një rrugë të njëjtë. Ndonëse bankat u ndihmuan nga qeveritë (*bail out*), qindra miliona dollarë u përdorën për të plotësuar kulturën e bonusit të elitës. Konfliktet lindën në të gjitha anët e botës, veçanërisht në Lindjen e Mesme, Azinë e Jugut dhe në Evropën Lindore.

Hazuri shprehu një dëshirë, që

bota të mësojë nga gabimet e kaluara të saj dhe kështu të shmangë një luftë botërore të ardhshme, pasojat e së cilës mund të jenë të tmerrshme dhe shkatërrimtare. Ai tha:

“Qeveritë, ekonomistët e kapitalit dhe Kombet e Bashkuara duhet të kuptojnë përgjegjësitë e tyre. Këto duhet që të përmbushim kërkesat e drejtësisë dhe t’u japin vështirimin e duhur të drejtave të njeri-tjetrit. Ata duhet të mendojnë të diskutojnë dhe të gjejnë një zgjidhje të bazuar në drejtësinë. Ata duhet të përpiqen fuqimisht të vendosin paqen dhe është shumë e rëndësishme që ata të përmbushin detyrat që kanë ndaj Krijuesit të tyre dhe të shmangin pakënaqësinë e Tij.

Duke ndjekur fjalimin e rëndësishëm, të ftuarit pasi hëngrën një drekë patën rastin të takoheshin me Hazurin. Shumë nga të ftuarit diskutuan për vlerat dhe cilësinë e fjalimit të tij dhe të tjerët kerkuan lutjet e tij. Një e ftuarë tjetër tha se ajo ishte një e besimtare e krishterë dhe komentoi se nëse do të ndiqeshin mësimet e Hazurit, atëherë bota do ndryshonte për më mirë.

Shkurtime

s.a.v.s.: *Sal-lallahu alejhi ue selam*

(Paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi Profetin e shenjtë s.a.v.s.), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Profetit të shenjtë Hazreti (i nderuar) Muhammed s.a.v.s.

a.s.: *Alehis selam* (Paqja qoftë mbi të), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë Profeti të Allahut xh.sh.


r.a.: *Redi Allahu anhu/anha/anhum* (Qoftë Allahu i kënaqur me të), shkruhet e lexohet kur

përmendet emri i ndonjë *sahabi* të Profetit të shenjtë s.a.v.s. ose të Mesihut të Premtuar a.s.

r.t.a.: *Rahmatullah alejhe* (Allahu e mëshiroftë), shkruhet e lexohet kur përmenden emrat e muslimanëve të shquar e të devotshëm.

a.b.a.: *Ajjadahullahu t'ala bi nasrihil aziz* (Allahu e ndihmoftë atë me ndihmën e Tij të fuqishme), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Kalifit të tanishëm të Mesihut të Premtuar a.s.

Ajeti (vargu) “*Bismillah ...*” (Në emër të Zotit...) që i referohet Kuranit të Shenjtë konsiderohet si ajeti i parë i çdo kapitulli (*sure*). Në disa tekste, nuk shënohet si ajet i parë, dhe lexuesi duhet të ketë parasysh se ajeti i cituar në revistën *Vërtetësia*, në tekste të tjera do të gjendet në një ajet më parë sesa numri i cituar.



Të nderuar lexues,

Redaksia e *Vërtetësisë* do t'ju lutej që, në adresën e mëposhtme të shfaqni mendimin tuaj për problemin në fjalë. Zoti jua shpërbleftë!



E-mail:



Post:



Celularë:

vertetesia@gmail.com

Xhemati Mysliman Ahmadia
Kutia postare 8176
Tiranë, Shqipëri

+355 (0) 682974992

+355 (0) 692994966

+355 (0) 672168054

Fax: +355 (0) 48302523

PERLAT E URTËSISË NGA FE TË NDRYSHME

“Nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues.”

(Kurani i Shenjtë 35:25)

“Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij”

(Kurani i Shenjtë 2:286)

ISLAM

Profeti Muhammed s.a.v.s. thotë:

“Rruga e mesme e të shpenzuarit është gjysma e ekonomisë. Sjellja e mirë dhe e butë ndaj njerëzve është gjysma e mençurisë. Shtrimi i çështjes në mënyrën e duhur është gjysma e dijes.”

(Bejhaki, fi shuabil Iman)

KRISHTERIM

“Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë; ku i brejnë tenja dhe ndryshku dhe ku vjedhësit hyjnë dhe vjedhin, përkundrazi mblidhni për vete thesare në qiell, ku as tenja as ndryshku nuk prishin dhe ku vjedhësit nuk hyjnë dhe nuk vjedhin. Sepse ku është thesari juaj do të jetë edhe zemra juaj.”

(Mateu 6:19-21)

BUDIZËM

“Të jesh i dhënë pas një pikëpamjeje të caktuar dhe t’i konsiderosh pikëpamjet e të tjerëve më inferiore – këtë njeriu i mençur e quan vargua.”

(Sutta Nipata 798)

HINDUIZËM

“Për atë që është i vetëpërmbajtur, mendja është mikja më e mirë; po për dikë që ka dështuar të bëjë një gjë të tillë, mendja e tij do të jetë armiku më i madh.”

(Bhagvad Gita 6:6)

KONFUCIZËM

“Më kot kam kërkuar një njeri të vetëm të aftë për të parë gabimet e tij dhe të paraqesë akuzë kundër vetes.”

(Analects 5:26)